# RAPORTI VJETOR
# 2024





Biblioteka Kombëtare - Prishtinë

# PËRMBAJTJA


Mesazh nga bordi i drejtorëve 8
Mesazh nga menaxhmenti ekzekutiv 11
Vizioni 21
Misioni 21
Vlerat tona 21
Mjedisi makroekonomik 22
Sektori bankar 23
Pozicionimi i bankës ekonomike në tregun bankar të Kosovës 25
Pjesëmarrja në tregun e kredive 27
Pjesëmarrja në tregun e depozitave 29
Pasqyra e pozicionit financiar 31
Performanca financiare e Bankës Ekonomike 35
Asetet e bankës 36
Ecuria e kredive 37
Ecuria e depozitave 38
Te hyrat nga interesi 39
Shpenzimet operative 40
Zhvillimi i biznesit 41
Portofoli kreditor 45
Klientët korporatë 46
Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 51
Klientët individualë 53
Kanalet e distribuimit dhe rrjeti i degëve 55
Kanalet alternative të shërbimit – qendra e thirrjeve 59
Lizingu 61

Njësia për zhvillim të “bancassurance” 63
Zhvillimi i produkteve dhe përkrahja e biznesit 67
Menaxhimi i riskut 69
Menaxhimi i riskut kreditor 69
Risku i likuiditetit 70
Risku i tregut 71
Risku operacional 72
Risku i teknologjisë së informacionit (TI) 72
Risku kreditor 73
Pagesat dhe operacionet 77
Transferet kombëtare 77
Transferet ndërkombëtare 79
Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare 80
Kartelat bankare 83
Teknologjia e informacionit 85
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit 89
Pajtueshmëria e përgjithshme 93
Përgjegjësia sociale e korporatës 97
Siguria: Viti 2024, një histori e rritjes dhe udhëheqjes 162
Bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave 165
Performanca e KS Siguria 169
Departamenti i shitjes dhe marrjes në sigurim 175
Departamenti i sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve 177
Departamenti i sigurimit të pronave dhe garancioneve 181
Departamenti i sigurimeve kasko 185
Departamenti i sigurimit të autopërgjegjësisë (TPL) 186
Departamenti i dëmeve 189


Banka Ekonomike

# MESAZH NGA BORDI I DREJTORËVE

Të nderuar klientë, staf i përkushtuar dhe aksionarë vizionarë,

Është kënaqësi dhe nder i madh të ndajmë me ju një moment kaq të rëndësishëm për Bankën Ekonomike - një vit që nuk ishte thjesht një sfidë e përballuar, por një dëshmi e forcës, zhvillimit dhe përkushtimit tonë për të çuar më tej një vizion të guximshëm.

Viti 2024 ishte një periudhë ndryshimesh të mëdha, një kohë sfidash dhe mundësish, një moment kur tregjet financiare përballeshin me lëvizje të paparashikuara. Në mes të gjithë këtyre dinamikave, ne nuk qëndruam vetëm në hap me kohën, ne e formësuam atë.

Duke qëndruar besnikë ndaj vizionit tonë për rritje, ne jo vetëm që përballuam sfidat, por i shndërruam ato në mundësi të reja për të krijuar vlera për klientët tanë, partnerët dhe të gjithë ata që besojnë në fuqinë e Bankës Ekonomike. Me përkushtimin e jashtëzakonshëm të ekipit tonë dhe me strategji të menduara deri në detaje, ne arritëm rezultate që na bëjnë krenarë dhe vendosën bazat për një të ardhme edhe më të ndritur.

## Rrugëtimi drejt suksesit

Në qendër të çdo arritjeje që kemi bërë, kanë qenë rritja, modernizimi dhe transformimi. Ne kemi investuar në teknologjinë bankare për të ofruar një përvojë më të sigurt, më të shpejtë dhe më të personalizuar. Kemi krijuar shërbime financiare që i përgjigjen nevojave të kohës, duke siguruar që çdo hap i ndërmarrë të jetë një hap përpara për ju.

Ne nuk e kemi parë inovacionin thjesht si një përmirësim teknologjik, por si një mundësi për të transformuar mënyrën se si ju ndërveproni me bankën tuaj. Nga proceset më të lehta të aplikimit për kredi, te opsionet më të sigurta të pagesave dhe përvojat e personalizuara të klientëve, çdo ndryshim është bërë për t'ju ofruar një udhëtim financiar më të lehtë dhe më të frytshëm.

## Një partneritet që hap rrugë të reja

Një nga momentet më strategjike ka qenë dhe vazhdon të mbetet partneriteti ynë me "KS Siguria", një hap që nuk ka qenë thjesht një bashkëpunim, por një vizion i ri për të ardhmen.

Ky investim ka krijuar një strukturë shërbimesh që kombinojnë financat dhe sigurinë, duke ju mundësuar një menaxhim më të plotë të pasurive dhe investimeve tuaja.

Bashkëpunimi me kompaninë e Sigurimeve "Siguria" është vetëm fillimi i një epoke të re ku synojmë të ofrojmë më shumë shërbime të integruara dhe më shumë mundësi për ju. Bashkëpunime të tilla janë dëshmi e qartë e përkushtimit tonë për të shkuar përtej kufijve të zakonshmes dhe për të krijuar një përvojë që tejkalon pritshmërinë tuaj.

## Ekipa, forca që na shtyn përpara

Në zemër të çdo suksesi, jeni ju, klientët tanë të besuar, që na zgjidhni çdo ditë për të menaxhuar financat tuaja. Ju, partnerët tanë, që ndani me ne vizionin për rritje dhe zhvillimin në të gjitha fushat. Ju, aksionarët tanë, që na mbështesni në çdo hap të rrugës sonë. Dhe mbi të gjitha, ju, ekipa jonë e jashtëzakonshme, që çdo ditë e ktheni një sfidë në një mundësi dhe një ide në realitet.

Asgjë nga kjo nuk do të ishte e mundur pa besimin dhe përkrahjen tuaj. Jemi krenarë të ecim përpara së bashku, duke ndërtuar jo vetëm një bankë më të fortë, por edhe një të ardhme financiare më të sigurt për të gjithë.

## E ardhmja na pret më e ndritur se kurrë

Ndërsa shohim drejtë mundësive dhe rrugëve të reja, një gjë është e sigurt: ne nuk ndalemi këtu. Jemi të përkushtuar të vazhdojmë këtë rrugëtim, të sjellim inovacione të reja, të investojmë në teknologji, të krijojmë partneritete strategjike dhe mbi të gjitha, të forcojmë besimin që na keni dhënë.

Me energji të re dhe synime të qarta, po përgatitemi për kapituj dhe suksese të reja. Faleminderit që jeni pjesë e këtij udhëtimi të jashtëzakonshëm. Së bashku, do të arrijmë lartësi të reja!

**Me respektin më të madh dhe mirënjohjen më të thellë,**

***Valon Lluka***
***Kryesues i Bordit të Drejtorëve***

# MESAZH NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV

Të nderuar klientë, partnerë dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,
2024-a nuk ishte një vit i zakonshëm, por moment historik për bankën tonë. Një vit që sfidoi kufijtë tanë, por në të njëjtën kohë, një vit ku vendosmëria, zhvillimi dhe përkushtimi i ekipit tonë na çuan drejt sukseseve të reja. Në një ekonomi dinamike, ku sfidat dhe mundësitë ndryshonin nga dita në ditë, ne nuk zgjodhëm të qëndrojmë neutral, ne guxuam, dhe vendosëm standarde të reja.



**Shpend Luzha**
Kryeshef Ekzekutiv



**Hamide Pacolli Gashi**
Zv. Kryeshefe Ekzekutive



**Arijan Haxhibeqiri**
Zv. Kryeshef Ekzekutive

**Rritje, qëndrueshmëri dhe besim i fortë**

Ky sukses nuk matet vetëm me përqindje dhe statistika – ai pasqyron vizionin dhe angazhimin tonë për të sjellë vlera të reja për ju. Megjithatë, shifrat flasin vetë:

- Portofoli i Bankës Ekonomike u rrit për rreth 50 milion euro ose rritje për 10.97 përqind nga viti paraprak, duke dëshmuar jo vetëm besimin e klientëve tanë, por edhe rolin tonë si mbështetës i zhvillimit ekonomik.

- Ka pasur rritje të të hyrave duke arritur total prej 35.97 milion euro dhe duke mirëmbajtur pjesëmarrjen në total të të hyrave të interesit të tregut në 9.40 përqind.

- Depozitat gjithashtu pësuan rritje të ndjeshme prej rreth 60 milion euro ose rritje prej 11.14 përqind në krahasim me vitin e kaluar, një sinjal i qartë i sigurisë dhe stabilitetit që ofrojmë për klientët tanë.

- Këto kanë ndikuar që banka gjatë vitit 2024 të arrije fitim prej 12.05 milion euro para tatimit.

Por suksesin nuk e ndërtojmë vetëm mbi bilancet financiare. Ekipi ynë është forca që na shtyn përpara. Me investime të vazhdueshme në trajnime dhe zhvillim profesional, kemi siguruar që çdo punonjës i Bankës Ekonomike të jetë i përgatitur për sfidat e së ardhmes, duke ofruar shërbime të nivelit më të lartë.

## Shtylla e transformimit tonë, teknologjia

Për ne, inovacioni është një mision. Në vitin 2024, kemi sjellë shërbime dhe zgjidhje që e bëjnë bankingun më të lehtë, më të sigurt dhe me qasje më të lehtë për të gjithë klientët tanë:

- Lansimi i pagesave elektronike përmes terminaleve POS, po vazhdon të jetë një mundësi e avancuar që ka bërë ndryshime të mëdha në mënyrën se si bizneset realizojnë transaksionet e tyre, duke u mundësuar atyre të jenë më efikas dhe të sigurt.

- Përmirësimi i shërbimeve për procesimin e pagave, duke e bërë këtë proces më të lehtë dhe më të shpejtë për bizneset, që nga pajisjet më moderne deri te proceset më të përmirësuara të përpunimit.

- Zhvillimi i kartelës së depozitës, vazhdon të mbetet një mjet inovativ që mundëson menaxhimin më të sigurt dhe më të shpejtë të financave të bizneseve, duke i dhënë atyre mundësinë për të monitoruar dhe kontrolluar shpenzimet në kohë reale.

## Zgjerimi dhe lidhja me komunitetin

Përtej shifrave dhe performancës financiare, Banka Ekonomike ka ndërtuar një strategji të fuqishme për të shtrirë praninë dhe shërbimet e saj më afër qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës. Një momentet kyç që na kanë sjellë më afër komunitetit është, hapja e degës së re në Mitrovicën e Veriut më 14 nëntor në vitit 2024, që do të sjellë mundësi më të mëdha për qytetarët dhe bizneset e këtij rajoni.
Ky zgjerim është një hap i rëndësishëm për të krijuar një rrjet më të fortë dhe më të gjerë të lidhjes me komunitetin, duke ofruar mundësi të barabarta dhe të drejta për të gjithë, pa dallim.

**Përgjegjësia sociale, investimi në shoqëri dhe kulturë**

Si bankë që ka si qëllim të ndikojë pozitivisht në shoqërinë kosovare, angazhimi ynë shkon përtej transaksioneve financiare. Gjatë vitit 2024, ne kemi mbështetur shumë iniciativa sociale dhe kulturore, përfshirë:

- Sportin, duke investuar në klubet sportive të Kosovës, përfshirë futbollin, basketbollin, atletikën dhe shumë sporte të tjera si alpinizmi, volejbolli, xhudo, artet marciale. Besojmë se sporti është një pasqyrë e forcës, disiplinës dhe përkushtimit, vlera që janë thelbësore për suksesin e Bankës Ekonomike.

- Kulturën, duke mbështetur aktivitete dhe evenimente kulturore që kanë pasuruar jetën e qytetarëve me informacione dhe argëtim duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie më të pasur.

- Shëndetësinë dhe arsimin, duke investuar në projekte që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e talenteve të reja.

- Gjithashtu edhe kategoritë e margjinalizuara, duke mbështetur iniciativat që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës për ata që kanë më shumë nevojë.

Asgjë nga këto nuk do të ishte e mundur pa ju, besimin dhe mbështetjen e klientëve tanë, përkushtimin e stafit tonë të dedikuar dhe vizionin e qartë të aksionarëve dhe Bordit të Drejtorëve, të cilët janë ndihmësit tanë më të fortë. Këto janë shtyllat që mbështesin çdo hap të suksesit tonë dhe që na frymëzojnë të vazhdojmë përpara, me një angazhim të përhershëm për përmirësim dhe zhvillim. Me këtë bazë të fortë, shohim të ardhmen me besim dhe entuziazëm. Jemi të gatshëm të vazhdojmë të ndërtojmë kapituj të rinj të suksesshëm dhe të krijojmë mundësi të reja për të gjithë ata që janë pjesë e rrugëtimit tonë.
Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi të jashtëzakonshëm dhe që besoni tek Banka Ekonomike!

**Në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv,**
**Shpend Luzha**
**Kryeshef Ekzekutiv**

## Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit




## Depozitat (në milionë EUR)




## Asetet (në milionë EUR)




## Kreditë joperformuese (KJP)




## Kreditë (në milionë EUR)




## Fitimi para tatimit (në milionë EUR)




Mendon
për ty!


Komiteti për Zhvillim të Bancassuarance
Komiteti i Qevrisjes Korporative Personelit dhe Kompensimit
Departamenti për Menaxhimin e Riskut
Komiteti për Menaxhimin e Riskut
Asambleja e Aksionarëve
Bordi i Drejtorëve
Kryeshef Ekzekutiv
Departamenti Riskut Kreditor
Departamenti Financave dhe Thesarit
Departamenti Burimeve Njerëzore
Departamenti Ligjor
Departamenti i Sigurisë së Informacionit
Departamenti i Teknologjisë Informative
Njësia për Zhvillim të Bancassurance
Koordinatore e Zyrës Ekzekutive
Zv. Kryeshef Ekzekutiv për Zhvillim të Biznesit
Degët
Departamenti për Zhvillim të Produkteve dhe Përkrahje te Biznesit
Departamenti i Lizingut
Departamenti për NVM, Mikro dhe Agro Biznese
Departamenti për Individë
Departamenti për Korporata
Departamenti i Marketingut & PR

# STRUKTURA ORGANIZATIVE

Banka Ekonomike







Liqeni i Radoniqit - Gjakovë

# VIZIONI

Të jemi një nga ofruesit më të mirë dhe më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Kosovë.

# MISIONI

· Të jemi partneri më i mirë financiar i klientëve tanë, për të arritur rritje dhe qëndrueshmëri ekonomike.

· Të jemi në qendër të kërkesave dhe shërbimeve financiare të klientëve individualë, bizneseve, korporatave dhe klientëve institucionalë.

· Të mbështesim dhe rreshtohemi në të gjitha aktivitetet që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

· Qëllimi ynë parësor është të fitojmë dhe të ruajmë besimin e publikut si dhe t'u përmbahemi standardeve më të larta etike.

· Të arrijmë të ofrojmë mbështetje financiare, siguri dhe optimizëm tek klientët tanë.

# VLERAT TONA

· Në pikëpamjen afatgjate, ne investojmë në njerëz, produkte dhe teknologji.

Ne vazhdimisht përpiqemi të përmirësojmë performancën tonë deri në përpikëri.

# MJEDISI MAKROEKONOMIK

Gjatë vitit 2024, ekonomia e Kosovës vazhdoi të tregojë stabilitet dhe ritme të moderuara të rritjes ekonomike, të nxitura kryesisht nga konsumi final i amvisërive dhe investimet publike. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi rritje reale prej 3.3 përqind në krahasim me vitin paraprak. Kjo rritje u mbështet veçanërisht nga aktivitetet në sektorët e ndërtimit, tregtisë me pakicë dhe shërbimeve të tjera.

Inflacioni, ndonëse në rënie krahasuar me vitin 2022 dhe 2023, mbeti një faktor ndikues gjatë vitit 2024, duke ndikuar fuqinë blerëse të qytetarëve. Sipas ASK-së, indeksi i çmimeve të konsumit për vitin 2024 u stabilizua në nivel më të ulët, falë rënies së çmimeve të produkteve ushqimore dhe të karburanteve.

Përkundër përmirësimeve në indikatorët makroekonomikë, tregu i punës vazhdoi të përballej me sfida strukturore. Niveli i papunësisë në TM4 2024 u regjistrua në 11.9 përqind, ndërkohë që pjesëmarrja në fuqinë punëtore mbeti e ulët në krahasim me mesataren e vendeve të rajonit. Qeveria vazhdoi përpjekjet për nxitjen e punësimit, sidomos në sektorët e rinj dhe inovativë.

Në aspektin fiskal, shteti ruajti një disiplinë buxhetore të qëndrueshme, ndërsa investimet kapitale patën një rritje krahasuar me vitin 2023. Po ashtu, përmes projekteve infrastrukturore dhe bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, Kosova vazhdoi integrimin ekonomik rajonal dhe afrimin me tregun evropian.

Në përmbledhje, viti 2024 u karakterizua me një konsolidim të mëtejshëm të stabilitetit ekonomik, me sfida të vazhdueshme në tregun e punës dhe bilancin tregtar, por me perspektivë pozitive për rritje të qëndrueshme në vitet në vijim.

# SEKTORI BANKAR

Gjatë vitit 2024, sektori bankar në Kosovë ka treguar edhe një herë se është një nga promotorët të zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit financiar në vend. Më një përkushtim të vazhdueshëm ndaj përmisimit të shërbimeve, bankat kanë arritur të qëndrojnë pranë qyetetarëve dhe bizneseve duke ofruar zgjidhje të përshtatura për çdo nevojë financiare.

Përmes përparimeve në teknologji dhe digjitalizim, bankat kanë bërë të mundur që shumë shërbime të kryhen lehtë, shpejtë dhe pa nevojë për prezencë fizike. Nga hapja e llogarive online, deri tek aplikimet për kredi dhe menaxhimi i financave përmes aplikacioneve mobile, klientët kanë sot më shumë kontroll dhe komodidet se kurrë më parë.

Një nga përparësitë e sektorit bankar gjatë këtij viti ka qenë përqendrimi tek përvoja e klientit. Përtej produkteve financiare, bankat janë fokusuar në ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe besimi me klientët e tyre. Me qasje më transparente, komunikim, dhe staf të trajnuar mirë, bankat kanë krijuar një ambient ku klienti ndihet i dëgjuar dhe i vlerësuar.

Në një ekonomi që po ndryshon me shpejtësi, nevojat financiare janë po aq dinamike. Prandaj bankat në Kosovë janë përshtatur duke ofruar produkte po aq fleksibile qasje më individuale dhe mbështetje konkrete për bizneset që kërkojnë të rriten, ose individët që duan të investojnë në të ardhmen e tyre. Përmes këtyre qasjeve, sektori bankar ka luajtur rol të rëndësishëm në gjallërimin e ekonomisë.
Një tjetër aspekt  thelbësor ka qenë përballja më sfida të reja, si ndryshimet rregullative apo rreziqet e natyrës financiare dhe digjitale. Bankat kanë forcuar sistemet e tyre të sigurisë dhe kanë investuar në mbrojtjen e të dhënave duke krijuar një ambient të sigurtë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të tyre.

Në fund të këtij viti, sektori bankar në Kosovë paraqitet më i konsoliduar, më i zhvilluar dhe më pranë njerëzve. Me një vizion te qartë për të ardhmen dhe me një fokus të pandërprerë në përmisim, bankat mbeten një partner i rëndësishëm për çdo hap që qytetarët dhe bizneset ndërmarrin drejt suksesit dhe stabilitetit financiar.





Mali i Lubotenit

# POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS

Gjatë vitit 2024, tregu bankar në Kosovë ka vijuar me një zgjerim të qëndrueshëm, duke shënuar një rritje të përgjithshme të aktiveve prej 15.25 përqind. Kjo rritje është reflektim i zhvillimit ekonomik të vendit dhe rolit aktiv të institucioneve financiare në mbështetjen e sektorit privat dhe të individëve.

Në këtë dinamikë të tregut, Banka Ekonomike ka luajtur një rol të rëndësishëm duke shënuar një rritje të asteteve prej 11.08 përqind. Kjo rritje e qëndrueshme vjen si rezultat i strategjisë dhe shërbimeve financiare të bankës.

Në vlerë absolute, asetet totale të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2024 arritën në 675 milionë euro, nga 607 milionë euro që ishin në fund të vitit 2023. Ky progres dëshmon se banka po konsolidohet vazhdimisht si një nga institucionet më të qëndrueshme financiare në vend.

**FIGURA 1.**
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 Dhjetor 2024:




**FIGURA 2.**
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total asetet e tregut, 31 Dhjetor 2024:





Guri i Plakës - Drenas

# PJESËMARRJA NË TREGUN E KREDIVE

Në kredidhënie, Banka Ekonomike ka ruajtur një pozicion të rëndësishëm dhe konkurrues, duke mbajtur një pjesëmarrje prej 8.64 përqind në totalin e kredive në treg deri më 31 dhjetor 2024.

Gjatë vitit, banka ka arritur të ruajë një trend pozitiv të rritjes, duke shënuar një zgjerim të portofolit të kredive me 10.97 përqind. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe përmirësimit të kushteve të financimit për individët.

Pavarësisht sfidave të tregut, Banka Ekonomike ka arritur të ruajë një qasje të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë që kredidhënia të jetë e shëndetshme dhe e qëndrueshme.

**FIGURA 3.**
Rritja e Bankës Ekonomike në kreditë e përgjithshme në raport me tregun, 31 Dhjetor 2024:




**FIGURA 4.**
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e kredive në raport me tregun, 31 Dhjetor 2024:






# PJESËMARRJA NË TREGUN E DEPOZITAVE

Besimi i klientëve ndaj Bankës Ekonomike është reflektuar edhe në rritjen e depozitave, të cilat deri më 31 dhjetor 2024 përbënin 8.63% të totalit të depozitave në sektorin bankar të Kosovës.
Gjatë vitit 2024, banka ka regjistruar një rritje të depozitave prej 11.14 përqind, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm rritjeje në krahasim me vitet e mëparshme. Në krahasim me tregun që ka shënuar një rritje prej 13.92 përqind.
Kjo rritje dëshmon besimin e klientëve ndaj stabilitetit financiar të Bankës Ekonomike dhe përkushtimin e saj për të ofruar kushte të favorshme depozitimi, duke u fokusuar në siguri dhe shërbim cilësor.

**FIGURA 5.**
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në depozita në raport me tregun, 31 Dhjetor 2024;




**FIGURA 6.**
Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e depozitave në raport me tregun, 31 Dhjetor 2024;



# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR



Malet e Sharrit

| Pasuritë | Më 31 dhjetor 2024 | Më 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|
| Paraja e gatshme dhe në banka | 40,484 | 54,299 |
| Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës | 60,232 | 74,360 |
| Kreditë për klientët | 491,220 | 441,298 |
| Investime në letra me vlerë | 55,749 | 10,605 |
| Investimet në degë | 7,358 | 7,358 |
| Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi | 13,535 | 13,604 |
| Pasuritë e paprekshme | 3,220 | 3,860 |
| Asetet e shtyra tatimore | 343 | - |
| Pasuri të tjera | 3,140 | 2,547 |
| **Gjithsej pasuritë** | **675,281** | **607,931** |
| **Detyrimet** | | |
| Depozitat nga klientët | 596,936 | 537,067 |
| Detyrime ndaj bankave | 1,096 | 1,487 |
| Detyrimi i tatimit në fitim | - | 88 |
| Detyrime të tjera | 3,931 | 3,802 |
| Detyrimi i shtyer tatimor | 596 | 600 |
| **Gjithsej detyrimet** | **602,559** | **543,044** |
| **Ekuiteti dhe rezervat** | | |
| Kapitali aksionar | 29,422 | 29,422 |
| Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera | 4,887 | 4,746 |
| Fitime të mbajtura | 38,413 | 30,719 |
| **Gjithsej ekuiteti dhe rezervat** | **72,722** | **64,887** |
| **Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat** | **675,281** | **607,931** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre më 18 Prill 2025 nga:

Zt. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv

Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar

| Pasuritë | | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv. | | 35,973 | 30,746 |
| Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv. | | (7,741) | (5,450) |
| **Të ardhurat neto nga interesi** | | **28,232** | **25,296** |
| Të ardhurat nga e tarifa dhe komision | | 5,941 | 4,776 |
| Shpenzimet nga tarifa dhe komisione | | (1,667) | (1,201) |
| **Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet** | | **4,274** | **3,575** |
| Të ardhurat e tjera operative | | 811 | 634 |
| **Të ardhurat** | | **33,317** | **29,505** |
| Shpenzimet e personelit | | (5,585) | (5,067) |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | | (3,306) | (3,004) |
| Shpenzime të tjera | | (12,062) | (8,964) |
| (Lirimi)/ngarkesa e lejimit te humbjeve neto në instrumentet financiare | | (342) | 1,380 |
| Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme | | (365) | (942) |
| **Gjithsej shpenzimet operative** | | **(21,660)** | **(16,597)** |

| Pasuritë | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 11,657 | 12,908 |
| Tatimi në fitim | (963) | (1,182) |
| **Fitimi neto për vitin** | **10,694** | **11,726** |
| **Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse**<br>***Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas ne Fitim ose Humbje.*** | | |
| Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi. | - | - |
| Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës. | 4 | 18 |
| ***Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje.*** | | |
| Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse | 137 | (125) |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi** | **141** | **(107)** |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | **10,835** | **11,619** |



Kamenicë

# PERFORMANCA FINANCIARE E BANKËS EKONOMIKE

Banka Ekonomike ka vijuar traditën e saj të rritjes së qëndrueshme, duke mbajtur fokusin në përmirësimin e përvojës së klientëve dhe optimizimin e proceseve të brendshme financiare.

Në përmbyllje të vitit 2024, banka ka realizuar një fitim para tatimit në vlerë prej 12.05 milionë euro, duke shënuar një tjetër vit suksesi në aspektin e qëndrueshmërisë financiare.

Të hyrat neto nga interesi kanë regjistruar një rritje të konsiderueshme prej 11.9 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje është reflektim i politikave të kujdesshme të kredidhënies dhe menaxhimit të portofolit financiar, si dhe i përmirësimeve në strukturën e produkteve bankare.

Gjithashtu, banka ka arritur të tërheqë një numër të konsiderueshëm klientësh të rinj, falë investimeve në teknologji dhe inovacion. Në këtë drejtim, të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet arritën në 6.2 milionë euro, duke treguar përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve bankare dhe llojllojshmërinë e produkteve të ofruara.

# ASETET E BANKËS

Në fund të vitit 2024, asetet e bankës arritën në 675 milionë euro, duke reflektuar një rritje të ndjeshme krahasuar me 607 milionë euro në fund të vitit 2023.
Ky zgjerim është rezultat i një menaxhimi të suksesshëm të operacioneve, rritjes së numrit të klientëve dhe zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve bankare. Banka Ekonomike ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës së saj duke siguruar që asetet e klientëve të menaxhohen me profesionalizëm dhe efikasitet.

**FIGURA 7.**
Asetet e Bankës Ekonomike, 2020-2024



# ECURIA E KREDIVE

Gjatë vitit 2024, Banka Ekonomike ka vijuar të luajë një rol kyç në mbështetjen e sektorit privat dhe individëve. Falë një menaxhimi të mirë të portofolit dhe balancimit të duhur të rrezikut, portofoli i kredive ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Nga 451 milionë euro në vitin 2023, portofoli i kredive është rritur në 501 milionë euro në fund të vitit 2024.
Ky zgjerim është një tregues i qartë i besimit të klientëve ndaj Bankës Ekonomike dhe i përkushtimit të saj për të mbështetur zhvillimin e bizneseve dhe ekonomisë në tërësi.
Banka ka promovuar vazhdimisht produktet e saj të kredidhënies përmes fushatave të targetuara marketingu, duke ofruar kushte të favorshme financimi dhe shërbime të personalizuara për çdo kategori të klientëve.

**FIGURA 8.**
Portofoli i kredive, 2020-2024



# ECURIA E DEPOZITAVE

Rritja e vazhdueshme e depozitave në Bankën Ekonomike është një dëshmi e besimit të klientëve dhe stabilitetit të institucionit.
Në fund të vitit 2024, totali i depozitave ka arritur në 597 milionë euro, nga 537 milionë euro që ishte në vitin 2023. Kjo përfaqëson një rritje të qëndrueshme, e cila reflekton politikën e bankës për të ofruar kushte konkurruese për kursimet e klientëve dhe siguri të lartë për depozitat e tyre.
Nëpërmjet laramanisë së produkteve për klient, banka ka arritur të ruajë dhe të forcojë marrëdhëniet me klientët e saj, duke krijuar një bazë të fortë financiare për rritjen e mëtejshme.

**FIGURA 9.**
Depozitat e klientëve, 2020-2024



# TE HYRAT NGA INTERESI

| Euro '000 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga interesi | 15,847 | 17,966 | 21,513 | 24,577 | 30,746 | 35,971 |
| Kostot e depozitave | 2,415 | 2,640 | 2,783 | 3,188 | 5,450 | 7,678 |
| **Të hyrat NETO nga interesi** | **13,432** | **15,326** | **18,730** | **21,388** | **25,295** | **28,293** |
| **Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat** | **2,162** | **2,030** | **2,467** | **3,444** | **3,575** | **6,293** |

**FIGURA 10.**
Të hyrat nga interesi, 2020-2024;



# SHPENZIMET OPERATIVE

| Euro '000 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet administrative | 3.767 | 4,463 | 5,083 | 5,314 | 7,292 | 9,739 |
| Shpenzimet e personelit | 3,274 | 3,466 | 3,888 | 4,546 | 5,064 | 5,582 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | 1,827 | 2,277 | 2,367 | 2,611 | 3,055 | 3,575 |
| **Gjithsej shpenzimet operative** | **8,868** | **10,206** | **11,338** | **12,471** | **15,410** | **18,896** |

**FIGURA 11.**
Shpenzimet Operative 2020 - 2024




Performanca e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2024 ka qenë një dëshmi e qartë e qëndrueshmërisë së saj dhe e përkushtimit për të ofruar shërbime të nivelit të lartë për klientët.
Me një rritje të konsiderueshme në asetet, kreditë dhe depozitat, banka ka vazhduar të luajë një rol kyç në tregun bankar të Kosovës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe duke forcuar pozicionin e saj në sektorin financiar.

Strategjia e saj e zgjerimit dhe inovacionit, e kombinuar me një menaxhim të kujdesshëm të rrezikut dhe një fokus të vazhdueshëm në nevojat e klientëve, do të sigurojë që Banka Ekonomike të vazhdojë të jetë një institucion lider në tregun bankar edhe në vitet në vijim.

# ZHVILLIMI I BIZNESIT

**Banka Ekonomike vazhdoi me suksese edhe ne vitin 2024**

Me strategji, digjitalizim të avancuar dhe mbështetje të fortë për bizneset dhe komunitetin, Banka Ekonomike ka shënuar një vit rekord, duke zgjeruar portofolin dhe përmirësuar përvojën e klientëve. Korporatat dhe bizneset e mëdha janë motorët e rritjes në bankën ekonomike.

Në një treg sfidues dhe dinamik, Departamenti i Korporatës ka vazhduar të jetë një shtyllë kryesore e rritjes së Bankës Ekonomike. Me një pjesëmarrje prej 31.53 përqind në portofolin e kredive dhe 19.50 përqind në totalin e depozitave, ky segment ka treguar stabilitet dhe ndikim të fuqishëm në ekonominë e vendit.

Për të rritur efikasitetin dhe për t'u përshtatur me nevojat e klientëve, proceset kryesore janë rishikuar dhe optimizuar. Një nga sukseset më të mëdha ka qenë projekti i POS terminaleve, i cili ka sjellë një qarkullim prej 32.79 milion EUR nga klientët e korporatave, duke kontribuar me 56.32 përqind të totalit të qarkullimit të POS terminaleve të bankës.

**Në Bankën Ekonomike mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është hapi kryesor drejt një ekonomie të suksesshme**

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të punës dhe inovacionit në vend. Banka Ekonomike ka qëndruar pranë tyre, duke u ofruar mbështetje financiare dhe produkte të personalizuara.

Gjatë vitit 2024, portofoli i kreditimit për këtë segment është rritur me 16.2 milionë EUR, duke arritur në 140.5 milionë EUR. Një faktor kyç ka qenë Fondi Garantues, i cili ka ndihmuar bizneset të kenë akses më të lehtë në kapital dhe të tejkalojnë sfidat e sigurimit të kolateralit.
Përparim i madh është bërë edhe në rritjen e infrastrukturës së pagesave, me shpërndarjen e mbi 1,100 POS terminaleve në të gjithë Kosovën, duke ndihmuar

bizneset të ofrojnë shërbime më të shpejta dhe më efikase. Ky investim ka gjeneruar një qarkullim prej 25 milion EUR brenda vitit.

**Avancimi digjital, për zhvillim të produkteve në një bankë më pranë klientëve**
Transformimi digjital ka qenë një ndër prioritetet kryesore të Bankës Ekonomike gjatë vitit 2024. Për të përmirësuar përvojën e klientit dhe për të lehtësuar shërbimet financiare, janë ndërmarrë disa hapa të mëdhenj, përfshirë:

- Thjeshtimin e dokumentacionit për shërbimet financiare, duke eliminuar burokracinë e panevojshme.
- Zhvillimin e produkteve të reja digjitale, të cilat u përshtaten nevojave të klientëve modernë.
- Fushata ndërgjegjësimi për përdorimin e Mobile Banking, POS terminaleve dhe kartelave të kreditit, duke nxitur një adoptim më të gjerë të shërbimeve elektronike.

Këto masa kanë sjellë rritje të ndjeshme në numrin e klientëve të rinj, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e depozitave dhe kredive, si dhe në përdorimin më të madh të shërbimeve financiare online.



Shpella e Kusarit - Gjakovë

## Lizingu partner i ri për investime dhe rritje

Një nga sukseset më të mëdha të Bankës Ekonomike në vitin 2024 ka qenë zgjerimi i shërbimit të lizingut, i cili tashmë është shndërruar në një ndër produktet më të kërkuara financiare.

Përmes bashkëpunimeve me kompani ndërtimi dhe biznese të ndryshme, Banka ka ofruar zgjidhje fleksibile financiare, duke u dhënë klientëve mundësinë të investojnë më lehtë në pajisje, automjete dhe asete të tjera të rëndësishme për biznesin e tyre. Besimi i klientëve dhe rritja e kërkesës ka ndikuar në zgjerimin e këtij segmenti, duke e forcuar pozicionin e Bankës Ekonomike si një lider në financimet fleksibile.

## Bankë partnere për komunitetin

Për Bankën Ekonomike, suksesi nuk matet vetëm me shifra financiare, por edhe me ndikimin pozitiv në shoqëri. Për këtë arsye, gjatë vitit 2024, banka ka investuar në projekte të shumta sociale, edukative dhe sportive, duke mbështetur zhvillimin e komunitetit.

- Arsimi dhe shëndetësia – Mbështetje për iniciativat që ndihmojnë përmirësimin e kushteve në shkolla dhe spitale.
- Sporti – Sponsorime për klube dhe talente të reja, duke ndihmuar në zhvillimin e sportit në vend.
- Kultura dhe arti – Përkrahje për evente kulturore që ruajnë dhe promovojnë trashëgiminë dhe kreativitetin vendor.

Ky angazhim nuk është thjesht një strategji marketingu, por një përkushtim i vazhdueshëm për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Me vizion të qartë, inovacion të vazhdueshëm dhe përkushtim ndaj klientëve, Banka Ekonomike ka shënuar një vit të jashtëzakonshëm në 2024. Duke forcuar rolin e saj si një partner financiar i besueshëm, banka synon që në vitet e ardhshme të sjellë edhe më shumë produkte inovative, shërbime të përmirësuara dhe mbështetje për zhvillimin ekonomik të Kosovës.



Hyjnesha në Fron

# PORTOFOLI KREDITOR

Banka Ekonomike ka shënuar një performancë të jashtëzakonshme në portofolin kreditor gjatë vitit 2024 si rezultat i strategjisë sonë të përpunuar me kujdes dhe angazhimit tonë për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë në të gjitha segmentet e biznesit.

Në vitin 2024, kemi vazhduar të shënojmë një rritje të qëndrueshme në portofolin kreditor, duke shtuar vlerën e tij nga 450 milionë euro, sa ishte në vitin 2023, në 501 milionë euro. Kjo rritje e madhe është rezultat i një strategjie të qëndrueshme të ofrimit të produkteve kreditore në të gjitha segmentet e tregut. Ky diversifikim i portofolit ka siguruar stabilitetin dhe rritjen e qëndrueshme të Bankës sonë në tregun e kredisë.

Me një qasje të përkushtuar ndaj nevojave të klientëve tanë dhe një angazhim të vazhdueshëm për të përmirësuar ofertën tonë kreditore, ne jemi të gatshëm për të vazhduar rrugën e suksesit në vitin 2025 dhe për të konsoliduar pozicionin tonë si një nga liderët në tregun e kredisë.

| Segmenti | Ekspozimi kreditor 2023 `000 | Përqindja e participimit në vitin 2023 | Ekspozimi kreditor 2024 `000 | Përqindja e participimit në vitin 2024 |
|---|---|---|---|---|
| NVM | 124 242,00 | 28% | 140 746,00 | 28% |
| LIZING | 32 107,00 | 7% | 40 492,00 | 8% |
| Korporatë | 151 978,00 | 34% | 157 984,00 | 32% |
| Individë | 142 213,00 | 32% | 161 888,00 | 32% |
| **Totali** | **450 540,00** | **100%** | **501 110,00** | **100%** |

# KLIENTËT KORPORATË

Banka Ekonomike më afër klientëve me shërbime të shpejta dhe moderne

**Rritja dhe Menaxhimi i Portofolit të Kredive**
Gjatë vitit 2024, portofoli i kredive u zgjerua me 7.32 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 4.86 përqind. Ky rezultat është dëshmi e aftësisë së bankës për të ruajtur një kërkesë të qëndrueshme për financim dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për klientët.
Ky fleksibilitet në menaxhimin e portofolit dëshmon jo vetëm aftësinë e bankës për të përshtatur ofertën e saj me kërkesën e tregut, por edhe stabilitetin e strategjisë së financimit që ndjek.

**Stabiliteti i depozitave dhe struktura e balancuar**
Depozitat e klientëve u mbyllën me 116.4 milionë euro, duke ruajtur zhvillim të vazhdueshëm nga viti në vit. Struktura e depozitave ishte e ekuilibruar, me 35 përqind në llogari rrjedhëse dhe 65 përqind në depozita me afat, duke siguruar një bazë solide financiare për bankën dhe klientët e saj.
Ky stabilitet tregon besimin e klientëve në bankë dhe aftësinë e saj për të menaxhuar likuiditetin në mënyrë efektive. Ruajtja e një raporti të shëndoshë mes depozitave me afat dhe atyre rrjedhëse ndihmon gjithashtu në optimizimin e kostos së fondeve dhe në mbështetjen e kërkesës për kredi.

**Rritja e normës së interesit në portofolin kreditues**
Në vitin 2024, norma e ponderuar (koeficienti mesatar) e interesit për kreditë u rrit me 0.29 përqind, duke reflektuar një menaxhim të kujdesshëm të riskut dhe një strategji të suksesshme të çmimeve.
Kjo rritje tregon aftësinë e bankës për të përshtatur normat e saj me kushtet e tregut, duke siguruar një balancë të duhur mes konkurrencës dhe ruajtjes së neto marzhit të interesit. Kjo qasje e kujdesshme ndihmon në ruajtjen e një oferte tërheqëse për klientët dhe njëkohësisht mbron qëndrueshmërinë financiare të bankës.

**Zgjerimi i aktivitetit të klientëve dhe rritja e qarkullimit**

**Volumi i përgjithshëm i transfereve dhe qarkullimit dalës të klientëve u rrit me** 502.92 milionë euro krahasuar me vitin 2023. Ky rezultat tregon një intensifikim të aktiviteteve financiare të klientëve, sidomos në segmentin korporativ dhe institucional.

Një faktor kyç që ka ndikuar në këtë rritje është përmirësimi i shërbimeve digjitale dhe operacionale të bankës, të cilat kanë lehtësuar proceset e menaxhimit të flukseve financiare për klientët. Investimet në përmirësimin e sistemeve dhe proceseve kanë sjellë një përvojë më të mirë për përdoruesit, duke ndikuar pozitivisht në angazhimin e tyre me bankën.

Rritja e disbursimeve dhe mbështetja për bizneset

**Gjatë vitit 2024, disbursimet totale të kredive u rritën me 13.2 milionë euro krahasuar** me një vit më parë. Kjo rritje pasqyron një angazhim të fuqishëm për të mbështetur nevojat financiare të klientëve, duke ofruar zgjidhje të lehta dhe të personalizuara të financimit. Rritja e disbursimeve jo vetëm që ka kontribuar në zgjerimin e portofolit kreditues, por gjithashtu ka ndikuar në rritjen e të ardhurave nga interesat dhe në përmirësimin e pozicionit të bankës në treg.

**financiare në treg**

**Gjatë vitit 2024, u hapën mbi 60 llogari të reja për klientë të korporatës dhe klientë** institucionalë, duke zgjeruar prezencën e bankës në këtë segment kyç. Gjithashtu, u lëshuan mbi 50 kredit kartela, duke lehtësuar aksesin e klientëve në instrumente financiare moderne.

Ky zgjerim tregon një rritje të besimit të klientëve ndaj bankës dhe një orientim më të madh drejt shërbimeve digjitale dhe fleksibilitetit në menaxhimin e financave të tyre. Kredi kartelat mbeten një mjet i rëndësishëm për klientët në sigurimin e likuiditetit të menjëhershëm dhe përmirësimin e përvojës së tyre financiare.

Përmirësimi i cilësisë së portofolit dhe ulja e kredive joperformuese

**Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit ishte ulja e nivelit të kredive** joperformuese nga 1.6 përqind në 2023 në vetëm 0.32 përqind në 2024.

Ky përmirësim i ndjeshëm është rezultat i një menaxhimi më të kujdesshëm të rrezikut, analizave më të avancuara të kredive dhe një monitorimi më të vazhdueshëm të ekspozimeve financiare.
Përveç kësaj, bankë ka vazhduar mbështetjen e personalizuar për klientët në menaxhimin e detyrimeve të tyre, duke parandaluar vonesat në pagesa dhe duke përmirësuar kualitetin financiar të portofolit të saj.

**Rritja e rrjetit të pagesave dhe përdorimi i POS Terminaleve**

Gjatë vitit, u instaluan mbi 700 terminale POS te klientët e korporatës, duke rritur ndjeshëm kapacitetin e tyre për të përpunuar pagesa elektronike dhe për të ofruar një përvojë më të mirë për konsumatorët e tyre. Si rezultat, qarkullimi i gjeneruar nga POS terminalet arriti mbi 32 milionë euro, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave nga komisionet dhe në zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve për bizneset.

**Një vit i suksesshëm dhe perspektivat për të ardhmen**

Viti 2024 ka qenë një periudhë transformuese për departamentin e korporatës, duke përballuar me sukses sfidat e tregut dhe duke shënuar një rritje të qëndrueshme në të gjithë treguesit kyç.
Zgjerimi i portofolit të kredive, rritja e qarkullimit financiar dhe stabiliteti i depozitave janë dëshmi e një menaxhimi të strukturuar dhe të orientuar drejt nevojave të klientëve. Departamenti ka treguar një aftësi të lartë për të balancuar rritjen dhe stabilitetin, duke krijuar bazat për zhvillim edhe më të fortë në vitet në vijim.


Shala e Bajgorës





Muzeu Etnologjik - Prishtinë

# KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

## Financimi i bizneseve, forcimi dhe zgjidhja e një partneriteti të suksesshëm

### Mbështetje e vazhdueshme për SME-të – besim, zhvillim dhe qasje më e lehtë në financim

Në një ekonomi të lëvizshme dhe fleksibile, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) mbeten shtylla kryesore e zhvillimit dhe punësimit. Duke e kuptuar rëndësinë e këtij segmenti, Banka Ekonomike ka vijuar me përkushtim mbështetjen e bizneseve në rrugëtimin e tyre të rritjes dhe suksesit. Gjatë vitit 2024, banka ka shënuar një zgjerim të ndjeshëm të portofolit kreditues për NVM-të, duke e rritur atë me 16.2 milionë euro, nga 124.2 milionë euro në 140.5 milionë euro. Ky rezultat është dëshmi e besimit të bankës në kapacitetet e bizneseve dhe e përkushtimit për të ofruar produkte financiare të përshtatura me nevojat e tyre.

### Financim i përshtatur për bizneset, rritje përmes qasjes së lehtësuar në kapital

Një nga sfidat kryesore për bizneset mbetet qasja në financim dhe sigurimi i kolateralit të nevojshme për të marrë kredi. Në këtë drejtim, Fondi Garantues ka luajtur një rol të rëndësishëm, duke shërbyer si një mekanizëm i vlefshëm për tejkalimin e kufizimeve që hasin shumë ndërmarrje në sigurimin e kolateralit. Përmes kësaj mbështetjeje, shumë biznese kanë arritur të financojnë projektet e tyre, të investojnë në zgjerimin e kapaciteteve dhe të forcojnë pozicionin e tyre në treg.

### Një qasje më e qëndrueshme, cilësi e lartë në menaxhimin e portofolit kreditues

Suksesi në kreditim nuk matet vetëm me rritjen e shumës së dhënë, por edhe me cilësinë e menaxhimit të portofolit. Banka Ekonomike ka treguar një qasje profesionale dhe të kujdesshme në menaxhimin e rrezikut, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm të kredive joperformuese dhe duke garantuar një portofolio të shëndoshë kreditues. Ky menaxhim i kujdesshëm reflekton përkushtimin e bankës për të ofruar financime të përgjegjshme, të cilat ndihmojnë bizneset të rriten pa u përballur me vështirësi të mëdha financiare.

**Jo vetëm kredi por një qasje e integruar për nevojat e bizneseve**

Përveç mbështetjes për kreditimin, Banka Ekonomike ka vazhduar të zgjerojë ofertën e saj për NVM-të duke integruar shërbime moderne dhe të përshtatura me nevojat e bizneseve. Aktualisht, tek klientët NVM banka ka 1,061 POS terminale, duke ndihmuar bizneset të modernizojnë mënyrën e pagesave dhe të rrisin efikasitetin e tyre operativ. Kjo ka bërë që shumë ndërmarrje të ofrojnë një përvojë më të mirë për klientët e tyre, duke lehtësuar pagesat.

## Banka Ekonomike është një partner strategjik për të ardhmen e bizneseve

Duke parë nevojat e tregut dhe potencialin e madh që kanë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Banka Ekonomike mbetet e angazhuar për të ofruar mbështetje afatgjatë dhe të qëndrueshme për këtë segment. Qasja jonë strategjike nuk kufizohet vetëm në ofrimin e financimeve, por edhe në krijimin e një ekosistemi mbështetës që u mundëson bizneseve të zhvillohen dhe të përfitojnë nga mundësitë e tregut.

Në vitet në vijim, Banka Ekonomike do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm për bizneset, duke sjellë zgjidhje financiare të personalizuara dhe një mbështetje të pandërprerë, që fuqizon sipërmarrësit dhe rritë ndikimin e tyre në ekonomi.



Ura e Terezive - Gjakovë

# KLIENTËT INDIVIDUALË

Në vitin 2024, Banka Ekonomike ka vazhduar të ruajë dhe të forcojë pozicionin e saj në treg duke zhvilluar më tej portofolin e kredive dhe depozitave për klientët individualë. Me një qasje inovative dhe oferta të personalizuara, banka ka synuar jo vetëm të mbajë klientët ekzistues, por edhe të tërheqë klientë të rinj, duke sjellë produkte unike për grupmosha dhe profile të ndryshme, si:

**Llogaria për fëmijë 16+**
**Llogaria studentore**
**Pakot për pagamarrësit në sektorin publik dhe privat**

Me përkushtimin dhe shërbim cilësor, 9,901 klientë të rinj i kanë besuar Bankës Ekonomike duke hapur llogari të reja gjatë vitit.
Zhvillimi ka qenë një shtyllë kryesore, duke përmirësuar vazhdimisht produktet ekzistuese dhe duke krijuar oferta të reja që i përshtaten klientëve tanë. Në bashkëpunim me departamente të ndryshme, janë realizuar kampanja të dedikuara për kredi, depozita dhe llogari rrjedhëse, të cilat kanë përmbushur nevojat financiare të klientëve dhe kanë sjellë përvoja të reja dhe më të favorshme bankare.

Si pjesë e këtyre kampanjave, klientët jo vetëm që kanë përfituar kushte preferenciale, por gjithashtu kanë pasur mundësinë të bëhen pjesë e lojërave shpërblyese, ku ndër çmimet më të mëdha janë dhuruar:

- **Një apartament në Shëngjin**
- **Një Veturë e markës “Volkswagen Polo”**

Bashkëpunimi i ngushë me të gjitha degët dhe nëndegët e Bankës na mundësoi në arritjen e objektivave strategjike të Bankës në rekrutimin e klientëve te rinjë, kredi dhe depozita që tregon se në aspektin financiar, viti 2024 ka shënuar rritje të dukshme për Bankën Ekonomike:

- **Portofoli i kredive për individë: +19.69 milion € (+13.85 përqind)**
- **Llogari rrjedhëse: +43.92 milion € (+18.36 përqind)**
- **Llogari kursimi: +4.07 milion € (+12.10 përqind)**
- **Depozita me afat (TDA): +12.83 milion € (+4.85 përqind)**

Me një qasje strategjike, përkushtim dhe orientim të qartë drejt nevojave të klientëve, banka ka arritur të ruajë nivelin e lartë të likuiditetit, duke mbetur një partner i besueshëm për individët në çdo hap të rrugëtimit të tyre financiar.



Liqeni i Breznës - Dragash


Rugovë

# KANALET E DISTRIBUIMIT DHE RRJETI I DEGËVE

Banka Ekonomike vazhdon të qëndrojë afër klientëve të saj, duke investuar në përmirësimin e hapësirave të shërbimit dhe ofrimin e një eksperience sa më të rehatshme në çdo degë dhe hapësirë të bankës.
Me një rrjet të zgjeruar prej 33 degësh, të shpërndara në 7 degë kryesore dhe 26 nëndegë, banka ka siguruar që shërbimet e saj të jenë sa më leht të çasshme kudo në Kosovë.
Gjatë vitit 2024, në përputhje me standardet bashkëkohore, janë bërë rinovime dhe përmirësime infrastrukturore dhe hapësirave vetshërbyese në disa degë kryesore, duke përfshirë:

- **Zhvendosjen e nëndegës në Prizren dhe Kastriot**
- **Rinovimin e degës në Mitrovicë**
- **Hapjen e një nëndege të re në Mitrovicën e Veriut**

Ky zgjerim jo vetëm që pasqyron rritjen e bankës, por edhe angazhimin e saj për të qenë një faktor kyç në zhvillimin ekonomik të vendit, duke krijuar një ambient modern dhe të përshtatshëm për klientët.
Sipas të dhënave të përgjithshme të tregut bankar në Kosovë, Banka Ekonomike renditet si e katërta në tregun bankar, duke dëshmuar suksesin e saj në ndërtimin e një baze solide klientësh dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve, duke qenë sa me afër klientëve.
Pjesmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar;

**FIGURA 12.**
Pjesmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar




## BANKOMATET

Banka Ekonomike ka shënuar një rritje prej 12 përqind në numrin e bankomateve, duke zgjeruar kështu qasjen e klientëve në shërbimet bankare 24/7.
Numri i transaksioneve në bankomatë ka shënuar rritje të ndjeshme:

- **Deponimet: +50.06 përqind në numër të transaksioneve, +70.03 përqind në volum**
- **Tërheqjet: +7.28 përqind në numër të transaksioneve, +18.37 përqind në volum**
- **Blerjet me kartelë në POS terminale: +1251.46 përqind në numër, +1092.58 përqind në volum**

Me një rrjet të zgjeruar bankomatësh dhe një rritje të ndjeshme të përdorimit të tyre, Banka Ekonomike po e forcon pozicionin e saj si një bankë moderne dhe e qasshme.

## POS TERMINALET

Në vitin 2023, Banka Ekonomike hyri fuqishëm në treg me 1,000 POS terminale të teknologjisë më të fundit. Në vitin 2024, falë një ekipi të përkushtuar dhe shërbimeve të personalizuara për bizneset, numri i POS terminaleve u dyfishua, duke arritur 1,947 terminale deri në fund të vitit.

Rritja e POS terminaleve ka ndikuar drejtpërdrejt në lehtësimin e pagesave dhe rritjen e qarkullimit të bizneseve, duke u mundësuar klientëve më shumë opsione për pagesa të shpejta dhe të sigurta.

Banka Ekonomike do të vazhdojë investimet në teknologji për të ofruar shërbime sa më moderne dhe të përshtatshme për të gjithë klientët e saj.





Ura e Rugovës

# KANALET ALTERNATIVE TË SHËRBIMIT – QENDRA E THIRRJEVE

Në një botë ku komunikimi i shpejtë dhe efektiv është thelbësor, Qendra e Thirrjeve e Bankës Ekonomike ka luajtur një rol kyç në lidhjen me klientët dhe ofrimin e ndihmës në kohë reale.
Me qasje dhe gatishmëri për klientët e saj në 24/7, kjo qendër ka qenë një pikë kyçe kontakti për mijëra klientë, duke siguruar informacion të detajuar mbi produktet, shërbimet dhe ofertat bankare.
Në vitin 2024, banka ka investuar në zhvillimin teknologjik dhe rritjen e kapaciteteve operacionale, duke siguruar:

- **Menaxhim më të mirë të thirrjeve**
- **Përmirësim të kohës së përgjigjes**
- **Shërbim më cilësor dhe të personalizuar për klientët**

Si rezultat, Qendra e Thirrjeve ka trajtuar me sukses mbi 40,000 kërkesa, duke siguruar një eksperiencë bankare të lehtë, të qartë dhe të efektshme për çdo klient. Me rritjen e kërkesës për shërbime të personalizuara dhe digjitale, Banka Ekonomike mbetet e përkushtuar në sjelljen e risive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të eksperiencës së klientëve në të gjitha platformat e komunikimit.
Në vitet që vijnë, Banka Ekonomike do të vazhdojë të jetë pranë klientëve të saj, duke sjellë shërbime inovative, fleksibilitet dhe oferta të personalizuara, për t'u siguruar që çdo klient të ketë një përvojë financiare të thjeshtë, të sigurt dhe të përmirësuar!



Liqeni i Batllavës

# LIZINGU

## Lizingu në rritje të vazhdueshme – Zgjerim, Besim dhe Sukses!

Ashtu si në vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2024 kemi vijuar me përkushtim për ta shtrirë edhe më tej shërbimin tonë të lizingut, duke krijuar mundësi të reja financimi për klientët tanë.

Zgjerimi i gamës së produkteve të lizingut dhe thellimi i bashkëpunimit me kompanitë e ndërtimit ka sjellë një kërkesë të vazhdueshme për financim në sektorin e lizingut të patundshmërive.
Kjo ka ndikuar në shfrytëzimin maksimal të potencialit të financimit, duke tërhequr klientë të rinj dhe duke forcuar lidhjet me ata ekzistues.

Rritje e fuqishme edhe në vitin 2024!
Portofoli i lizingut ka shënuar rritje të konsiderueshme, ku disbursimet janë rritur me 24.57 përqind krahasuar me vitin 2023.

- **Klientët korporatë kanë shënuar rritje prej 44.14 përqind**
- **Klientët individualë kanë regjistruar një rritje mbresëlënëse prej 103 përqind**

Portofoli aktiv për vitin 2024 ka arritur në 40.49 milionë euro:

- **Klientët korporatë: 15.17 milionë euro**
- **NVM-të: 20.94 milionë euro**
- **Klientët individualë: 4.38 milionë euro**

Ky sukses i qëndrueshëm është rezultat i një pune ekipore të palodhur dhe besimit që klientët tanë kanë ndërtuar tek ne. Zgjerimi i llojllojshmërisë së produkteve, thellimi i partneriteteve dhe përkushtimi ndaj nevojave financiare të klientëve tanë janë shtyllat e këtij suksesi.

## E ardhmja edhe me më shumë rritje!

Duke parë potencialin e madh dhe kërkesën në rritje për këtë produkt, Banka do të vijojë me fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve, duke siguruar një ofertë edhe më të gjerë e të përshtatur për nevojat e klientëve tanë. Besimi juaj është shtysa jonë për të ecur përpara!



Kalaja e Kulinës - Kamenicë

# NJËSIA PËR ZHVILLIM TË "BANCASSURANCE"

**Zhvillimi i bashkëpunimit dhe përmirësimi i marrëdhënieve mes Bankës Ekonomike dhe KS Sigurisë**

Gjatë vitit 2024, Banka Ekonomike ka vazhduar përpjekjet për të forcuar koordinimin me KS Sigurinë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të cilësisë më të lartë për klientët e saj. Ky angazhim ka qenë i orientuar drejt efikasitet të proceseve, duke siguruar që çdo shërbim dhe produkt të përmbushë nevojat dhe kërkesat e klientëve, dhe gjithashtu të ofrojë vlera të shtuar për ta.

## Përmirësimi i bashkëpunimit dhe ofrimi i produkteve të ndërlidhura

Një nga prioritetet kryesore gjatë vitit ka qenë forcimi i bashkëpunimit midis Bankës Ekonomike dhe KS Sigurisë, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të produkteve të gërshetuara që ofrojnë përfitime për klientët. Kjo ka përfshirë zhvillimin e mundësive të reja për ofrimin e produkteve të sigurimit të lidhura me shërbimet bankare, si dhe përmirësimin e procesit të shërbimit ndaj klientëve, duke siguruar që çdo klient të ketë një përvojë të rehatshme dhe të besueshme.

## Kampanja të suksesshme për nxitjen e shitjeve dhe rritjen e bashkëpunimit

Për të rritur shitjet dhe për të nxitur bashkëpunimin mes Bankës Ekonomike dhe KS Sigurisë, gjatë vitit 2024 janë realizuar disa fushata dhe kampanja të përbashkëta për stafin dhe sektorët e bankës. Këto iniciativa kanë arritur rezultate pozitive, duke rritur jo vetëm shitjet e produkteve të përbashkëta, por edhe duke kontribuar në zgjerimin e numrit të klientëve të konsoliduar, një element kyç i harmonisë mes dy institucioneve.

## Forcimi i marrëdhënieve dhe krijimi i mundësive të reja për klientët

Ky proces i vazhdueshëm ka kontribuar në forcimin e marrëdhënieve mes Bankës Ekonomike dhe KS Siguria dhe ka krijuar mundësi të reja për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve që ofrojnë vlerë të shtuar për klientët. Duke shfrytëzuar këto mundësi, klientët kanë mundësinë të arrijnë qëllimet e tyre financiare në një

mënyrë të sigurt dhe të besueshme, duke pasur gjithashtu një mundësi për të përfituar nga një gamë e gjerë shërbimesh që përfshijnë sigurime, kredi dhe shërbime të tjera financiare.

**Plani për të ardhmen: zgjerimi i sinergjisë dhe inovacioni në shërbimet për klientët**

Për vitin 2025, Banka Ekonomike dhe KS Siguria do të vazhdojnë të punojnë për forcimin e mbështetjes reciproke mes tyre dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Plani për të ardhmen përfshin ofrimin e mundësive të reja për klientët, si dhe zhvillimin e një oferte më të pasur që do të mundësojë një përvojë më të mirë për klientët në të gjitha nivelet. Në këtë mënyrë, do të sigurohet që klientët të kenë qasje në shërbime dhe produkte të nivelit të lartë që mbështesin objektivat e tyre financiare dhe sigurojnë që ata të përfitojnë nga një shërbim i shkëlqyer.



Liqeni i Livoqit





Kalaja e Artanës

# ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE PËRKRAHJA E BIZNESIT

**Zhvillime të reja për një përvojë bankare më të lehtë dhe innovative**
**Një hap përpara – Produkte dhe shërbimë që transformojnë përvojën bankare**
Gjatë vitit 2024, Banka Ekonomike ka ndërmarrë një sërë përmirësimesh në produktet dhe shërbimet e saj, duke vënë theksin në zhvillim, lehtësimin e proceseve dhe krijimin e mundësive të reja për klientët. Përmes departamentit të zhvillimit të produkteve dhe përkrahjes së biznesit, janë bërë ndryshime që jo vetëm kanë lehtësuar operacionet bankare, por edhe kanë përmirësuar ndjeshëm përvojën e klientëve.

## Pagesa me këste për shpenzime më të menaxhueshme

Një nga ndryshimet kryesore ka qenë përfshirja e opsionit të pagesës me këste në kredit kartelë, duke i dhënë klientëve fleksibilitetin për të shpërndarë shpenzimet e tyre në periudha të menaxhueshme, duke lehtësuar menaxhimin e financave për klientët tanë. Ky zhvillim u mundëson klientëve një menaxhim më të mirë të financave personale, duke i ndihmuar të realizojnë blerje më të mëdha pa ndikim të menjëhershëm në buxhetin e tyre.

## Më shumë mbështetje për gratë në biznes

Në kuadër të përkrahjes së sipërmarrjes, është hartuar një program i dedikuar për gratë në biznes, me qëllim lehtësimin e qasjes në financa dhe krijimin e mundësive më të mëdha për zhvillimin e bizneseve të tyre. Ky program do të ndihmojë gratë sipërmarrëse të rrisin kapacitetet e tyre financiare dhe të forcojnë pozicionin e tyre në treg.

## Llogaria Studentore 16+, hapi i parë drejt pavarësisë financiare

Me synimin për të afruar të rinjtë me bankingun dhe menaxhimin e financave, Banka Ekonomike ka krijuar Llogarinë Studentore 16+. Ky produkt u mundëson të rinjve qasje më të lehtë në shërbimet bankare dhe një marrëdhënie më të strukturuar me financat e tyre. Me mirëmbajtje falas dhe debit kartelë, kjo llogari

është një hap i parë drejt edukimit financiar dhe pavarësisë ekonomike për gjeneratat e reja.

**Menaxhim më i lehtë i financave për bizneset**
Një tjetër lehtësim për klientët është përshkrimi i mjeteve në ATM, i cili u mundëson bizneseve të identifikojnë qartë deponimet e bëra nga agjentët e tyre të biznesit, në bazë të përshkrimit të vendosur në ATM-ët e Bankës Ekonomike. Kjo risi ka sjellë më shumë transparencë dhe lehtësi në menaxhimin e financave, duke e bërë procesin e deponimit më të qartë dhe më të sigurt.

**Thjeshtim i proceseve dhe më shumë efikasitet për klientët**
Për të përmirësuar përvojën e klientëve, Banka Ekonomike ka përditësuar të gjitha dokumentet e shërbimeve duke i bërë më të kuptueshme dhe më të lehta për përdorim. Po ashtu, është optimizuar procesi i hapjes së llogarisë për individë dhe biznese, duke reduktuar dokumentacionin e kërkuar dhe duke bashkuar disa dokumente në një kontratë të vetme. Ky ndryshim ka thjeshtuar ndjeshëm procedurat dhe ka ulur kohën e nevojshme për përfundimin e procesit të hapjes së llogarisë.

**Riorganizim për një shërbim më të përqendruar tek klienti**
Në kuadër të ndryshimit të përgjegjësive operacionale, është krijuar një pilot-projekt për riorganizimin e përgjegjësive në degë, ku menaxhimi i arkës dhe trezorit ka kaluar nga menaxheri i nëndegës (përgjegjësi për menaxhimin e parasë) tek zyrtarët e shitjes. Ky riorganizim, ka liruar menaxherët nga detyrat operacionale, duke u mundësuar atyre të përqendrohen më shumë në shitje dhe në rritjen e angazhimit me klientët.

**Fushata të reja për të nxitur përdorimin e kanaleve digjitale**
Si pjesë e strategjisë për të rritur përdorimin e kanaleve digjitale, Banka Ekonomike ka zhvilluar një sërë fushatash sezonale, të cilat kanë synuar rritjen e përdorimit të kartelave bankare, POS terminaleve dhe BEK mobile.
Të gjitha këto ndryshime janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Bankës Ekonomike për të sjellë shërbime më efikase, më të qasshme dhe më të përshtatura me nevojat e klientëve, duke ofruar një përvojë bankare të transformuar dhe më të lehtë për të gjithë.

# MENAXHIMI I RISKUT

## RRITJE, ZHVILLIM, BESUESHMËRI ME PRODUKTE TË REJA PËR MIJËRA KLIENT TË RINJË

**Menaxhimi i Riskut, Themel i Qëndrueshmërisë Financiare**

Menaxhimi i riskut është një nga shtyllat kryesore të strategjisë së Bankës Ekonomike, duke siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të institucionit. Gjatë vitit 2024, Banka ka vazhduar të forcojë dhe zhvillojë më tej mekanizmat e saj të menaxhimit të riskut, duke adresuar të gjitha ekspozimet kryesore financiare dhe operacionale. Këto veprime janë ndërmarrë në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe standardet ndërkombëtare të Komitetit të Baselit, duke garantuar një qasje të zhvilluar dhe të integruar në parandalimin dhe administrimin e rreziqeve.

Një nga përmirësimet më të rëndësishme ka qenë integrimi i teknologjive të avancuara në monitorimin dhe analizimin e riskut, duke zbatuar modele të reja analitike dhe mjete të automatizuara për vlerësimin dhe parashikimin e skenarëve të ndryshëm. Kjo ka mundësuar një identifikim më të hershëm të rreziqeve dhe marrjen e masave parandaluese në kohën e duhur.

# MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

**Menaxhimi i Riskut Kreditor, Një Portofol i Shëndoshë për një Stabilitet Afatgjatë**

Risku kreditor vazhdon të jetë një ndër sfidat më të rëndësishme për Bankën Ekonomike, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e portofolit dhe qëndrueshmërinë financiare. Gjatë vitit 2024, Banka ka avancuar në mënyrë të ndjeshme modelet e saj të analizës së riskut, duke implementuar metodologji të avancuara për vlerësimin e aftësisë paguese të huamarrësve dhe minimizimin e ekspozimeve të rrezikshme.

Në kuadër të përpjekjeve për të mbajtur një portofol të shëndoshë, janë aplikuar standarde më të larta për monitorimin dhe rishikimin e kredive, duke siguruar që ekspozimi i bankës të mbetet brenda kufijve të tolerancës së riskut, duke rishikuar ekspozimet kreditore me qëllim mbajtjen e një niveli të qëndrueshëm të kredive jo-performuese. Si rezultat i kësaj qasjeje proaktive, përmirësimi i cilësisë së kredive ka qenë i dukshëm, duke e ulur përqindjen e kredive jo-performuese (KJP) nga 2.37 përqind në fund të vitit 2023 në 2.06 përqind në dhjetor 2024.

# RISKU I LIKUIDITETIT

**Menaxhimi i Likuiditetit, Forcimi i Bazave Financiare**
Likuiditeti është një faktor kyç për qëndrueshmërinë financiare të çdo institucioni bankar. Banka Ekonomike ka vazhduar të mbajë një strukturë solide të likuiditetit, duke siguruar rezerva të mjaftueshme për të përballuar nevojat operacionale dhe kërkesat e klientëve.

Një nga faktorët kryesorë që ka ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit të likuiditetit është përbërja e depozitave, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre janë depozita me afat, duke i dhënë bankës një bazë të qëndrueshme financimi. Gjithashtu, banka ka tejkaluar kërkesat rregullatore për Raportin e Mbulimit të Likuiditetit (Liquidity Coverage Ratio – LCR) dhe standardet ndërkombëtare të Baselit, duke siguruar një balancë mesatare ndërmjet aktiveve likuide dhe kërkesave për financim.
**Ky rezultat është arritur përmes:**

- **Strukturës së depozitave me afat, të cilat përbëjnë një bazë të qëndrueshme financimi për Bankën. Klientët e Bankës vazhdojnë të preferojnë depozitat me afat të mesëm dhe të gjatë, duke i siguruar Bankës një nivel të qëndrueshëm të fondeve dhe një ekspozim më të ulët ndaj tërheqjeve të menjëhershme të depozitave.**

- **Politikës pro-aktive të menaxhimit të burimeve të financimit, duke siguruar që Banka të ketë rezerva të mjaftueshme të likuiditetit për të përmbushur kërkesat e klientëve dhe për të reaguar ndaj skenarëve të papritur të tregut.**

Për të ruajtur këtë ekuilibër, Banka ka zbatuar një strategji të ndryshme të menaxhimit të likuiditetit, e cila përfshin:

- **Investime në instrumente likuide, si obligacionet qeveritare dhe depozitat ndërbankare, për të siguruar qasje të shpejtë në fonde të disponueshme.**

- **Analiza të avancuara të stresit, për të simuluar skenarë të ndryshëm dhe për t'u përgatitur për çdo luhatje të mundshme në treg.**

- **Diversifikim të burimeve të financimit, duke zvogëluar varësinë nga një kategori e vetme klientësh apo burimesh financiare.**

# RISKU I TREGUT

## Risku i Tregut, Menaxhim i Kujdesshëm i Ekspozimeve

Risku i tregut, i cili përfshin luhatjet e normave të interesit dhe kursit të këmbimit, ka qenë një prioritet i rëndësishëm për Bankën Ekonomike gjatë vitit 2024. Përmes analizave të stresit dhe simulimeve të ndryshme, Banka ka vlerësuar ndikimin e ndryshimeve të tregut në pasqyrën e saj financiare dhe ka zbatuar masa për të kufizuar ekspozimin ndaj këtyre rreziqeve.

Në përputhje me praktikat më të mira të industrisë, Banka ka mbajtur një strukturë të balancuar të aktiveve dhe pasiveve, duke zvogëluar ndikimin e ndryshimeve të papritura në normat e interesit dhe duke ruajtur një stabilitet të qëndrueshëm financiar.

# RISKU OPERACIONAL

**Menaxhimi i Riskut Operacional, Efikasitet dhe Kontroll**
Gjatë vitit 2024, Banka ka vazhduar të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e riskut operacional, duke përmirësuar kontrollet e brendshme, optimizuar proceset dhe fuqizuar kapacitetet e stafit për të minimizuar gabimet dhe ndërprerjet operacionale.

Një nga përmirësimet kryesore ka qenë implementimi i një sistemi të avancuar të raportimit të incidenteve, i cili ka mundësuar një identifikim dhe përgjigje më të shpejtë ndaj sfidave të ndryshme operacionale.

# RISKU I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)

**Risku i Teknologjisë së Informacionit: Siguri dhe Inovacion**
Duke marrë parasysh rritjen e kërcënimeve kibernetike dhe rëndësinë e sigurisë së informacionit, Banka ka investuar ndjeshëm në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës ndaj sulmeve kibernetike.

Gjatë vitit 2024, janë zbatuar masa të reja sigurie, duke përfshirë:

- **Monitorim të vazhdueshëm të rrjeteve, për të identifikuar dhe parandaluar kërcënimet në kohë reale.**
- **Protokolle më të forta të qasjes, për të mbrojtur sistemet kritike dhe të dhënat e ndjeshme.**
- **Trajnime për stafin, për të rritur ndërgjegjësimin mbi sigurinë kibernetike dhe për të përmirësuar menaxhimin e rreziqeve teknologjike.**

**Përfundim - Një Qasje Proaktive për një Bankë më të Sigurt**

Viti 2024 ka qenë një vit i suksesshëm për Bankën Ekonomike në drejtim të menaxhimit të riskut. Strategjitë e aplikuara dhe përmirësimet e vazhdueshme në analiza, monitorim dhe parandalim kanë garantuar një stabilitet të qëndrueshëm dhe një performancë të fortë financiare. Për vitin e ardhshëm, Banka do të vazhdojë të përforcojë sistemet e saj të menaxhimit të riskut, duke adoptuar teknologji të reja dhe duke zbatuar strategji më të avancuara për minimizimin e ekspozimeve të mundshme.

# RISKU KREDITOR

## RRITJA, STABILITETI DHE PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE NË 2024

**Menaxhimi i Riskut Kreditor: Prioritet Kryesor për Stabilitetin dhe Performancën e Bankës**

Risku kreditor mbetet një nga faktorët më të rëndësishëm dhe të ndjeshëm për institucionet financiare, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin dhe performancën financiare të tyre. Ky risk përfshin mundësinë që klientët e bankës të mos i përmbushin detyrimet e tyre kreditor, duke çuar në humbje për institucionin. Prandaj, menaxhimi efikas dhe i kujdesshëm i këtij risku është një prioritet i jashtëzakonshëm për Bankën Ekonomike, duke synuar ruajtjen e ekuilibrit financiar dhe mbrojtjen nga rreziqet e mundshme.

**Performanca e Departamentit të Riskut Kreditor dhe Masat e Ndërmarra për Përmirësim**

Departamenti i Riskut Kreditor ka realizuar një vit të jashtëzakonshëm, duke shfaqur një performancë të shkëlqyer në menaxhimin e riskut të kredive. Puna e bërë ka kontribuar ndjeshëm në uljen e ekspozimit ndaj riskut dhe përmirësimin e cilësisë së portofolit kreditor. Masat e ndërmarra për monitorimin e riskut, si dhe

analiza të hollësishme të faktorëve kyç të rrezikut, kanë ndihmuar në ruajtjen e një ekuilibri të qëndrueshëm mes mundësive të kreditimit dhe mbrojtjes nga humbjet. Për të vazhduar përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi, banka do të adoptojë teknika moderne dhe të avancuara për menaxhimin e riskut kreditor. Kjo do të përfshijë përdorimin e modeleve analitike të avancuara dhe automatizimin e procesit të vlerësimit të kredive, duke siguruar një menaxhim më të shpejtë dhe më të saktë të riskut.

**Përmirësimi i Aftësive të Stafit dhe Trajnimi i Duhur**

Një tjetër aspekt i rëndësishëm gjatë vitit 2024 ka qenë trajnimi i stafit të Departamentit të Riskut Kreditor dhe analistëve kreditore. Banka ka organizuar trajnime të specializuara, të cilat kanë pasur fokus të veçantë analizimin e faktorëve kryesorë të riskut kreditor dhe teknikave të vlerësimit të riskut. Këto trajnime janë mbajtur me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit, në mënyrë që ata të jenë më të përgatitur për të menaxhuar dhe adresuar çdo situatë të mundshme që mund të lindë në këtë fushë.

**Menaxhimi i Limiteve dhe Diferencimi i Portofolit Kreditor**

Departamenti i Riskut Kreditor ka ndjekur me rigorozitet politikat e menaxhimit të limiteve kreditore, duke vendosur limite në përputhje me normat dhe standardet e brendshme të bankës. Ky proces ka ndihmuar në ruajtjen e një ekuilibri të duhur midis mundësive të kreditimit dhe minimizimit të riskut. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi ka qenë diferencimit i portofolit kreditor, duke minimizuar koncentrimin e aktiviteteve apo segmenteve të caktuara. Kjo strategji ka kontribuar në uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve dhe ka rritur qëndrueshmërinë e bankës në periudha të paqëndrueshme financiare.

**Kontrolli dhe Monitorimi i Kredive të Klasifikuara**

Performanca e përgjithshme e portofolit të kredive ka qenë e shkëlqyer, me një nivel të kontrolluar të kredive problematike. Përqindja e kredive të klasifikuara si me vonesa ka qenë në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe brenda standardeve të miratuara. Ky rezultat tregon një menaxhim të suksesshëm të kredive dhe një vëmendje të vazhdueshme për të parandaluar humbjet potenciale.

Përmirësimi i proceseve të monitorimit dhe ndërhyrja e hershme në rastet e riskut kanë ndihmuar në reduktimin e ekspozimit ndaj humbjeve të mundshme. Banka ka përdorur praktika të avancuara për të identifikuar çdo sinjal të mundshëm të problemeve dhe për të ndërhyrë në kohë për të zvogëluar ndikimin e këtyre problemeve.

## Plani për Vitin 2025: Përmirësimi i Analizës së Riskut dhe Forcimi i Kapaciteteve të Stafit

Si përfundim, Departamenti i Riskut Kreditor ka arritur të ruajë një standard të lartë të menaxhimit të riskut dhe të sigurojë qëndrueshmërinë financiare të institucionit. Për vitin 2025, fokusi do të jetë në përmirësimin e mëtejshëm të analizës së riskut, forcimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e strategjive efektive për menaxhimin e kredive. Me këtë qasje, banka synon të rrisë më tej performancën dhe të mbrojë institucionin nga çdo rrezik i mundshëm që mund të ndikojë në stabilitetin dhe zhvillimin e tij financiar.



Rugovë


Gjakovë

# PAGESAT DHE OPERACIONET

Banka Ekonomike ka vijuar përkushtimin e saj ndaj përmirësimit të shërbimeve bankare, duke zhvilluar dhe zbatuar projekte moderne që synojnë avancimin e proceseve operacionale dhe përmbushjen e kërkesave ligjore, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Falë kësaj qasjeje, Banka Ekonomike mbetet një konkurrent kyç në treg, duke u fokusuar në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së shërbimeve për të ofruar një përvojë bankare më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikase.

Si pjesë e strategjisë për modernizimin dhe dixhitalizimin e shërbimeve të pagesave, banka ka implementuar një sërë risish, përfshirë:

**SWIFT GO** – Një shërbim inovativ për pranimin e pagesave hyrëse ndërkombëtare, i cili rrit ndjeshëm efikasitetin dhe shpejtësinë e transaksioneve. Banka Ekonomike është banka e parë në Kosovë që ka implementuar këtë shërbim, duke ofruar një standard të ri në treg.

**Avancimin e platformës E-Banking**, duke ofruar transaksione më të shpejta, më të sigurta dhe më të lehta për klientët.

**Optimizimin e proceseve të brendshme**, duke reduktuar kohën e përpunimit të pagesave dhe duke automatizuar procedurat operacionale.

# TRANSFERET KOMBËTARE

Në vitin 2024, vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 22 përqind, duke u rritur nga 2.17 miliardë euro në 2.64 miliardë euro.

Transferet dalëse kombëtare të kryera në degë kanë pësuar një zvogëlim prej 1.2 përqind në shumë dhe 10 përqind në numër krahasuar me vitin 2023, duke reflektuar orientimin gjithnjë e më të madh të klientëve drejt platformave dixhitale. Platforma E-Banking ka shënuar një rritje mbresëlënëse:

**+37 përqind në numrin e transfereve**
**+32 përqind në vlerën totale të transfereve**

Gjatë vitit 2024, 69 përqind e të gjitha transfereve dalëse kombëtare janë realizuar përmes E-Banking, duke konfirmuar zhvendosjen e klientëve drejt kanaleve digjitale dhe rritjen e besimit në shërbimet online të bankës.

**FIGURA 13.**
Transfere kombëtare, hyrëse dhe dalëse;
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro



# TRANSFERET NDËRKOMBËTARE

Në vitin 2024, transferet ndërkombëtare kanë vazhduar të ndjekin trendin e rritjes, duke shënuar një rritje prej 24 përqind krahasuar me vitin paraprak.
Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse ndërkombëtare është rritur nga 526 milionë euro në vitin 2023 në 653 milionë euro në vitin 2024.
Përdorimi i E-Banking për pagesa ndërkombëtare ka pësuar një rritje domethënëse:

**+35 përqind në numrin e transfereve**
**+36 përqind në vlerën e transfereve**

Gjatë vitit 2024, 53 përqind e transfereve dalëse ndërkombëtare janë realizuar përmes E-Banking, duke treguar se klientët e bankës po adoptojnë një qasje më të avancuar dhe dixhitale ndaj shërbimeve bankare ndërkombëtare.

**FIGURA 14.**
Transfere ndërkombëtare, hyrëse dhe dalëse;
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro



# GARANCIONET DHE LETËRKREDITË NDËRKOMBËTARE

Viti 2024 ka shënuar një rritje rekord në garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare, duke konfirmuar pozicionin e fuqishëm të Bankës Ekonomike në sektorin e tregtisë ndërkombëtare.
Rritje prej 213 përqind në totalin e garancioneve të lëshuara, krahasuar me vitin e kaluar. Ky sukses vjen si rezultat i strategjisë së zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare, përmirësimit të proceseve operacionale dhe përkushtimit të bankës për të mbështetur bizneset dhe klientët në transaksionet e tyre ndërkombëtare.

**FIGURA 15.**
Garancionet dhe Letërkreditë ndërkombëtare ndër vite.
Të gjitha shifrat janë në '000 Euro



## PËRMBYLLJE

Me një vizion të qartë për inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm, Banka Ekonomike ka arritur të:
Modernizojë proceset e pagesave dhe të rrisë efikasitetin e shërbimeve të saj.
Zgjerojë përdorimin e kanaleve digjitale, duke krijuar një përvojë më të shpejtë dhe më të thjeshtë për klientët.
Ruajë pozicionin në treg, duke sjellë risitë më të fundit në sektorin bankar.
Duke qenë pionier në aplikimin e shërbimeve të avancuara, Banka Ekonomike do të vazhdojë të sjellë zgjidhje financiare inovative, të përmirësojë shërbimet për klientët dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të Kosovës!



Malet e Sharrit



# KARTELAT BANKARE

**KARTELAT DHE TEKNOLOGJIA QË PO NDRYSHON FRYMËN E PAGESAVE NË KOSOVË, ME KARTELË NË POS PO TRANSFORMOHET FRYMA E TRANSAKSIONEVE**

**Një Vit i Suksesshëm për Kartelat dhe Pagesat Digjitale**

Banka Ekonomike vazhdon të jetë një konkurrent kyç në sektorin e shërbimeve financiare, duke ofruar një gamë të gjerë të kartelave debitore dhe kreditore për klientët brenda dhe jashtë vendit. Kjo ka sjellë një rritje të ndjeshme në përdorimin e kartelave, me një rritje prej 24 përqind të kartelave debitore dhe 11 përqind të kartelave kreditore në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkohë, kartelat lokale të skaduara janë zëvendësuar me kartela të skemave ndërkombëtare të pagesave dhe numri i tyre është në rënie, duke sjellë një përmirësim të dukshëm në ofertën tonë. Gjatë vitit 2024, klientët tanë kanë realizuar 3.2 milion transaksione, me një vlerë prej 414 milion EUR, një rritje prej 28.46 përqind në numër transaksionesh dhe 35.75 përqind në qarkullim krahasuar me vitin 2023. Veçanërisht, blerjet me kartelë janë rritur me 52 përqind në numër dhe 48 përqind në volum, ndërsa depozitat përmes ATM-ve kanë njohur një rritje rekord prej 53.06 përqind në numër dhe 70.03 përqind në volum.



Bajgorë

## ATM-të dhe POS Terminalet – Rritje dhe Përmirësime

Banka ka zgjeruar rrjetin e saj të ATM-ve, duke arritur në 66 ATM, me 13 të reja të shtuara gjatë vitit. Tani, të gjitha degët dhe nëndegët kanë ATM që u mundësojnë klientëve të bëjnë depozitime direkte në llogaritë e tyre.

Një veçori e re për klientët është mundësia për të zgjedhur arsyen e deponimit gjatë transaksionit, duke e bërë procesin më të personalizuar dhe të lehtë për menaxhim. Për më tepër, Banka ka integruar edhe marketing në ATM, duke promovuar fushatat\kampanjat dhe shërbimet e saj drejtpërdrejt përmes këtyre pajisjeve.

Në anën tjetër, Banka ka rritur edhe praninë e saj në treg me 1,810 POS terminale në 1,609 pika shitje, ndërsa numri i tregtarëve që pranojnë pagesa përmes POS-ve ka arritur në 678. Për herë të parë, gjatë vitit 2024, klientëve u është ofruar mundësia e blerjeve me këste përmes POS terminaleve, një shërbim modern që do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e mëtejshme të përdorimit të kartelave të kreditit dhe POS terminaleve.

Si rezultat, transaksionet e realizuara përmes POS terminaleve të Bankës Ekonomike kanë arritur 2.9 milion, një rritje rekord prej 1251 përqind krahasuar me vitin 2023, ndërsa vlera e qarkullimit ka arritur në 57 milion EUR, ose 1092 përqind më shumë se një vit më parë.

## Fokusi në Sigurinë e Informacionit

Në fund të vitit 2024, Banka ka filluar implementimin e një projekti strategjik për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar një mbrojtje më të fortë kundër rrjedhjes së informatave dhe rreziqeve kibernetike. Ky projekt është pjesë e strategjisë sonë për një banking më të sigurt dhe më inovativ dhe do të përfundojë gjatë vitit 2025.

Banka Ekonomike vazhdon të jetë një lider në inovacionin e pagesave dhe sigurisë financiare, duke sjellë shërbime më të lehta, më të sigurta dhe më të përshtatshme për klientët e saj.

# TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

## Siguri, Inovacion dhe Besueshmëri

Në një epokë ku teknologjia është forca shtytëse e çdo inovacioni, Banka Ekonomike e ka vendosur sigurinë, besueshmërinë dhe zhvillimin e produkteve e shërbimeve inovative në qendër të strategjisë së saj për Teknologjinë e Informacionit.

Gjatë vitit 2024, ekipi i TI-së ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe për të sjellë risi që i bëjnë transaksionet më të lehta dhe më të sigurta për klientët tanë. Disa nga përmirësimet kyçe përfshijnë:

- Zhvillimin e mëtejshëm të **Mobile Banking**, duke sjellë një përvojë më të afërt me bankën dhe funksione të reja për përdoruesit.
- **Kreditë me kartelë në këste**, një produkt që ofron fleksibilitet më të madh financiar.
- **Swift Go**, një shërbim që mundëson transferta ndërkombëtare më të shpejta dhe më të sigurta.
- Funksione të reja në **e-Banking**, ku klientët tani mund të:
- Shikojnë gjendjen e kursimeve të tyre në TRUST.
- Menaxhojnë llogaritë e fëmijëve të tyre.
- Marrin përshkrime të detajuara të depozitave të realizuara në ATM.
- Gjejnë më lehtë degët, POS-at dhe ATM-të në të gjithë territorin e Kosovës përmes një harte të zgjeruar dhe të përditësuar.

Për të garantuar që të gjitha këto shërbime funksionojnë me efikasitet maksimal, Banka ka investuar në pajisje të avancuara dhe sisteme të sigurisë që forcojnë mbrojtjen e të dhënave dhe disponueshmërinë e shërbimeve. Për më tepër, janë zbatuar projekte që:

- Rrisin efikasitetin e punës, duke optimizuar proceset e brendshme.
- Përmirësojnë cilësinë e të dhënave, duke mundësuar vendimmarrje më të saktë dhe më të shpejtë.

· Forcojnë kontrollin mbi proceset e brendshme, për një operim më të sigurt dhe të standardizuar.

Teknologjia nuk është forca që po transformon bankat! Në Bankën Ekonomike, ne vijojmë të investojmë në risitë teknologjike, duke e bërë bankingun më të sigurt, më të shpejtë dhe më të lehtë për të gjithë klientët tanë.

## Kërcënimet Kibernetike Banka Ekonomike Forcon Mbrojtjen e të Dhënave, klientëve dhe sistemit

Në një kohë kur informacioni është bërë një nga asetet më të vlefshme, siguria e të dhënave dhe ruajtja e privatësisë kanë qenë prioritete kyçe për organizatën tonë gjatë vitit të kaluar.

Siguria e informacionit nuk është thjesht një masë mbrojtëse, por strategji e domosdoshme për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Për këtë arsye, ne kemi ndërmarrë masa të vazhdueshme dhe moderne të zhvilluara për të mbrojtur sistemet tona nga kërcënimet, qofshin ato të brendshme apo të jashtme.

Gjatë vitit 2024, Banka ka forcuar masat e saj të mbrojtjes, duke zbatuar një sërë iniciativash:

### 1. Politikat dhe Procedurat e Sigurisë

· Përditësimi i politikave dhe rregulloreve dhe procedurave të sigurisë sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

· Zbatimi i protokolleve të reja për menaxhimin e fjalëkalimeve dhe aksesit të përdoruesve, duke siguruar një mbrojtje më të fortë ndaj sulmeve kibernetike.

· Rregulla më të rrepta për përdorimin e pajisjeve të jashtme, duke kufizuar rreziqet e viruseve të ndryshme.

### 2. Trajnimi dhe Ndërgjegjësimi i Stafit

· Një Bankë e sigurt fillon nga njerëzit e saj, prandaj, kemi investuar në trajnime të specializuara për punonjësit mbi rreziqet kibernetike dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e informacionit.

· Përmes simulimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të rregullt të sulmeve të mundshme sociale (phishing), kemi ndihmuar në reduktimin e rrezikut të mashtrimeve dhe sulmeve me inxhinieri sociale.

**3. Mbrojtja ndaj Malware dhe Sulmeve Kibernetike (Viruseve)**

· Kemi implementuar zgjidhje të avancuara të mbrojtjes, duke përfshirë softuerë të fuqishëm kundër viruseve dhe malware, të cilët ofrojnë monitorim në kohë reale të çdo aktiviteti të dyshimtë.

· Sistemet tona janë përditësuar vazhdimisht për të adresuar rrezikshmëritë e reja, duke qëndruar hap për hap me evolucionin e kërcënimeve kibernetike.

**4. Monitorimi dhe Auditimi i Sistemeve**

· Kemi rritur monitorimin e mbikëqyrjes së rrjeteve për të detektuar në kohë çdo tentativat për shkelje të sigurisë.

· Auditime të rregullta të sigurisë, për të siguruar që masat e mbrojtjes janë efektive dhe për të identifikuar hapësira për përmirësime të vazhdueshme.

**E Ardhmja e Sigurisë, Angazhimi ynë Vazhdon**

Siguria e informacionit nuk është një mision i përmbyllur, por një përkushtim i vazhdueshëm. Me teknologji gjithnjë e më komplekse dhe kërcënime që evoluojnë çdo ditë, ne do të vazhdojmë të investojmë në zgjidhje të avancuara dhe praktika të sigurta, duke garantuar që çdo e dhënë është e mbrojtur.

Besimi i klientëve dhe partnerëve tanë është aseti ynë më i çmuar – dhe ne do të sigurojmë që ai të qëndrojë i pacenuar!





Ujvara e Radacit

# MENAXHIMI DHE TRAJNIMI I PERSONELIT

## Një ekip i fortë, një bankë që rritet!

## Menaxhimi dhe zhvillimi i personelit në Bankën Ekonomike

Në Bankën Ekonomike, ne e dimë se suksesi nuk matet vetëm me shifra, por edhe me njerëzit që e bëjnë të mundur çdo arritje. Prandaj, investimi ynë më i rëndësishëm mbetet ekipi, duke tërhequr talentet më të mira për pozitat respektive, duke zhvilluar aftësitë e tyre dhe krijuar një ambient pune që frymëzon, gjithmonë duke u ofruar mundësi zhvillimi brenda institucionit.

Gjatë vitit 2024, jo vetëm që kemi zgjeruar skuadrën tonë, duke arritur 427 punonjës, por kemi punuar intensivisht që çdo anëtar i stafit të ndiejë vlerësimin dhe mbështetjen për rritje profesionale.
Për këtë arsye, kemi organizuar trajnime të specializuara, aktivitete rekreative dhe kemi vijuar traditën e ndarjes së mirënjohjeve për ata që kanë qëndruar me ne për 10 dhe 20 vite, një dëshmi e fortë se Banka Ekonomike mbetet një punëdhënës i përkushtuar ndaj njerëzve të saj. Banka Ekonomike vazhdon të jetë punëdhënës atraktiv me kulturë organizative dhe ambient të mirë të punës.

Po aq të rëndësishëm sa përvoja janë edhe talentet e reja. Në bashkëpunim me universitetet, këtë vit kemi mirëpritur 72 studentë dhe të sapodiplomuar, kryesisht me fushë studimi ekonominë, administratën si dhe në teknologji informative duke u dhënë atyre mundësinë të përfshihen në projekte reale brenda bankës. Dhe më e mira, nga ky program i studentëve karrierën me bankën tonë e kanë vazhduar mbi 29 studentë të profileve të ndryshme.

Si pjesë e integruar e strategjisë sonë për të punësuarit, trajnimi dhe zhvillimi brenda Bankës Ekonomike luan një rol kryesor në ndërtimin e aftësive dhe

shkathtësive për të ardhmen. Në një treg që ndryshon vazhdimisht, ne e dimë se të qëndruarit përpara kërkon përkushtim ndaj dijes. Prandaj, gjatë vitit 2024 kemi investuar në zhvillimin e punonjësve tanë përmes trajnimeve që mbulojnë gjithçka, nga aftësitë teknike dhe menaxheriale deri te përditësimi me politikat dhe procedurat më të fundit të sektorit bankar.

Për të sjellë eksperienca të reja dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi ndërkombëtar, përfaqësuesit tanë kanë marrë pjesë në samite të rëndësishme në Paris, Pragë, Mynih, La Hulpe dhe qendra të tjera financiare, duke u kthyer me ide dhe praktika që do ta çojnë bankën edhe më përpara.

Dhe sigurisht, asnjë organizatë nuk rritet pa liderë të aftë. Këtë vit kemi vijuar fuqizimin e drejtuesve tanë, duke i përgatitur ata për të ndërtuar ekipe të suksesshme dhe për të udhëhequr me vizion dhe integritet.

Në Bankën Ekonomike, ne nuk ofrojmë vetëm një vend pune – ne krijojmë mundësi, nxisim zhvillimin dhe ndërtojmë së bashku një të ardhme më të fortë!




Gjeravicë

# PAJTUESHMËRIA E PËRGJITHSHME

## MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE FORCIMI I KONTROLLIT TË BANKËS

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Rajtueshmërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit të Bankës në përputhje me kërkesat ligjore, duke forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe promovuar një kulturë të avancuar të ruajtjes në të gjitha nivelet organizative. Ky departament ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar që të gjitha aktivitetet dhe operacionet e Bankës të jenë në përputhje të plotë me standardet e kërkuara nga organet ligjore, duke u përqëndruar në rritjen e transparencës dhe integritetit të proceseve të brendshme.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua monitorimit dhe vlerësimit të mbrojtjes duke identifikuar dhe adresuar rreziqet që mund të dëmtonin reputacionin dhe funksionimin e Bankës.
Për këtë arsye, është realizuar një analizë e thelluar e proceseve dhe praktikave ekzistuese, duke zbuluar mundësi për përmirësimin e vazhdueshëm. Si pjesë e kësaj nisme, u zhvillua një program i trajnimeve dhe edukimit të stafit me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive në fushën e mbrojtjes, duke i mundësuar stafit të Bankës që të përmbushë me sukses rregullat dhe kërkesat ligjore.

Në përpjekjet për të forcuar kontrollin e brendshëm dhe për të mbrojtur të dhënat personale, është punuar intensivisht në menaxhimin e dokumentacionit të brendshëm. Ky proces ka përfshirë standardizimin dhe përditësimin e politikave dhe procedurave institucionale, duke siguruar që të gjitha praktikat të jenë të përditësuara dhe në përputhje me kërkesat më të fundit ligjore.

Kjo ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në menaxhimin e informacionit të brendshëm dhe ka minimizuar mundësitë për gabime ose shkelje të mundshme.

Për të mbështetur përpjekjet për mbrojtjen e të dhënave personale, janë ndërmarrë iniciativa edukative dhe masa të përmirësuara mbrojtëse. Këto përfshijnë trajnime të specializuara për punonjësit, që fokusohen në rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit dhe përputhshmërisë me rregullat për mbrojtjen e të dhënave, si dhe implementimin e masave teknologjike të avancuara për mbrojtjen e të dhënave sensitive të klientëve dhe punonjësve.

Nëpërmjet këtyre masave, Departamenti i Rajtueshmërisë ka kontribuar në forcimin e pozicionit të Bankës si një institucioni financiar i besueshëm, i cili respekton në mënyrë rigoroze normat ligjore dhe etikën profesionale, duke ruajtur integritetin dhe reputacionin e saj në treg.
Kjo qasje ka siguruar që Banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj ligjore dhe mbrojtëse, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për të gjithë klientët dhe partnerët e saj.




Prishtinë

# PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Përgjegjësia sociale nuk është thjesht një angazhim për Bankën Ekonomike, është puna jonë e përditshme dhe e palodhshme, vlera që na udhëheq dhe forca që na motivon për të krijuar ndryshim. Për ne, të jemi një bankë e suksesshme nuk do të thotë vetëm rritje financiare, por edhe ndikim pozitiv në shoqëri, në komunitetet që prekim dhe në mjedisin ku jetojmë.

**Një vit i mbushur me angazhim dhe ndikim**

Gjatë vitit 2024, kemi investuar shumë projekte të rëndësishme që kanë prekur drejtpërdrejt jetën e njerëzve në fusha kyçe si arsimi, shëndetësia, sporti dhe kultura. Këto projekte nuk kanë qenë vetëm mbështetje financiare, por edhe një angazhim i plotë me vizionin tonë, për të siguruar suksesin dhe jetëgjatësinë e tyre.

**Më shumë sesa ndihmë, një shtysë drejt së ardhmes**

Banka Ekonomike nuk ndalet vetëm tek financimi i projekteve. Por edhe ndërtimi i urave të bashkëpunimit, krijojmë mundësi dhe ndihmojmë në formësimin e një shoqërie më të drejtë e të qëndrueshme. Çdo iniciativë që mbështesim synon të lërë një gjurmë të përhershme, të fuqizojë individët dhe të sjellë ndryshime të prekshme.

**Të ndërtojmë të ardhmen e vendit tonë, më mirë për të gjithë!**

Përgjegjësia sociale është një nga misionet tona më serioze, dhe për këtë arsye nuk do të ndalemi këtu. Me përkushtim dhe vizion, do të vazhdojmë të fuqizojmë komunitetet, të mbështesim kauza me ndikim dhe të krijojmë një realitet më të mirë për të gjithë.

Edhe tutje ne do të ndajmë me ju histori frymëzuese nga projektet tona, ndikimin e tyre në shoqëri dhe planet tona për të ardhmen. Sepse një bankë nuk është vetëm një institucion financiar,  ajo është një forcë për ndryshim!

## MBËSHTETJA PËR SPORTIN

Në Bankën Ekonomike, sporti është mënyra për ndërtimin e një komuniteti më të fortë, për të frymëzuar gjeneratat e reja dhe për të krijuar një mjedis ku pasioni dhe përkushtimi bëhen rruga drejt suksesit.

### Një vit i mbushur me mbështetje dhe investime në sport

Gjatë vitit 2024, kemi vazhduar me përkushtim mbështetjen tonë për sportin në mbarë Kosovën, duke investuar në shumë klube sportive në disiplina të ndryshme, përfshirë futbollin, hendbollin, volejbollin, ping pongun artet marciale dhe shumë të tjera. Ky angazhim është një përkushtim për të ndihmuar sportin vendas të rritet, të zhvillohet dhe të arrijë nivele të reja.

### Investim për të ardhmen

Duke krijuar kushte më të mira për talentet e reja dhe duke fuqizuar garën sportive, ne po kontribuojmë në rritjen e cilësisë dhe konkurrencës në sportin vendor. Mbështetja jonë synon të krijojë një mjedis ku sportistët të kenë hapësirën dhe mundësitë për të shpalosur potencialin e tyre të plotë, duke nxitur gjithashtu ndërgjegjësimin për rëndësinë e aktivitetit fizik në jetën e qytetarëve.

### Sporti është forcë, bashkim dhe pasion që mbështetjen e gjen tek Banka Ekonomike!

Ky është vetëm fillimi i një rrugëtimi të gjatë. Do të vijojmë të mbështesim sportin, të investojmë në talentet e reja dhe të krijojmë mundësi për të gjithë ata që e shohin sportin si një rrugë për një të ardhme më të ndritur

Në vazhdim, do të ndajmë histori suksesi nga klubet dhe sportistët që kemi mbështetur, duke treguar se si angazhimi ynë ka ndihmuar në fuqizimin e sportit në Kosovë. Sepse kur sporti lulëzon, lulëzon edhe shoqëria!Duke parë nevojën për mbështetje të klubeve me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për punë, kemi vazhduar me mbështetjen e 46 klubeve në mbarë Kosovën, si: **KB Rahoveci, KH Rahoveci, KB Vëllaznimi, KFC Vëllaznimi, FC Malisheva, KF Gjakova, Klubi i Hendbollit, Vushtrria - Femrat, Klubi i Hendbollit Vushtrria – Meshkujt, KF Trepça 89, KB Trepça, Klubi i Hendbollit Trepça-M, KPP Lidhja e Prizrenit, KB Bashkimi, Klubi i Karatesë - Eagle Karate, KBF Bashkimi (femrat), Klubi i Shahut Sharri,**

**KF Kosovari, KF Drenasi, Kv Feronikeli, K.F. Llapi 1932 Sh.p.k, KV Ulpiana, KF Flamurtari, 2 Korriku, FC KEK, KF Shkëndija Hajvali, Skijimi, KV Prishtina Elite, TOP Futboll, Federata e Golfit të Kosovës, Federata e Tenisit të Kosovës, Klubi i Volejbollit Prishtina Femrat, Klubi i Volejbollit M-technologie, Klubi i Atletikës Dardania, Klubi i Shenjtërisë dhe Shigjetarisë, Tenis Hajvali, Akademia Taekëondo Hapkido Tiger, FC Ferizaj, KVF Klubi i Volejbollit, Klubi i Hendbollit Ferizaj, KF Lepenci, KB Istogu, KB Peja, KVF Drita, FC Drita SHPK, SC Gjilani, Klubi i Volejbollit FENIKS Kamenice, Kv Peja , Klubi i Atletikës Burimi, Klubi i Handbollit Prishtina, Klubi Skitar Priski, Klubi I Volejbollit Prishtina 75.**

Angazhimi ynë në sport shpreh vlerat e Bankës Ekonomike në përkrahje të zhvillimit të komunitetit dhe promovimit të një stili jetese të shëndetshme. Përmes kësaj përpjekje të vazhdueshme, ne synojmë të krijojmë një mjedis më të mirë për të gjithë qytetarët dhe të përcaktojmë një standard të lartë të kontributit tonë shoqëror dhe kulturor në Kosovë.








KV
FERIZAJ
2014

Banka
Ekonomike

REDONI



TOURNAMENT




ELBAU


Banka
Ekonomik



Banka
Ekonomike

FVK
KV ULPIANA
LIPJAN 1999
EXFIS

Banka
Ekonomike
eurokoha
SWISS

Banka
Ekonomike
Mendon për ty!

26

Banka
Ekonomike

Banka
Ekonomike
Mendon për ty!

Banka
Ekonomike

## Banka Ekonomike mbështet Ulpiana Fest: Zgjimi i Ndërgjegjes për Trashëgiminë Kulturore

Banka Ekonomike është krenare që mbështet **Ulpiana Fest**, festivalin e parë të këtij lloji në Kosovë. Ky festival synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe të promovojë pasurinë e saj arkeologjike. Përmes kombinimit të shkencës dhe artit, publiku ka mundësinë të mësojë më shumë për jetën e banorëve të Dardanisë së lashtë.
**Ulpiana Fest** bashkon arkeologjinë, antropologjinë, etnografisë dhe artin, duke krijuar një spektakël unik që lidh të shkuarën me të tashmen. Rrënjët e historisë dhe vlerat moderne ndërthuren për të krijuar një përvojë të paharrueshme. Si pjesë e përkushtimit tonë për të mbështetur iniciativat kulturore, Banka Ekonomike kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e identitetit dhe trashëgimisë sonë për brezat e ardhshëm.



## Dita Botërore e Pastrimit: Banka Ekonomike dhe Siguria për një Mjedis më të Pastër



Banka Ekonomike dhe Kompania e Sigurimeve Siguria bashkojnë forcat për të mbështetur nismën “Let’s Do It Kosova” në Ditën Botërore të Pastrimit. Duke marrë pjesë aktivisht në pastrimin e hapësirave publike, ne tregojmë përkushtimin tonë ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për komunitetin.

Ky angazhim është pjesë e përgjegjësisë sonë sociale për një të ardhme të qëndrueshme. Banka Ekonomike dhe Siguria do të vazhdojnë të mbështesin projekte që fuqizojnë komunitetin dhe mbrojnë mjedisin tonë.

## Dhurimi i Gjakut: Një Akt Shprese dhe Solidariteti

Banka Ekonomike dhe Kompania e Sigurimeve Siguria vazhdojnë traditën e tyre të gjatë të dhurimit vullnetar të gjakut, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve. Kjo iniciativë është shumë më tepër sesa një akt bamirësie; është një shprehje e vërtetë humanizmi dhe shprese për ata që kanë më shumë nevojë. Ne besojmë se çdo pikë gjaku i dhuruar ka fuqinë të bëjë një ndryshim të madh në jetën e dikujt. Përmes përgjegjësisë sociale, ne do të vazhdojmë të mbështesim këtë kauzë humane.



**Opera në Rrota: Një Rrugëtim Operistik për Fëmijët**

Banka Ekonomike dhe Siguria ishin sponsorë kryesorë të projektit unik “Opera në Rrota,” realizuar nga Fondacioni Rame Lahai në bashkëpunim me Opera e Kosovës. Ky projekt sjell magjinë e operës tek fëmijët në gjashtë komuna të Kosovës:

- 15 Shtator – Istog
- 16 Shtator – Pejë
- 17 Shtator – Gjakovë
- 18 Shtator – Gjilan
- 19 Shtator – Mitrovicë
- 20 Shtator – Prishtinë



## Rialokimi i Degës së Bankës Ekonomike në Obiliq: Një Përkushtim për Zhvillim




Banka Ekonomike ka rialokuar degën e saj në Obiliq në një vendndodhje të re dhe më të përshtatshme, në Rrugën “Hasan Prishtina”. Kjo lëvizje është një dëshmi tjetër e përkushtimit tonë për t’u ofruar klientëve tanë shërbime me qasje më të lehtë dhe moderne.

Me një ambient të ri dhe të përshtatur për nevojat bashkëkohore, ne synojmë të jemi gjithmonë pranë jush, aty ku ndodheni dhe kur keni nevojë. Ejani dhe vizitoni degën tonë të re, ku ekipi ynë është i gatshëm t’ju ofrojë një përvojë të jashtëzakonshme bankare.

## Banka Ekonomike rialokon degën në Mitrovicë



Banka Ekonomike, është e përkushtuar për të qenë pranë jush, ku jeni dhe kur keni nevojë. Me këtë frymë, jemi krenarë të ju njoftojmë se dega jonë në Mitrovicë është rialokuar në një adresë të re dhe më të përshtatshme! Ky hap është një tjetër dëshmi e angazhimit tonë për të përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet tona për ju.

Ju mirëpresim në degën tonë të re në adresë Rr. Shemsi Ahmeti,ku kemi sjellë një ambient të ri dhe modern për të plotësuar çdo nevojë bankare që keni. Ekipi ynë është i gatshëm të ju presë në hapësirën tonë të re. Ejani, vizitoni dhe ndjeni ndryshimin



## Prizren Fest

Ky festival na sjell së bashku për të festuar kulturën, artin dhe trashëgiminë e bukur të qytetit të Prizrenit me aktorë, regjisorë dhe pasionistë të artit teatror.
Si partnerë të përkushtuar, ne mbështesim nismat që promovojnë vlerat tona dhe fuqizojnë lidhjet tona për të zhvilluar kulturën dhe artin në vendin tonë. Jemi të lumtur që mund të krijojmë mundësi për publikun të përjetojë performancat e mrekullueshme teatrale të këtij festivali. Prizren Fest do të mbahet nga data 21 deri më 28 Korrik dhe do të ofrojë shfaqje të shumta teatrore nga vende të ndryshme pjesëmarrëse, si Kosova, Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Franca, Çekia, Bullgaria, Irani, Italia, Greqia, Spanja dhe Maqedonia e Veriut. Përveç shfaqjeve, festivali do të promovojë edhe trashëgiminë kulturore dhe monumentet e shumta të Prizrenit. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes, Kryeshefi Ekzekutiv

Shpend Luzha theksoi: “Ne jemi krenarë që mbështesim Prizren Fest për të dytin vit me radhë. Ky festival është një dëshmi e fuqisë së kulturës për të bashkuar njerëzit dhe për të promovuar vlerat në vendin tonë. Jemi krenarë që jemi pjesë e Prizren Fest dhe shpresojmë që ky bashkëpunim të sjellë emocion, frymëzim dhe përvoja të jashtëzakonshme për të gjithë ata që do të marrin pjesë.” Ndërsa drejtori gjeneral i festivalit, Shkelzen Vaseli, vazhdoi me: “Si drejtor i festivalit jam i lumtur dhe kam kënaqësinë që në një festival ndërkombëtar të teatrit kemi partneritet për të dytin vit me radhë me një bankë vendore me vlera siç është Banka Ekonomike


Banka Ekonomike
Banka Ekonomike

## Banka Ekonomike nënshkruan marrëveshjen për Dritarën për Investime të Diasporës

Banka Ekonomike ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) për Dritaren për Investime të Diasporës. Kjo iniciativë, e cila filloi më 16 korrik, është rezultat i një marrëveshjeje trepalëshe të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID-i. Marrëveshja synon të tërheqë investimet nga diaspora dhe të lehtësojë qasjen në financa për bizneset e diasporës që dëshirojnë të investojnë në Kosovë. Banka Ekonomike është e përkushtuar në mbështetjen e kësaj iniciative, duke u bërë partner në këtë skemë të re garantuese. Qëllimi ynë është të ndihmojmë në krijimin e mundësive të reja investimi dhe të mbështesim rritjen ekonomike në vend.



**Rialokimi i nëndegës Prizren**

Banka Ekonomike është e orientuar ndaj kujdesit për ju në plotësimin e nevojave tuaja, në çdo vend ku ju ndodheni. Krahas këtij qëllimi ju njoftojmë se nëndega jonë në Prizren është rialokuar. Nëndega e re ndodhet në adresën“ Rruga Prizreni 1 P4, Prizren, Republika e Kosovës Kjo zhvendosje është një hap tjetër thelbësor drejt ofrimit të shërbimeve sa më efikase të cilat janë prioriteti ynë për tu siguruar që të jemi sa më pranë juve kudo që ndodheni. Ekipi ynë është i gatshëm të ju pres në hapjen e re. Ejani na vizitoni dhe ndjeni ndryshimin! Banka Ekonomike, Mendon për ty



## Vizita nga fëmijët e Kopshtit Ama

Filluam ditën me një vizitë nga fëmijët e Kopshtit Ama, të cilët kishin një energji dhe një dëshirë të madhe për të mësuar dhe eksploruar botën rreth tyre. Fëmijët, na sollën gëzim dhe freski në ambientin tonë, duke na bërë të ndjehemi të lumtur dhe të mbushur me energji pozitive që nga fillimi i ditës.

Me anë të aktiviteteve argëtuese dhe mësimore, u përpoqëm t'i inspirojmë ata të mendojnë për të ardhmen dhe të kuptojnë se sa e rëndësishme është të kursejnë për gjërat që duan.



## Java Ndërkombëtare e Parasë

Banka Ekonomike ka shënuar Javën Ndërkombëtare të Parasë me një sërë aktivitetesh të përkushtuara për fëmijët. Këtë vit, fëmijët e Kopshtit Eni Edu Ars kanë pasur mundësinë të vizitojnë ambientet e Bankës Ekonomike, ku janë njohur me proceset dhe aktivitetet e përditshme të bankës. Përmes kësaj vizite, ata kanë mësuar rreth rëndësisë së kursimit dhe menaxhimit të financave personale që nga një moshë të re. Gjithashtu, Banka Ekonomike ka organizuar vizita në disa shkolla në shtatë qytetet kryesore të Kosovës, duke ju ofruar ligjërata argëtuese rreth rëndësisë së kursimit që në fëmijëri. Përmes kësaj iniciative, Banka Ekonomike synon të ndihmojë në ndërtimin e një kulture të mirëqenies financiare që do të ndihmojë në zhvillimin e jetës financiare të ardhshme të fëmijëve. Angazhimi i Bankës Ekonomike në promovimin e arsimit financiar dhe ndërgjegjësimit të financave personale do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke ofruar resurse dhe aktivitete të përshtatshme për të gjithë komunitetin.



## XP GAMES

Banka Ekonomike mbështeti edicionin e katërt të XP Game Fest 2024, një iniciativë e rëndësishme në fushën e zhvillimit të lojërave. Ky bashkëpunim synon të përforcojë ekosistemin e teknologjisë dhe inovacionit në vend, duke ofruar burime dhe mbështetje financiare për zhvilluesit e lojërave.
Me këtë partneritet, Banka Ekonomike shpreh përkushtimin e saj për të inkurajuar rritjen dhe zhvillimin e sektorit të lojërave dhe në promovimin e krijimtarisë dhe inovacionit.



## HIKING ME STAF

Banka Ekonomike organizoi një eksperiencë të mrekullueshme hikingu për stafin e bankës në Grykën Rugovës dhe shtegun Liqeneve në Kuqishtë dhe Drelaj.
Me ndihmën dhe guidat e Klubit Alpin Prishtina, të cilët i falenderojmë që e bënë këtë aktivitet më të sigurt dhe të këndshëm, stafi pati mundësinë të largohen nga rutina e përditshme e zyrës dhe të rikrijojnë lidhjen e tyre me natyrën dhe ambientin e jashtëm.
Ky udhëtim ishte një përvojë e jashtëzakonshme që do ta mbajmë gjatë në kujtesën tonë dhe do të na sjellë energji të reja dhe motivim për të përballuar sfidat e ardhshme.



## 1 QERSHORI

Me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve 1 Qershori, Banka Ekonomike ofroj aktivitete argëtuese dhe edukative për fëmijët e qytetit tonë.
Aktiviteti ynë përfshiu praninë e maskotave të animuara, maskotat ishin aty për të krijuar një atmosfere të gëzueshme dhe argëtuese, të cilat përcjellën ndjenjën e magjisë dhe sjellën buzëqeshje në fytyrat e fëmijëve, ngjyrosja e fytyrave si imazhet e tyre të preferuara. Gjithashtu u organizuan një seri lojërash të ndryshme edukative, ku fëmijët patën mundësinë të mësojnë dhe të argëtohen njëkohësisht, aktiviteti përfshiu edhe sesione vallëzimi për fëmijët, ku ata shprehën kreativitetin e tyre.





Ujvara e Mirushës

## BSIDES PRISHTINA

Banka Ekonomike për të tretin vit me radhë mbështet konferencën e Sigurisë së Informacionit organizuar nga Bsides Prishtina.
Konferencë dy ditore e sigurisë se informacionit e mbajtur për herë të tretë në Kosovë si pjesë e framework-ut të Security Bsides me seli në Amerikë, me qëllim që të mblidhen entuziastët e sigurisë kibernetike.
Banka Ekonomike vazhdon të i kushtojë rëndësi të veçantë Sigurisë së Informacionit për faktin se bankimi çdo ditë e më shumë gjenë shtrirjen në platforma te ndryshme digjitale.









Radavc - Pejë

## PËRKUSHTIMI I BANKËS EKONOMIKE NDAJ ARTIT DHE BARAZISË SOCIALE

Në përpjekjet e saj për të fuqizuar artin dhe për të promovuar barazinë sociale, Banka Ekonomike është sponsor i edicionit të 12-të të Festivalit FemArt. Kjo ngjarje unike ka transformuar Prishtinën në një qendër ndërkombëtare të kreativitetit dhe aktivizmit, duke mirëpritur mbi 200 artistë dhe aktivistë nga 20 vende të ndryshme.

Përgjatë gjashtë ditëve (25-30 shtator 2024), festivali, me temën e fuqishme "Motërzimi: Në Kohë Lufte dhe Paqe," u bë një platformë ku arti dhe aktivizmi u shkrinë në një, duke hapur rrugë për reflektim dhe ndryshim shoqëror. Nga shfaqjet teatrore te koncertet e mbushura me emocione, nga ekspozitat që sfidonin normat e deritanishme te panelet që nxirrnin në pah barazinë gjinore dhe drejtësinë sociale, festivali u kthye në një manifestim të vlerave universale për të drejtat e njeriut.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në këtë festival nuk ishte vetëm një sponsorizim; ishte një dëshmi e përkushtimit të saj ndaj ndërtimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të drejtë. Me këtë mbështetje, ne kemi treguar se arti nuk është vetëm një mjet krijues, por edhe një forcë transformuese për barazinë gjinore dhe drejtësinë sociale. Për Bankën Ekonomike, ky bashkëpunim reflekton vlerat tona më të larta për të investuar në kulturë dhe për të nxitur dialogun që na çon drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të barabartë.

Ne jemi këtu për të qëndruar pranë çdo nisme që mbjell farat e drejtësisë, fuqizimit të grave dhe bashkëpunimit, sepse e ardhmja që ëndërrojmë, është një e ardhme që ndërtojmë së bashku.


Banka Ekonomike
Banka Ekonomike

## SOCIALIZIMI I BANKËS EKONOMIKE, FUQIZIMI I MARRËDHËNIEVE PËRMES PUNËS NË GRUP

Te Banka Ekonomike dhe KS Siguria, puna ekipore nuk është thjesht një koncept, është themeli mbi të cilin ndërtojmë çdo sukses. Çdo vit, ky frymëzim merr jetë përmes një aktiviteti të veçantë socializimi, ku kolegët nga çdo departament dhe qytet mblidhen përtej mureve të zyrave për të ndarë momente të paharrueshme dhe për të ndërtuar ura të reja bashkëpunimi.

Nga lojërat energjike që sfidojnë kreativitetin dhe koordinimin e ekipit, deri te aktivitetet relaksuese si joga, piktura dhe vallëzimi, ky event është më shumë sesa argëtim, është një hapësirë që zbulon pasionet e fshehura dhe potencialin unik të çdo pjesëmarrësi. Imagjinoni një koleg që kurrë nuk keni ditur se ka talent në aktrim, apo një tjetër që krijon piktura frymëzuese gjatë një seance



artistike. Ky event krijon një ambient ku energjia pozitive, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ndërtojnë themelet e suksesit profesional kolektiv.

Për ne, puna ekipore është ajo që mban gjallë çdo aspiratë, çdo projekt dhe çdo ëndërr të përbashkët. Sepse suksesi nuk është i një individi – është i një ekipi. bashku.



## NJË DHURATË PËR SHPRESË DHE SHËRIM, MBËSHTETJA E BANKËS EKONOMIKE PËR KLINIKËN PSIKIATRIKE




Përfaqësuesit e Bankës Ekonomike patën nderin të vizitojnë Klinikën e Kujdesit Psikiatrik, mbështetja jonë ishte një ndryshim të prekshëm në jetën e pacientëve. Përmes një sërë aktivitetesh rekreative, të dhuruara me dashuri dhe përkushtim, kemi parë sesi fuqia e lojërave dhe kreativitetit mund të ndryshojë jetë.

Një histori e veçantë na prek zemrën: një pacient, i cili për vite të tëra kishte qëndruar pasiv, dhe i izoluar nga masa pa kontakt me njerëzit, u përfshi për orë të tëra në aktivitete, duke shfaqur një energji të papritur dhe një angazhim që frymëzoi të gjithë stafin mjekësor. Një shembull i prekshëm i asaj që ndodh kur përkushtimi takon nevojën për shpresë.

Banka Ekonomike e sheh mbështetjen e komunitetit si një pjesë të pandashme të misionit të saj. Për ne, këto aktivitete nuk janë thjesht donacione, janë investime në jetën dhe mirëqenien e njerëzve tanë. Ndërsa ecim përpara, mbetemi të përkushtuar për të fuqizuar nismat që ofrojnë vlera të prekshme për të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmë. Sepse çdo histori suksesi që krijojmë së bashku është një hap drejt ndërtimit të një të ardhmeje më të ndritur për të gjithë.

## BANKA E ZEMRËS MBËSHTET NJË SHËNDETËSI MË TË FORTË DHE MË TË QËNDRUESHME

Banka Ekonomike qëndron gjithmonë pranë përpjekjeve që bëjnë ndryshim. Me krenari, ishim pjesë e **Konferencës Vjetore 2024 të Asociacionit të Spitaleve Private të Kosovës**, një ngjarje që bashkoi përfaqësues nga 29 spitale private, anëtarë të Unionit Evropian të Spitaleve Private, dhe liderë shëndetësorë nga vendi dhe Evropa.

Ky event shërbeu si platformë për diskutimin e ideve, ndarjen e përvojave dhe krijimin e partneriteteve që synojnë forcimin e sistemit shëndetësor në Kosovë. Si mbështetës i palodhur i shëndetit publik dhe privat, Banka Ekonomike është gjithmonë pranë nismave që përmirësojnë cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe krijojnë mundësi të reja për një sistem më të qëndrueshëm.

Ne besojmë se një ekonomi e shëndetshme fillon me një shoqëri të shëndetshme.
**Banka Ekonomike, gjithmonë pranë komunitetit për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.**



## MUAJI ROZË, NJË REFLEKTIM NË FORCËN DHE GUXIMIN E GRUAS

Muaji Rozë është më shumë sesa një thirrje për ndërgjegjësim ndaj kancerit të gjirit; është një himn për forcën, guximin dhe shpirtin e palëkundur të çdo gruaje që ka përballuar këtë sfidë. Gjatë këtij muaji, gratë e Bankës Ekonomike u bashkuan jo vetëm me zemër, por edhe me shpirt, dhe me një aktivitet ku duke mbajtur me krenari ngjyrën rozë, një simbol solidariteti për të gjitha ato që luftojnë, ato që kanë fituar betejën dhe ato që kanë nevojë për një dorë mbështetëse.

Secila fotografi e kapur gjatë këtij muaji, çdo buzëqeshje e dhuruar, dhe çdo zë i bashkuar në këtë iniciativë përfaqëson një premtim: asnjë grua nuk është vetëm në këtë betejë. Përkushtimi ynë nuk përfundon me fundin e muajit tetor. Ne qëndrojmë pranë tyre, sot dhe gjithmonë, për të dhënë mesazhin se, pavarësisht sfidave, bashkë jemi më të fortë. Banka Ekonomike vazhdon të mbështesë çdo grua, çdo histori dhe çdo betejë për një të ardhme më të ndritshme dhe më të lehtë. Sepse ngjyra rozë nuk është vetëm një simbol, është një premtim.



## LIZING PËR BIZNESET - ZGJIDHJE PËR RRITJE DHE ZHVILLIM

Në një përpjekje për të përmirësuar dhe mbështetur zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, Banka Ekonomike mori pjesë në takimin e organizuar nga Unioni i Bizneseve, ku prezantoi zgjidhjet më të fundit të lizingut për bizneset. Në këtë event të rëndësishëm, përfaqësuesit tanë nga Departamenti i Lizingut ndanë me entuziazëm detaje mbi procesin, përfitimet dhe fleksibilitetin që ofron ky shërbim inovativ.

Me një qasje të përshtatur për nevojat e çdo biznesi, Banka Ekonomike garanton që çdo klient të gjejë një zgjidhje që nxit rritjen dhe suksesin e tij. Lizingu është më shumë sesa një opsion financimi, është një mundësi për të ndërtuar një të ardhme më të fortë për bizneset që synojnë zgjerimin dhe inovacionin.

Përmes këtij angazhimi, Banka Ekonomike përforcon rolin e saj si partner i besuar i sektorit privat, duke u bërë një mbështetje e palëkundur për çdo hap të rrugëtimit të suksesshëm të bizneseve në Kosovë.


Mendon për ty!
Banka Ekonomike

## HAPJA E DEGËS SË RE NË MITROVICË TË VERIUT: NJË UDHËTIM I RI PËR BANKËN EKONOMIKE

Me krenari dhe përkushtim, Banka Ekonomike shënon një moment historik për zhvillimin e vendit, hapjen e degës së saj të re në Mitrovicë të Veriut. Ky nuk është thjesht një hap drejt zgjerimit të shërbimeve, por një mesazh i qartë se ne jemi këtu për të qenë pranë çdo qytetari, kudo që ai ndodhet.

Kjo degë e re është një pikënisje për një transformim ekonomik dhe social në këtë zonë. E pajisur me shërbime të avancuara dhe një ekip të dedikuar për nevojat e klientëve, ajo përfaqëson jo vetëm përkushtimin tonë për të sjellë më të mirën, por edhe besimin tonë në zhvillimin dhe bashkëpunimin që ndërtojmë së bashku.

Falënderojmë çdo klient dhe partner që ka qenë pjesë e këtij rrugëtimi. Përmes kësaj dege, ne forcojmë angazhimin tonë për të sjellë më shumë mundësi, më shumë zhvillim dhe më shumë shpresë për një të ardhme të ndritur.
Banka Ekonomike Mendon për Ty – sot, nesër dhe gjithmonë.


Banka
Ekonomike
VISA
BANKOMAT
24/7

## BANKA EKONOMIKE DHE USAID: NJË RRUGË E RE PËR GRATË NDËRMARRËSE NË KOSOVË

Banka Ekonomike, gjithmonë një mbështetëse e palëkundur e fuqizimit të gruas, ka ndërmarrë një hap madhor në bashkëpunim me USAID, duke nënshkruar një kontratë në kuadër të programit "Kosovo Investment Promotion and Access to Finance." Ky projekt i veçantë, që përfshin një grant të dedikuar për gratë ndërmarrëse në Kosovë, synon të hapë dyer të reja për ato që aspirojnë të bëhen pjesë e një ekonomie gjithnjë e më konkurruese.

Programi i dedikuar për gratë ndërmarrëse, që do të krijohet nga Banka Ekonomike, shkon përtej financimit. Ai ofron një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin trajnimet praktike për zhvillimin e aftësive profesionale dhe kapaciteteve personale. Qëllimi është t'i ndihmojë gratë të përballen me sfidat e tregut, duke fuqizuar idetë e tyre të biznesit dhe duke krijuar një pozicion më të fortë për to në ekonominë vendore.

Përveç kësaj, programi do të realizojë fushata të përbashkëta promovimi, duke nxitur njohjen e grave si kontribuese kyçe në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo iniciativë nuk është thjesht një mundësi për bizneset, por një thirrje për ndërtimin e një ekonomie të drejtë dhe të qëndrueshme, ku gratë janë jo vetëm pjesë, por edhe drejtueset kryesore të transformimit ekonomik.

Me këtë hap të guximshëm, ne demonstrojmë përkushtimin tonë për të mbështetur gratë në biznes dhe për të ndërtuar një të ardhme ekonomike më të fortë për Kosovën.


USAID
Banka Ekonomike

## NJË PARTNERITET PËR TË RINJTË E KOSOVËS MES BANKËS EKONOMIKE DHE FAKULTETI EKONOMIK

Në një hap që lidh arsimin me tregun e punës, Banka Ekonomike dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës kanë zyrtarizuar një bashkëpunim të rëndësishëm për të sjellë mundësi të jashtëzakonshme për studentët e ekonomisë. Ky partneritet shkon përtej një marrëveshjeje bashkëpunimi; ai është një urë që lidh teorinë me praktikën, ambicien me përvojën dhe të ardhmen me suksesin.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, studentët do të kenë mundësinë të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale në departamente të ndryshme të Bankës Ekonomike. Kjo jo vetëm që u ofron një shans për të kuptuar dinamikën e tregut financiar nga afër, por edhe për t'u mentoruar nga ekspertë të industrisë bankare. Nga mësimi i proceseve menaxheriale deri te përfshirja në projekte strategjike, këto përvoja do të ndërtojnë themelet e karrierës së tyre të ardhshme.

Për studentët, kjo nuk është thjesht një mundësi, është një ftesë për të eksploruar potencialin e tyre, për të përvetësuar aftësitë që tregu kërkon dhe për të bërë hapat e parë drejt udhëheqjes së ardhshme në sektorin ekonomik të Kosovës.

Për Bankën Ekonomike, kjo iniciativë përfaqëson një angazhim të vazhdueshëm për të investuar në gjeneratën e re. Ne besojmë se zhvillimi i arsimit dhe krijimi i mundësive për të rinjtë janë çelësi për një ekonomi të fortë dhe një shoqëri të qëndrueshme. Me këtë bashkëpunim, ne ndërtojmë një të ardhme ku të rinjtë jo vetëm që ndjekin ëndrrat e tyre, por bëhen liderët që do të formësojnë të nesërmen.

Ky është një hap i ri drejt forcimit të lidhjes midis arsimit dhe industrisë, një hap që i afron më shumë të rinjtë me tregun e punës dhe që përforcon vizionin tonë për një ekonomi të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë.


Banka
Ekonomike

## NDERIMET QË VLERËSOJNË PUNËN DHE PËRKUSHTIMIN E BANKËS EKONOMKE

Në një natë plot emocion dhe vlerësime, gjatë Gala Mbrëmjes së organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, Banka Ekonomike u nderua me titullin prestigjioz për vitin 2024: "**Tatimpaguesi i Vitit**." Ky çmim përfaqëson më shumë se një arritje; është dëshmi e vizionit tonë për të qenë jo vetëm një shtyllë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës, por edhe një model i përgjegjësisë sociale dhe përkushtimit ndaj punonjësve tanë.

Kjo njohje tregon vlerësimin për përpjekjet tona të pandërprera për të kontribuar në një ekonomi të qëndrueshme, për të mbështetur rritjen e qëndrueshme të vendit dhe për të siguruar se përgjegjësia tatimore është një prioritet i pandashëm i rrugëtimit tonë.

Ky sukses është një motivim i jashtëzakonshëm për të vazhduar me përmirësime të vazhdueshme në çdo aspekt të shërbimeve tona — për punonjësit që përbëjnë zemrën e Bankës Ekonomike, për klientët që na besojnë çdo ditë dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Banka **Ekonomike – Gjithmonë pranë jush!**

Banka Ekonomike




Banka Ekonomike
shpallet:

**"Tatimpaguesi i vitit 2024"**

## ZËRI I GRAVE - FORCA QË NDRYSHON BOTËN

**Gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës në Baza Gjinore**, gratë dhe vajzat e Bankës Ekonomike u bashkuan për të përçuar një mesazh të fuqishëm solidariteti dhe shprese. **Dhuna nuk ka vend në shoqërinë tonë.**

Me zemër, guxim dhe përkushtim, ne qëndrojmë pranë çdo individi që ka përjetuar dhunë, duke ofruar mbështetje dhe frymëzim për një të ardhme më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë. Përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe përfshirjes aktive, ne po kontribuojmë në krijimin e një mjedisi ku secili zë dëgjohet dhe ku drejtësia triumfon mbi padrejtësinë.

Ky angazhim është pjesë e misionit tonë për të fuqizuar gratë, për të ndihmuar komunitetet dhe për të qenë një shtyllë mbështetëse në luftën për një shoqëri pa dhunë.

**Banka Ekonomike, Partneri dhe zëri juaj në krijimin e ndryshimit.**









## MAGJIA E FUNDVITIT, SHPRESA DHE DASHURI PËR FËMIJËT E KOSOVËS

Në prag të festave të fundvitit, **Banka Ekonomike** ishte krenare të mbështeste aktivitetin tradicional të organizuar nga "**Klubi Alpin Prishtina**" dhe "**Care for Kosovo Kids**", duke sjellë gëzim dhe shpresë për fëmijët e shtruar në pediatri.

Superheronjtë e tyre të preferuar u bënë pjesë e këtij aktiviteti të veçantë, duke i gëzuar fëmijët me dhurata dhe duke krijuar momente të paharrueshme për këta luftëtarë të vegjël. Mes buzëqeshjeve dhe emocioneve të ndjera, Banka Ekonomike u bashkua me zemër për të dhuruar dashuri dhe mbështetje

Ky aktivitet nuk është thjesht një gjest festiv; është një premtim i qëndrueshëm për të qëndruar pranë atyre që kanë më shumë nevojë.
**Gjithmonë pranë zemrave të forta dhe atyre që na frymëzojnë çdo ditë qëndron vetëm Banka Ekonomike**



## DIASPORA, SHTYLLA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS – BANKA EKONOMIKE NDËRTON URA PËR TË ARDHMEN

Diaspora jonë ka qenë gjithmonë një shtyllë e fuqishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës, një burim frymëzimi dhe energjie që nuk njeh kufij. Në kuadër të një takimi të rëndësishëm me "**Dritaren për Investime të Diasporës**," Banka Ekonomike prezantoi mundësi të shumta për të përkrahur idetë dhe projektet inovative të bashkatdhetarëve tanë.

Përfaqësuesi i Bankës Ekonomike, **Burim Latifi**, së bashku me ekspertë nga **Fondi Kosovar për Garanci Kreditore** dhe **USAID – Aktiviteti për Promovim të Investimeve dhe Financimit**, ndanë njohuri kyçe për skemat garantuese, grantet dhe opsionet e financimit. Kjo iniciativë përfaqëson më shumë se një hap ekonomik, është një urë që lidh energjinë, idetë dhe pasionin e diasporës me zhvillimin e Kosovës.

Përmes këtij bashkëpunimi, Banka Ekonomike riafirmon rolin e saj si një partner strategjik për ata që shohin të ardhmen e tyre dhe të vendit në rritje. Investimet nga diaspora jo vetëm që ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin ekonomik, por gjithashtu sjellin ndryshim të prekshëm në jetën e përditshme të qytetarëve tanë.
**Banka Ekonomike, Duke ecur krah për krah me diasporën për të ndërtuar një Kosovë më të fortë dhe më të begatë.**


Mendon për ty!
Banka Ekonomike
BANKË ME KAPITAL 100% VENDOR
USAID
NGA POPULLI AMERI
OD AMERIČKOG NAR
to Finance
KETTLER

## NJË HAP MË AFËR BARAZISË, SOLIDARITETI QË NDRYSHON JETËN

Në **Ditën Ndërkombëtare të Solidaritetit**, Banka Ekonomike dhe Kompania e Sigurimeve **Siguria** riafirmuan angazhimin e tyre për një botë më të barabartë dhe me më shumë mundësi për të gjithë. Me krenari, ne vazhdojmë të mbështesim **Down Syndrome Kosova**, duke kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndritur për fëmijët me sindromën Down.

Përmes kësaj nisme, ne nuk ofrojmë vetëm mbështetje financiare, por edhe krijojmë mundësi për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Programet tona përfshijnë mbështetje për terapitë e nevojshme dhe krijimin e mjediseve më të përshtatshme për zhvillimin e talenteve dhe aftësive të këtyre fëmijëve të jashtëzakonshëm.

Solidariteti për ne nuk është vetëm një veprim i momentit, por një përkushtim afatgjatë për të ndërtuar një shoqëri ku të gjithë kanë mundësinë të realizojnë ëndrrat e tyre.

**Banka Ekonomike, Partneri juaj në rrugën drejt një shoqërie më përfshirëse dhe të drejtë.**


Bonjour

## MIRËNJOHJE PËR RININË, BANKA EKONOMIKE, INVESTIM PËR BREZAT E ARDHSHËM

Me kënaqësi dhe krenari, ndamë me ju mirënjohjen e pranuar nga **Kosovo Generation Unlimited (KGen)**, e cila vlerësoi përkushtimin tonë të palëkundur në fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mundësive të reja. Si një bankë 100 përqind vendore, ne besojmë fuqishëm se investimi në rininë është investim në të ardhmen e Kosovës.

Kjo mirënjohje është dëshmi e angazhimit tonë të vazhdueshëm për të ndërtuar ura bashkëpunimi me organizatat që ndajnë të njëjtin vizion për një Kosovë më të fortë dhe më të qëndrueshme. Përmes trajnimeve, mbështetjes financiare dhe projekteve inovative, ne ndihmojmë të rinjtë të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të bëhen liderët e së nesërmes.

Ky sukses na motivon të vazhdojmë rrugëtimin tonë për të fuqizuar talentet e rinj, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë një të ardhme të ndritur për veten dhe komunitetin.

**Banka Ekonomike – Për një Kosovë ku çdo i ri ka mundësinë të ëndërrojë, të veprojë dhe të arrijë.**


REPUBLIKA E
KOSOVËS MINISTRIA E
FINANCAVE, PUNËS
DHE TRANSFERAVE
With funding from
Austrian
Development
Cooperation
KOSOVO CSR
NETWORK
Supported by UNICEF in Kosovo and Austrian Development Agency

## BANKA EKONOMIKE NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE INOVACIONIT, NJË PARTNERITET PËR NJË KOSOVË TË FORTË

Mbrëmë, në kuadër të "**Darkës së Investitorëve 2024**," të organizuar nga Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Banka Ekonomike pati nderin të jetë sponsore e këtij eventi të rëndësishëm që mblodhi së bashku investitorë, startup-e dhe biznese nga Kosova dhe Gjermania. Ky organizim krijoi një platformë të veçantë ku idetë novatore të startup-eve kosovare ndriçuan si shembuj të vizionit dhe përkushtimit për një të ardhme më të qëndrueshme.

Kryeshefi Ekzekutiv i Bankës Ekonomike, **Shpend Luzha**, në fjalimin e tij, theksoi: "Si bankë 100 përqind vendore, ne jemi krenarë që fuqizojmë rrjetin e biznesit kosovar, duke përfshirë edhe diasporën tonë të jashtëzakonshme, e cila është një shtyllë e rëndësishme e ekonomisë sonë. Për ne, është përgjegjësi dhe privilegj të krijojmë mundësi të reja që lidhin komunitetin tonë brenda dhe jashtë vendit, duke fuqizuar ide që hapin rrugën për një të ardhme më të mirë."

Përmes këtij angazhimi, Banka Ekonomike jo vetëm që mbështet zhvillimin ekonomik, por gjithashtu nxit inovacionin dhe sipërmarrësin në vend. "**Darka e Investitorëve**" dëshmon se fuqia e bashkëpunimit mund të ndërtojë ura që lidhen me tregjet ndërkombëtare, duke e bërë Kosovën një qendër të mundësive dhe zhvillimit ekonomik.

**Banka Ekonomike – Partneri juaj në zhvillim, gjithmonë pranë komunitetit dhe progresit.**


UNION BUSINESS
DARKA
E INVESTITORËVE

## BASHKË PËR AUTIZMIN – NJË ANGAZHIM PËR NDRYSHIM

Si çdo vit, **Banka Ekonomike** dhe **Kompania e Sigurimeve Siguria** qëndrojnë pranë **Asociacionit Nacional të Autizmit**, duke mbështetur fëmijët dhe familjet që përballen me sfidat e autizmit. Për ne, solidariteti është forca që bashkon njerëzit dhe fuqizon shpresën për një të ardhme më të ndritur.

Në këtë iniciativë, ne nuk shohim vetëm një akt mbështetjeje, por një angazhim të vazhdueshëm për të krijuar një mjedis ku çdo fëmijë, pavarësisht sfidave, ka mundësinë të zhvillohet dhe të arrijë potencialin e tij. Përmes mbështetjes sonë, ne synojmë të fuqizojmë shërbimet terapeutike, të rrisim ndërgjegjësimin dhe të ndërtojmë ura që lidhin zemrat me ndryshimin.

Banka Ekonomike, ndihmon të ndryshojmë jetë dhe të ndërtojmë një të ardhme më të ndritshme për të gjithë.

**Solidariteti nuk është një veprim momental, por një filozofi që drejton çdo hap të udhëtimit tonë.**



## NGROHTËSIA E FUNDVITIT, BANKA EKONOMIKE PRANË TË MOSHUARVE DHE FËMIJËVE NË NEVOJË

Në frymën e festave të fundvitit, Banka Ekonomike zgjodhi të sjellë buzëqeshje dhe ngrohtësi për të moshuarit. Në shtëpinë e të moshuarve në Suharekë, ekipi ynë dhuroi momente të gëzueshme dhe ndau dhurata modeste, duke krijuar kujtime të paharrueshme për këta njerëz të dashur që meritojnë gjithë përkujdesjen e shoqërisë.

Në të njëjtën frymë, Banka Ekonomike shpërndau dhurata për fëmijët e institucioneve në shtatë qytete kryesore, duke u kujdesur që asnjë fëmijë të mos ndihet i harruar në këtë kohë festash. Përmes kësaj nisme, ne riafirmojmë përkushtimin tonë për të ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë, duke sjellë shpresë dhe dashuri në çdo shtëpi.

Banka Ekonomike, për një fundvit të mbushur me gëzim, solidaritet dhe kujdes për të gjithë.




NEWBORN





Jezerc - Ferizaj



Suksesi i kompanise sonë matet me rritjen konstante te numrit te klientve tanë i cili sa vjenë e shtohet gjithashtu e jonshmangshme është edhe rritja e besimit te klientëve tanë gjë që na mundësonë edhe rritjen e kualitetit te ofertave tona dhe detyrimeve qe kalin nga sigurimet.


SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE


SIGURIA
SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE
SIGURIA

# SIGURIA: VITI 2024, NJË HISTORI E RRITJES DHE UDHËHEQJES

Me një strategji të qartë dhe fokus në zhvillim, SIGURIA ka vazhduar rritjen e saj në vitin 2024, duke forcuar pozicionin si një nga kompanitë konkurruese të sigurimeve në treg. Rritja e primeve të shkruara, menaxhimi efikas i dëmeve dhe avancimi i digjitalizimit kanë qenë shtyllat kryesore të suksesit tonë këtë vit.



**Fitim Rexhepaj**
Kryeshef Ekzekutiv



**Lumbardh Kusari**
Zv. Kryeshef Ekzekutiv

**Një vit rekord në rritjen e biznesit**
Në vitin 2024, SIGURIA ka zgjeruar dukshëm praninë në treg, duke regjistruar një rritje të konsiderueshme në të gjitha parametrat financiarë.

- Primet bruto arritën në 14.460 milion EUR, një rritje domethënëse nga 11.018 milion EUR në vitin 2023.
- Dëmet e paguara u rritën në 6.641 milion EUR, krahasuar me 6.268 milion EUR vitin e kaluar, me përmirësime të mëdha në procesin e menaxhimit dhe pagesave të dëmeve.
- Fitimi para taksave u rrit në 1.03 milion EUR, nga 858 mijë EUR në vitin 2023, ndërsa fitimi neto arriti në 758 mijë EUR.

Këto rezultate tregojnë qartë fuqizimin e kompanisë dhe përkushtimin ndaj një rritjeje të qëndrueshme dhe të shëndetshme, në treg.

**Menaxhim i përmirësuar i dëmeve dhe qasje strategjike**
Menaxhimi efektiv i dëmeve ka qenë një prioritet kyç për kompaninë tonë në vitin 2024. Përmes avancimeve teknologjike dhe optimizimit të proceseve:

- Është zvogëluar koha e përpunimit të dëmeve, duke garantuar një përvojë më të mirë për klientët.
- Janë aplikuar analiza të avancuara të të dhënave, duke përmirësuar identifikimin dhe trajtimin e rasteve në mënyrë më efikase.
- Janë zbatuar praktikat më të mira të qeverisjes korporative, duke mundësuar një menaxhim më të fortë të rreziqeve dhe një transparencë më të madhe.

**Transformimi digjital**
Duke ndjekur trendet më të fundit të industrisë, SIGURIA ka investuar fuqishëm në zhvillimin e platformave digjitale, duke krijuar shërbime më të lehta dhe më të shpejta për klientët.

Disa nga projektet kyçe të realizuara përfshijnë:

- Modernizimin e sistemit të menaxhimit të dëmeve, duke lehtësuar procesin për klientët dhe duke rritur efikasitetin operativ.
- Avancimin e platformës së shitjeve, duke ofruar shërbime të sigurimeve më të shpejta dhe më të personalizuara.
- Zhvillimin e analizave të thelluara të të dhënave, të cilat kanë ndihmuar në optimizimin e politikave të menaxhimit të rreziqeve dhe përmirësimin e vendimmarrjes strategjike.

Këto ndryshime kanë treguar rezultate të menjëhershme, duke rritur saktësinë, shpejtësinë dhe cilësinë e shërbimeve për klientët tanë.

**Një vit i suksesshëm, një e ardhme e sigurt**

Viti 2024 ka qenë një vit suksesi dhe i zhvillimit për SIGURIA. Me një rritje financiare, avancime të rëndësishme në teknologji dhe një menaxhimin efektiv të rreziqeve, ne jemi të pozicionuar më mirë se kurrë për të vazhduar rritjen tonë në vitet e ardhshme.

Ne jemi të bindur se investimet e bëra në teknologji dhe përmirësimet operative do të kontribuojnë në një sukses të qëndrueshëm në të ardhmen.

Faleminderit për besimin dhe bashkëpunimin

Në këtë vit të jashtëzakonshëm, duam të shprehim mirënjohjen tonë të thellë për stafin tonë të përkushtuar, i cili ka qenë një forcë kryesore pas suksesit të SIGURIA-s, klientët tanë, për besimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, partnerët tanë të biznesit, për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në ndërtimin e një industrie sigurimesh më të fortë, Bordin e Drejtorëve, për udhëheqjen strategjike dhe vizionin e qartë, si dhe Bankën Ekonomike, për mbështetjen e palëkundur dhe besimin në misionin tonë.

Me ambicie të mëdha dhe një ekip të fortë, ne shikojmë përpara drejt vitit 2025, me synimin për të sjellë edhe më shumë rritje dhe sukses!

**Mesazh nga Ekzekutivi**

# BILANCI I GJENDJES DHE PASQYRA E TË ARDHURAVE



Kaçanik

| Pasuritë | 2024<br>EUR '000 | 2023<br>EUR '000 |
|---|---|---|
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 870 | 469 |
| Depozitat | 11,682 | 9,914 |
| Investime në letra me vlerë | 5,082 | 5,084 |
| Të arkëtueshmet nga sigurimet | 1,299 | 1,538 |
| Kostot e shtyra të përvetësimit | 601 | 532 |
| Prona, pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurisë | 3,325 | 3.462 |
| Prona investuese | 895 | 895 |
| Pjesa e risiguruesit në detyrimet e provizioneve teknike | 882 | 963 |
| Pasuri të tjera | 1,816 | 1,351 |
| **Gjithsej pasuritë** | **26,452** | **24,208** |
| **Ekuiteti dhe detyrimet** | | |
| **Ekuiteti** | | |
| Kapitali aksionar | 19,503 | 19,503 |
| Rezerva e rivlerësimit | 534 | 534 |
| Humbjet e akumuluara | (12,846) | -13,604 |
| **Gjithsej Ekuiteti** | **7,191** | **6,433** |
| **Detyrimet** | | |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 11,545 | 11,221 |
| Provizioni për prime të pafituara | 6,427 | 5,168 |
| Detyrime ndaj borxhit të varur | 200 | - |
| Detyrim ndaj tatimit në të ardhura | 164 | 54 |
| Dertyrimet e Qirasë | 324 | 445 |
| Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera | 601 | 887 |
| **Gjithsej detyrimet** | **19,261** | **17,776** |
| **Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet** | **26,452** | **24,208** |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 04 Prill 2025 dhe janë nënshkruar në emër të:

Z. Fitim Rexhepaj
Drejtor Gjeneral

Z. Adhurim Kastrati
Drejtor Financiar

| Pasuritë | 2024<br>EUR '000 | 2023<br>EUR '000 |
|---|---|---|
| Primet e shkruara bruto | 14,460 | 11,018 |
| Minus: Primet e bartura tek risiguruesit | (2,055) | -813 |
| **Primet e shkruara neto** | **12,405** | **10,206** |
| Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara | (1,258) | -337 |
| Ndryshimi në pjesën e risiguruesëve të rezervës së primit të pafituar | 770 | 93 |
| **Primet e shkruara neto** | **11,917** | **9.961** |
| | | |
| Të ardhurat financiare neto | 355 | 229 |
| Të ardhura tjera | 411 | 420 |
| **Gjithsej të ardhurat** | **12,683** | **10,610** |
| | | |
| Shpenzimet e provizioneve teknike | (6,641) | -6,268 |
| Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit | 70 | 63 |
| Kontributi në BKS për shpenzimet administrative | (257) | -292 |
| Shpenzime tjera operative dhe administrative | (4,827) | -3,255 |
| **Gjithsej shpenzimet** | **(11,656)** | **-9,751** |
| **FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT** | **1,027** | **858** |
| Tatimi në të ardhura | (269) | -114 |
| **Fitimi/(humbja) për vitin** | **758** | **744** |
| Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse | - | - |
| **GJITHSEJ FITIMI/(HUMBJA) GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN** | **758** | **744** |



Ujëvara e Mirushës

# PERFORMANCA E KS SIGURIA

**Rruga drejt rritjes së qëndrueshme dhe afrimit me klientin**

Viti 2024 ishte një tjetër hap i sigurt për KS "SIGURIA" drejt konsolidimit të pozicionit të saj si një partner i besueshëm për individët dhe bizneset në Kosovë. Në një treg në zhvillim e sipër, kompania ka ndërtuar suksesin e saj mbi një strategji të qartë – mbështetje konkrete për ata që janë motor i ekonomisë: bizneset, dhe përkushtim ndaj klientëve individualë përmes shërbimeve të qasshme, moderne dhe cilësore.

**Afër partnerëve tanë, gjithmonë**

Në përputhje me strategjinë afatgjatë të kompanisë, gjatë vitit 2024 është thelluar angazhimi për mbështetjen e bizneseve – punëdhënësit kryesorë të vendit – si partnerë kyç në rritjen dhe zhvillimin e përbashkët. Përgjatë kësaj periudhe, është ruajtur një fokus i rëndësishëm edhe ndaj individëve, përmes hapjes së degëve të reja dhe modernizimit të atyre ekzistuese, duke krijuar një ambient më të përshtatshëm dhe të afërt për ofrimin e shërbimeve.

**Një hap i ri drejt lehtësimit të shërbimeve**

Një nga veprimet më domethënëse në këtë drejtim ka qenë integrimi i shërbimeve të KS "SIGURIA" brenda degëve të Bankës Ekonomike, duke i mundësuar klientëve që të përfitojnë nga produktet tona në një vend të vetëm, me efikasitet dhe komoditet më të madh.

**Rritje përtej tregut – dëshmi e besimit të klientëve**

- Kompania ka shënuar një rritje të konsiderueshme në prime të shkruara gjatë vitit 2024
- Rritje e primeve totale ka shkuar në 31 përqind krahasuar me vitin paraprak.
- Rritja mesatare e tregut: 14.6 përqind.

Veçanërisht, produktet që lidhen me sigurimin shëndetësor dhe aksidentet personale kanë pasur një rritje.

- Rritje prej 48 përqind për KS "SIGURIA".
- Rritje prej 28 përqind në nivel tregu.

## Fushata me ndikim dhe përgjegjësi sociale

Në përputhje me strategjinë për rritje të prezencës në treg, KS "SIGURIA" gjatë vitit 2024 ka zhvilluar një sërë fushatash për promovimin e sigurimit të shëndetit, pronës dhe për bashkëpunime me partnerë afaristë. Brenda këtij viti, në kuadër të përgjegjësisë sociale, janë ndërmarrë edhe aktivitete të ndryshme.

- Mbështetje për persona me aftësi të kufizuara.
- Ndihmë për raste në nevojë.

Duke dëshmuar se kujdesi i kompanisë nuk ndalet vetëm te biznesi, por shtrihet edhe në zemrën e komunitetit.

## Portofoli dhe Risigurimi

Portofoli: Përgjatë vitit 2024, KS 'SIGURIA', në portofolin e saj ka pasur gjithsej 49'299 klientë aktivë, ku 55.8 përqind e tyre i takojnë portofolit të sigurimeve të detyrueshme dhe 44.2 përqind sigurimeve vullnetare.

Portofoli i KS 'SIGURIA' është i risiguruar nga risiguruesit reputabilë, me stabilitet financiar dhe kredibilitet në tregjet e risiguruesve në Evropë.



Porofolio e Sigurimeve Vullnetare 2024/2023




**PJESËMARRJA NË TREG**

**Një pozicion që forcohet vit pas viti**

Viti 2024 ka shënuar rritje të ndjeshme të pranisë së KS "SIGURIA" në tregun e sigurimeve, me rritje të ndjeshme në primet e shkruara bruto.

- Rreth 3.4 milion euro më shumë se në vitin 2023, që përbën një rritje prej 31 përqind.
- Pjesëmarrja në treg, referuar primeve të shkruara bruto, arriti në 9 përqind për vitin 2024.



## Shtytje nga primet vullnetare dhe rritje e qëndrueshme në MTPL

- Primet vullnetare shënuan një rritje të jashtëzakonshme prej 54 përqind, krahasuar me vitin 2023.
- Primet MTPL u rritën me 19 përqind më shumë se në vitin 2024.
- Nga 7.2 përqind në vitin 2023, pjesëmarrja në treg për primet vullnetare arriti në 8.9 përqind në vitin 2024, një indikator i qartë i rritjes së besimit të klientëve.



**DËMET:**
Departamenti i Dëmeve ka vijuar përkushtimin ndaj efikasitetit dhe transparencës, duke ruajtur standardet e larta të pagesave të dëmeve dhe duke përshpejtuar trajtimin e rasteve.

- Gjatë vitit 2024, KS "SIGURIA" ka shënuar rritje prej 9 përqind të dëmeve të paguara, krahasuar me vitin 2023.
- Pjesëmarrja në tregun e sigurimeve, sa i përket vlerës së dëmeve të paguara, qëndron në 8.7 përqind për vitin 2024.

Ky rezultat vjen si rrjedhojë e strategjive të përmirësimit të proceseve, digjitalizimit të menaxhimit të dëmeve dhe fokusit në kërkesat reale të klientëve të dëmtuar.





# DEPARTAMENTI I SHITJES DHE MARRJES NË SIGURIM

Kompania jonë mbetet e përkushtuar ndaj një transformimi të shpejtë dhe të qëndrueshëm, duke synuar të jetë një kompani sa më afër klientit dhe sa më fleksibile. Qëllimi ynë primar është të shtojmë vazhdimisht vlerën që i ofrojmë klientit, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe produkteve tona dhe duke zgjeruar gamën e ofertave digjitale gjithëpërfshirëse.Kjo strategji synon të përkthehet në një përvojë sa më të këndshme dhe efikase për të gjithë klientët tanë.

Departamenti i Shitjes dhe Marrjes në Sigurim ka pasur një vit tejet dinamik, duke shënuar rritje të konsiderueshme në arritjen e objektivave strategjike. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e proceseve, me theks të veçantë në integrimin e teknologjive të reja dhe zgjerimin e portofolit të klientëve. Kjo ka sjellë rritje të ndjeshme në performancën e përgjithshme dhe një qëndrueshmëri më të madhe në treg.

- **Rritje prej 31 përqind në prime është dëshmi e përpjekjeve tona të koordinuara, ku strategjia e qartë, inovacioni dhe angazhimi i palëkundur ndaj cilësisë kanë luajtur rol kyç.**

- **Objektivi ynë për vitin 2025 është jo vetëm të ruajmë këtë trend të suksesshëm, por edhe ta tejkalojmë, përmes thellimit të inovacionit, zgjerimit të mëtejshëm të tregut dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve që ofrojmë.**

Gjatë vitit 2024, kemi bërë progres të rëndësishëm në drejtim të digjitalizimit dhe përmirësimit të proceseve, duke ndikuar drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë tonë. Viti ishte plot arritje për Departamentin e Shitjes, duke shënuar nivelin më të lartë të primeve që nga themelimi i kompanisë.

Ky rezultat erdhi si pasojë e një rikonstruktimi të plotë të qasjes sonë ndaj klientit. Procesi i rivitalizimit i shërbimeve dhe produkteve tona ka sjellë një ofertë më konkurruese dhe më cilësore për të gjithë klientët tanë, qoftë individë apo biznese. U kushtua rëndësi e veçantë nevojave të tyre, përmes:

- **Ofertave atraktive**
- **Shërbimeve të personalizuara**
- **Procesimit të shpejtë të kërkesave**

Pavarësisht sfidave në mjedisin makroekonomik, veçanërisht për shkak të rritjes së çmimeve, rritja e primeve gjatë 2024-s dëshmoi një trend shumë pozitiv. Krahasuar me vitin paraprak, kjo rritje prej 31 përqind është reflektuar në të gjitha produktet e sigurimeve, duke përforcuar pozicionin e KS SIGURIA si një nga liderët në tregun e sigurimeve në Kosovë.
Departamenti ka vazhduar të jetë motor i zhvillimit të kompanisë, duke ruajtur fokusin në rritjen e shitjeve, optimizimin e proceseve dhe përmirësimin e përvojës së klientëve. Strategjitë që kemi ndërmarrë gjatë këtij viti kanë rezultuar në përmirësime të dukshme në të gjithë indikatorët kyç të performancës.

Shikimi ynë drejt së ardhmes mbetet i qartë, të vazhdojmë të krijojmë produkte dhe shërbime që i përgjigjen realisht nevojave të klientëve, duke ruajtur besueshmërinë, transparencën dhe vlerën që na karakterizon. Përmes investimeve në teknologji, inovacion dhe forcim të mëtejshëm të marrëdhënieve me klientët, do të sigurojmë që kompania të mbetet një partner i besueshëm për secilin prej tyre.

# DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË SHËNDETIT DHE AKSIDENTEVE

Departamenti i sigurimit të shëndetit ka pasur një vit tejet të suksesshëm, duke reflektuar rritje të konsiderueshme në numrin e klientëve dhe në përmirësimin e përvojës së tyre. Përgjatë vitit 2024, është investuar në rritjen e mbulimit shëndetësor, thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e qasjes në shërbime mjekësore. Kjo ka rezultuar në një eksperiencë më të lehtë dhe më të besueshme për klientët tanë.

Në fokus ka qenë gjithmonë ndihma dhe mirëqenia e klientëve, duke ofruar:

- **Produkte të personalizuara dhe paketa të strukturuara sipas nevojave reale**
- **Procesim më të shpejtë të kërkesave**
- **Rritje të bashkëpunimeve me institucionet shëndetësore private**

Me qëllim lehtësimin e qasjes në shërbime, janë përforcuar partneritetet me klinikat private më të njohura në vend, janë bërë marrëveshje me qendra diagnostike të certifikuara dhe është ngritur një sistem më i lehtë komunikimi me qendrat e kontaktit, duke shkurtuar ndjeshëm kohën e reagimit për çdo kërkesë. Një rol të veçantë ka luajtur bashkëpunimi me institucionet arsimore, korporatat dhe organizatat ndërkombëtare për ofrimin e pakove të sigurimit në grup, që garantuan një mbulim më të madh të popullsisë aktive.
Duke qenë se shëndeti është primar, kompania përgjatë vitit 2024 i ka kushtuar rëndësi të veçantë plotësimit të kërkesave të klientëve të cilat dalin nga sigurimi shëndetësor

- **Rritje prej 47 përqind në sigurimet shëndetësore krahasuar me vitin paraprak**
- **Zgjerim i mbulimit për mijëra individë dhe familje**
- **Lansimi i tri pakove shëndetësore me tarifa të favorshme**

Strategjia e kompanisë ka synuar jo vetëm të rrisë numrin e klientëve, por edhe të krijojë një sistem sigurimi më të shpejtë, më transparent dhe më afër nevojave reale të qytetarëve. Digjitalizimi ka qenë një tjetër shtyllë kyçe, me nisjen e projekteve për aplikacione që do t'u mundësojnë klientëve të marrin shërbimet online, duke kursyer kohë dhe mund.



Manastiri i Moqarës - Kamenicë





Kalaja e Pogragjës - Gjilan

# DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË PRONAVE DHE GARANCIONEVE

Departamenti i sigurimit të pronave dhe garancioneve ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në forcimin e mbrojtjes për individët dhe bizneset nga rreziqet e paparashikuara. Gjatë vitit 2024, ky sektor ka pasur një rritje të ndjeshme në vëllimin e primeve, duke kontribuar ndjeshëm në performancën e përgjithshme të kompanisë.
Me një qasje të orientuar drejt inovacionit dhe partneritetit afatgjatë, gjatë vitit 2024 është punuar intensivisht në zhvillimin e produkteve të reja të sigurimit të pronës. Produktet janë dizajnuar në mënyrë të tillë që të jenë të adaptueshme sipas kërkesave të tregut dhe specifikave të pasurive në pronësi të klientëve.

Bashkëpunimi i ngushtë me Bankën Ekonomike, ka rezultuar në krijimin e një modeli efikas të bashkërendimit të shërbimeve, ku klientët mund të përfitojnë në të njëjtin moment kredi, sigurim prone dhe asistencë teknike, duke kursyer kohë dhe duke marrë një shërbim të plotë në një pikë të vetme kontakti.

**Me fokus në cilësi dhe efikasitet, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në:**

- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve në kohë rekorde.
- Zhvillimin e politikave të reja të sigurimit për t'u përshtatur me nevojat e tregut
- Forcimin e bashkëpunimeve me sektorin bankar për një qasje "One Stop Shop"

**Pikat kryesore të arritjeve:**

- Rritje e sigurimit të pronave me 13.62 përqind
- Rritje e kënaqësisë së klientëve përmes shërbimeve të përmirësuara
- Mbështetje e dedikuar për bizneset, si faktorë kyç të zhvillimit ekonomik

Në këtë drejtim, kompania ka shfaqur përkushtim të lartë ndaj mbrojtjes së pronës së qytetarëve dhe bizneseve, duke e trajtuar sigurinë e pronës si një prioritet strategjik.



Kompleksi Memorial “Adem Jashari” - Prekaz





Rugovë

# DEPARTAMENTI I SIGURIMEVE KASKO

Në vitin 2024, departamenti i sigurimeve KASKO ka shënuar një tjetër vit të suksesshëm, duke e rritur ndjeshëm praninë në treg dhe besimin e klientëve. Me një qasje të personalizuar dhe bashkëpunime të zgjeruara me Bankën Ekonomike dhe partnerët afaristë, janë realizuar kampanja të rëndësishme që kanë dhënë rezultat të prekshëm.
Në bashkëpunim me departamentin e dëmeve, është ndërtuar një zinxhir i ri i trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, ku koha e përgjigjes është shkurtuar ndjeshëm dhe klientët kanë marrë shërbim më transparent dhe më të shpejtë. Janë zbatuar gjithashtu politika të reja për menaxhimin e rrezikut dhe identifikimin e automjeteve të ekspozuara ndaj dëmtimeve të shpeshta, duke ndikuar në uljen e rasteve problematike dhe në përmirësimin e balancave financiare të produktit.

- **Rritje e primeve KASKO me 17 përqind**
- **Investim në kapacitete njerëzore dhe teknologji për përpunim më efikas të kërkesave**
- **Produkte më transparente dhe me mbulim të plotë**

Synimi i kompanisë mbetet i qartë, ofrimi i sigurisë së plotë, transparencës dhe mbështetjes për çdo klient që zgjedh sigurimin KASKO, duke e bërë këtë produkt një shtyllë të rëndësishme të zhvillimit të kompanisë.


Hajla - Rugovë

# DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË AUTOPËRGJEGJËSISË (TPL)

TPL mbetet një nga produktet më të kërkuara dhe më të rëndësishme në portofolin e kompanisë. Përgjatë vitit 2024, ky departament ka pasur një vit dinamik me rritje të ndjeshme në policat e lëshuara dhe përmirësim të dukshëm në menaxhimin e dëmeve.
Sigurimi i autopërgjegjësisë është baza ligjore e mbrojtjes së drejtuesve të automjeteve dhe qytetarëve në rast të incidenteve në komunikacion, dhe ne e kemi trajtuar këtë produkt me seriozitetin që meriton.

Gjatë vitit është punuar në rritjen e aksesit në këtë produkt përmes rrjetit të shitjes, me përfshirjen e më shumë lokacioneve të shërbimit dhe digjitalizimin e një pjese të procesit të aplikimit. Është vendosur një sistem i ri kontrolli dhe menaxhimi i dokumentacionit, që ka përmirësuar dukshëm përvojën e klientëve dhe ka eliminuar vonesat në aktivizimin e policave.

Departamenti ka punuar ngushtë me institucionet e sigurisë rrugore për të ofruar edukim në komunitet dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurimit të detyrueshëm. Në të njëjtën kohë, janë rritur kapacitetet për menaxhimin e dëmeve dhe janë vendosur standarde të reja për trajtimin e kërkesave në kohë të shkurtër dhe me korrektësi të lartë.
Në aspektin e performancës, TPL ka shënuar:

- **Rritje të përgjithshme të primeve me 19 përqind krahasuar me vitin e kaluar;**
- **Rritje të pjesëmarrjes në treg në 9.2 përqind, duke dëshmuar për forcimin e pozicionit të kompanisë në këtë segment;**
- **Rritje të efikasitetit të brendshëm përmes trajnimeve dhe automatizimit të proceseve.**

Ky departament vazhdon të jetë shembull i konsistencës dhe i përkushtimit për të garantuar mbrojtje për çdo qytetar në rrugë.





Liqeni i Vasilevës - Drenas

# DEPARTAMENTI I DËMEVE

## Kur shpejtësia, saktësia dhe transparenca bëhen standard

Viti 2024 ka qenë një tjetër kapitull suksesi për Departamentin e Dëmeve në KS "SIGURIA", ku përkushtimi për shërbim të drejtë dhe efikas ndaj klientëve është reflektuar në përmirësime të prekshme, rritje të përmbushjes së dëmeve dhe automatizim të proceseve.




**Rritje e vlerës dhe numrit të dëmeve të paguar**
Gjatë vitit 2024, SIGURIA ka vazhduar me trendin pozitiv në trajtimin e dëmeve, duke rritur ndjeshëm efikasitetin dhe shpejtësinë e pagesave:

- Dëmet e paguara për vitin 2024 shënuan një rritje prej 9.4 përqind në krahasim me vitin 2023.
- Pjesëmarrja në treg, sipas vlerës së dëmeve të paguara, qëndron në 7.7 përqind, duke dëshmuar një pozicion të fortë të kompanisë në tregun e sigurimeve.
- Krahasuar me vitin e kaluar, numri i dëmeve të paguara është rritur me 31.62 përqind, ndërsa vlera e tyre me 9.45 përqind, duke reflektuar një përkushtim real ndaj klientëve të dëmtuar.

## Optimizim i proceseve dhe përkushtim ndaj klientit

Strategjitë e zbatuara nga Departamenti i Dëmeve kanë pasur një fokus të qartë në përmirësimin e eksperiencës së klientit:

- Koha mesatare e trajtimit të dëmeve është reduktuar ndjeshëm, falë optimizimit të proceseve dhe aplikimit të politikave të reja.
- Janë adresuar me prioritet raste të ndërlikuara dhe ankesat, përmes procedurave të përshpejtuara dhe komunikimit më efikas.
- Përkushtimi ka qenë i orientuar në transparencë, drejtësi dhe qasje njerëzore në secilin rast të dëmtuar.

## Transformim digjital në trajtimin e dëmeve

Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit 2024 ka qenë përforcimi i infrastrukturës digjitale në menaxhimin e dëmeve:

- Është implementuar sistemi i ri për menaxhimin e dëmeve shëndetësore, i cili ka kontribuar në rritjen e efikasitetit të vlerësimit dhe pagesës së tyre.
- Digitalizimi i komunikimit me palët e përfshira ka mundësuar një transparencë më të lartë dhe ka reduktuar kohën e reagimit.
- Janë bërë hapa konkretë drejt automatizimit të mëtejshëm të dokumentacionit dhe analizës së rasteve, për të garantuar saktësi dhe vendimmarrje të shpejtë.

## Përballja me sfida dhe synime të reja

Pavarësisht arritjeve të mëdha, sfidat e rritjes së volumit të dëmeve kanë kërkuar një qasje edhe më të përqendruar:

- Nevoja për automatizim të thelluar është një prioritet për vitin 2025, me synim për të reduktuar ngarkesën operative dhe për të përmirësuar më tej përvojën e klientëve.
- Departamenti i Dëmeve ka treguar një përkushtim maksimal për cilësi dhe besueshmëri, duke ndërtuar një kulturë të re të përgjegjshmërisë dhe performancës.

Me përkushtim ndaj cilësisë dhe transparencës, KS “SIGURIA” do të vazhdojë të jetë sinonim i sigurisë dhe profesionalizmit në trajtimin e dëmeve. Sepse kur klienti është në qendër, çdo proces bëhet më i drejtë, më i shpejtë dhe më i besueshëm.





Kalaja e Prizrenit




Kamenicë

# BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat Individuale Financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)

**Përmbajtja**

Raporti i Auditorit të Pavarur 197
Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar 201
Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse 203
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Ekuitet 205
Pasqyra Individuale e Rrjedhës së Parasë 207
Shënime për Pasqyrat Individuale Financiare 210

RSM KOSOVO SH.P.K.

Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja B-C,
Kati 2, No.B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DL +383 45 666 888

www.rsm.global/kosovo

# RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

**Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Bankës Ekonomike Sh.A.**

## Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat individuale financiare të Banka Ekonomike Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën individuale të rrjedhës së parasë për vitin që përfundon dhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat individuale financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin *'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare'* në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

**RSM KOSOVO SH.P.K.**

Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja B-C,
Kati 2, No.B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DL +383 45 666 888

www.rsm.global/kosovo

## Theksimi i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 2(a) të pasqyrave individuale financiare shoqëruese, këto pasqyra individuale financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën në përmbushjen e kërkesave të Bankës Qendrore të Kosovës për raportim financiar dhe mund të mos jenë të përshtatshme për t'u përdorur për qëllime të përgjithshme, përveç nëse ato lexohen së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

## Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Bankës, por nuk përfshijnë pasqyrat individuale financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat individuale financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave individuale financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuara më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat individuale financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Individuale Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave individuale financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave individuale financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat individuale financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra individuale financiare.
Si pjese e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave individuale financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në

pasqyrat individuale financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave individuale financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat individuale financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Organizatës, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë disa mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

**RSM Kosovo Sh.p.k.**

Prishtinë, Republika e Kosovës

21 Prill 2025

**Sadik Berisha**

Auditor Ligjor

Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar
(Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehen ndryshe)

| | Shënimi | Më 31 Dhjetor 2024 | Më 31 Dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 6 | 40,484 | 54,299 |
| Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës | 7 | 60,232 | 74,360 |
| Kreditë për klientët | 8 | 491,220 | 441,298 |
| Investime në letra me vlerë | 9 | 55,749 | 10,605 |
| Investimet në degë | 9.1 | 7,358 | 7,358 |
| Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi | 10 | 13,535 | 13,604 |
| Pasuritë e paprekshme | 11 | 3,220 | 3,860 |
| Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat | | 343 | - |
| Pasuri të tjera | 12 | 3,140 | 3,547 |
| **Gjithsej pasuritë** | | **675,281** | **607,931** |
| **Detyrimet** | | | |
| Depozitat nga klientët | 13 | 596,936 | 537,067 |
| Detyrime ndaj bankave | 14 | 1,096 | 1,487 |
| Detyrimi i tatimit në fitim | | - | 88 |
| Detyrime të tjera | 15 | 3,931 | 3,802 |
| Detyrimi i shtyer tatimor | | 596 | 600 |
| **Gjithsej detyrimet** | | **602,559** | **543,044** |
| **Ekuiteti dhe rezervat** | | | |
| Kapitali aksionar | 16 | 29,422 | 29,422 |
| Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera | 16 | 4,887 | 4,746 |
| Fitime të mbajtura | | 38,413 | 30,719 |
| **Gjithsej ekuiteti dhe rezervat** | | **72,722** | **64,887** |
| **Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat** | | **675,281** | **607,931** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre më 18 Prill 2025 nga:

Zt. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv

Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar

| | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv | 17 | 35,973 | 30,746 |
| Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv | 17 | (7,741) | (5,450) |
| **Të ardhurat neto nga interesi** | | **28,232** | **25,296** |
| | | | |
| Të ardhurat nga tarifa dhe komisione | 18 | 5,941 | 4,776 |
| Shpenzimet nga tarifa dhe komisione | 18 | (1,667) | (1,201) |
| **Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione** | | **4,274** | **3,575** |
| | | | |
| Të ardhurat e tjera operative | 19 | 811 | 634 |
| **Të ardhurat** | | **33,317** | **29,505** |
| | | | |
| Shpenzimet e personelit | 20 | (5,585) | (5,067) |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | 10,11 | (3,306) | (3,004) |
| Shpenzime të tjera | 21 | (12,062) | (8,964) |
| (Lirimi)/ngarkesa e lejimit te humbjeve neto në instrumentet financiare | 6,7,8,9 | (342) | 1,380 |
| Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme | 11 | (365) | (942) |
| **Gjithsej shpenzimet operative** | | **(21,660)** | **(16,597)** |

| | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| **Ekuiteti dhe rezervat** | | 11,657 | 12,908 |
| Tatimi në fitim | 22 | (963) | (1,182) |
| **Fitimi neto për vitin** | | **10,694** | **11,726** |
| | | | |
| **Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse** | | | |
| *Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje* | | | |
| Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimirifa dhe komisione | | - | - |
| *Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës* | | 4 | 18 |
| | | | |
| *Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje* | | | |
| *Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse* | | 137 | (125) |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi** | | **141** | **(107)** |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | | **10,835** | **11,619** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

| | Kapitali aksionar | Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera | Fitimet e mbajtura | Gjithsej ekuiteti dhe rezervat |
|---|---|---|---|---|
| **Me 01 Janar 2023** | **29,422** | **4,853** | **18,993** | **53,268** |
| Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet | | | | |
| Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët | - | - | - | - |
| Dividenta e shpërndarë (Shënimi 16) | - | - | - | - |
| **Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet** | **-** | **-** | **-** | **-** |
| Fitimi për vitin | - | - | 11,726 | 11,726 |
| *Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin* | | | | |
| Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi | - | 18 | - | 18 |
| Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi) | - | (125) | - | (125) |
| Transfer | - | - | - | - |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | **-** | **(107)** | **11,726** | **11,619** |
| **Më 31 Dhjetor 2023** | **29,422** | **4,746** | **30,719** | **64,887** |

| | Kapitali aksionar | Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera | Fitimet e mbajtura | Gjithsej ekuiteti dhe rezervat |
|---|---|---|---|---|
| **Me 01 Janar 2024** | **29,422** | **4,746** | **30,719** | **64,887** |
| **Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet** | | | | |
| Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët | - | - | - | - |
| Dividenta e shpërndarë (Shënimi 16) | - | - | (3,000) | (3,000) |
| **Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet** | **-** | **-** | **(3000)** | **(3000)** |
| Fitimi për vitin | - | - | 10,694 | 10,694 |
| *Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin* | | | | |
| Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi | - | 4 | - | 4 |
| Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi) | - | 137 | - | 1137 |
| Transfer | - | - | - | - |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | **-** | **141** | **10,694** | **10,835** |
| **Më 31 Dhjetor 2024** | **29,422** | **4,887** | **38,413** | **72,722** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

| **Aktivitete operative** | **Shënimi** | **Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024** | **Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023** |
|---|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | | 11,657 | 12,908 |
| Ndryshime për: | 10,11 | 3,306 | 3,004 |
| Amortizimin dhe zhvlerësimin | | | |
| (Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në kreditë për klientët | 8 | 283 | (1,375) |
| Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme | 11 | 365 | 942 |
| Humbje neto nga zhvlerësimi i aseteve tjera | | 620 | - |
| (Lirimi)/Ngarkesa e provizionit për garancitë dhe letrat me vlerë | 15,9 | (47) | (78) |
| Të ardhurat nga interesi | 17 | (35,973) | (30,746) |
| **Shpenzimet e interesit** | **17** | **7,741** | **5,450** |
| | | **(12,048)** | **(9,895)** |

| *Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative* | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Rezerva statutore me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara | | (16,264) | 1,951 |
| Kreditë për klientët | | (50,543) | (59,385) |
| Pasuri të tjera | | (1,213) | (18) |
| Depozitat nga klientët | | 58,996 | 30,822 |
| Detyrime ndaj bankave | | (391) | 1,394 |
| Detyrime të tjera | | 1,133 | 85 |
| | | **(20,330)** | **(35,046)** |
| Interesi i paguar | | (6,868) | (4,469) |
| Interesi i arkëtuar | | 36,177 | 30,150 |
| Tatim mbi të ardhurat i paguar | | (1,394) | (1,308) |
| **Neto rrjedha e parasë e gjeneruar / (përdorur në) nga aktivitetet operative** | | **7,585** | **(10,673)** |

| Aktivitete investuese | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Blerja e pronave dhe pajisjeve dhe pasuritë e paprekshme | 10,11 | (2,944) | (1,474) |
| Blerjet e letrave me vlerë | 9 | (183,080) | (8,667) |
| Shitjet e letrave me vlerë | 9 | 138,185 | 26,111 |
| Investimi në degë | 9.1 | - | (1,300) |
| **Neto rrjedha e parasë e (përdorur në) / gjeneruar nga aktivitetet investuese** | | **(47,839)** | **14,670** |
| **Aktivitetet financiare** | | | |
| Shlyerja e detyrimit të qirasë | 10 | (952) | (976) |
| Dividentët e paguar | 16 | (3000) | - |
| **Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet financiare** | | **(3,952)** | **(976)** |
| **Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj** | | **(44,206)** | **3,021** |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fillim të vitit | 6 | 96,122 | 93,101 |
| **Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit** | **6** | **51,916** | **96,122** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.



## 1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a ("Banka") është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 22 nëndegë. Banka ka te punësuar 450 punonjës më 31 Dhjetor 2024 (2023: 441).

Në Shtator 2022, Banka përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Kompanisë të Sigurimeve Siguria Sh.a. Më 31 Dhjetor 2024, Banka zotëron 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a (2023: 100%).

## 2. Baza e përgatitjes

### (a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra individuale financiare përgatiten në përputhje me Standarded Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e tyre të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Këto pasqyra individuale financiare përfaqësojnë rezultatin dhe pozicionin financiar të Bankës dhe nuk përfshijnë atë të filialit të saj (shënimi 9.1). Banka përgatit një

grup tjetër pasqyrash financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF. Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur për qëllime ligjore lokale.

**(b) Prezantimi i pasqyrave financiare dhe shënimeve**

Për qëllime qartësie, pasqyrat individuale financiare dhe shënimet e pasqyrave individuale financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave individuale financiare agregohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare parësore. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime.

**(c) Standardet dhe interpretimet e reja ose të ndryshuara të adoptuara nga Banka**

Banka ka adoptuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Adoptimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim signifikant në pasqyrat financiare individuale të bankave.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 Janar 2024:

- Amendamentet në IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare - Klasifikimi i Detyrimeve si Të Shkurtra ose të Gjatë dhe Amendamentet në IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare - Detyrimet e Gjatë me Kushtet.
- Amendamentet në IAS 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe IFRS 7 Instrumentet Financiare: Zbulime - Marrëveshjet e Financimit të Furnizuesve.
- Amendamentet në IFRS 16 Qirate - Detyrimi i Qirasë në Një Shitje dhe Riarendim i Qirasë.

## 2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

### (d) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive , deri në datën e lëshimit të pasqyrave individuale financiare të Bankës janë shpalosur më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- Amendamentet në IAS 21 Efektet e Ndryshimeve në Normat e Këmbimit të Monedhës - Mungesa e Ndryshueshmërisë - në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2025.
- Amendamentet në IFRS 9 dhe IFRS 7 - Amendamentet në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare - në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 9 dhe IFRS 7 - Kontratave që Referencojnë Energjinë Elektrike të Varur nga Natyrë – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 1, IFRS 7, IFRS 9, IFRS 10 dhe IAS 7 - Përmirësime Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit IFRS - Vëllimi 11 – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- IFRS 18 Prezentimi dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2027.
- IFRS 19 Subsidiarët pa Përgjegjësi Publike: Zbulimet – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe IAS 28 Investimet në Shoqëri dhe Ndërmarrje të Pajtueshme - Shitja ose Kontributi i Pasurive mes një Investitori dhe Shoqërisë së tij të Pajtueshme ose Ndërmarrjes së Pajtueshme - data e efektivitetit shtyrë nga IASB përkohësisht, por aplikimi i hershëm lejohet.

Banka ka zgjedhur të mos miratojë para kohe këto deklarata dhe është në proces të

analizimit të ndikimit të adoptimit të këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve në pasqyrat individuale financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

**(e) Baza e kontabilitetit**

Pasqyrat individuale financiare janë përgatitur duke përdorur parimin e vazhdimësisë dhe sipas konventës së kostos historike, me përjashtim të pasurive financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit të mbajtura për mbledhje dhe shitje dhe klasa të caktuara të pronave, impianteve dhe pajisjeve

**(f) Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat individuale financiare përgatiten mbi bazën e vijmësisë, pasi Drejtorët janë të kënaqur që banka ka burime për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë parashikimet e ardhshme të përfitimit, flukset monetare, kërkesat për kapital dhe burimet kapitale. Këto konsiderata përfshijnë skenarë të theksuar. Ata gjithashtu morën parasysh rreziqe të tjera kryesore, si dhe nga ndikimet e lidhura me përfitimin, kapitalin dhe likuiditetin.

**(g) Valuta funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra individuale financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt,

përveç ku shprehet ndryshe.

**2. Baza e përgatitjes (vazhdim)**

**(h) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimi**

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 25.

**3. Politikat materiale kontabël**

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra individuale financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

**(a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare, duke përjashtuar ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim, njihen në 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi mbi pasuritë financiare të zhvlerësuara nga kredia njihet duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (d.m.th., vlerën kontabël bruto të aktivit minus provizionin për 'HPK').

Për pasuritë financiare të blera ose të origjinës të dëmtuara nga kredia ('POCI'), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI të rregulluar nga kredia dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e rregulluar nga kredia është norma e interesit që, në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme monetare të vlerësuara (përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të pasurive POCI.

**(b) Tarifa dhe komisione**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit (shënimi (3a)).
Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, shitjet nga komisioni dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.
Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

**3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**

**(c) Shpenzimet e tatimit**

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të

ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

*(i) Tatimi aktual*
Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

*(ii) Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërisht për të kompensuar detyrimet dhe pasuritë tatimore afatshkurtera dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor.

Taksat shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendëve nga Banka njihen në të njëjtën kohë me njohjen e detyrimit për të paguar dividentin përkatës.

*(iii) Ekspozimet tatimore*
Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore

ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

**(d) Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet e shprehura në valutë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, përveç aktiveve dhe detyrimeve jomonetare të matura me koston historike, të cilat përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën fillestare të transaksionit.

**(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare**

*(i) Njohja*

Banka fillimisht njeh kreditë, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat dhe huamarrjet dhe borxhet e varura në datën që ato janë krijuar.Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të pasurive financiare)fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

*(ii) Klasifikimi*

***Pasuritë financiare***

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDNFH.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja këto kushte dhe është
nuk është caktuar si në VDNFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

## 3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

### (e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(ii) Klasifikimi (vazhdim)*
***Pasuritë financiare (vazhdim)***
Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH:

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Këto zgjedhje bëhen në bazë të investim pas investimi.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose në VDATGJ.

***Riklasifikimet***

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

***Detyrimet financiare***

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare matur me koston e amortizuar.

*(iii) Çregjistrimi*

***Pasuritë financiare***

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjen e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban
kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes transferohet në pasuri financiare që kualifikohen për mosnjohje që krijohen ose mbahen nga Banka njihen si një pasuri ose detyrim i veçantë.

***Detyrimet financiare***

Banka ç'regjistron një pasuri financiare kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose mbarojnë.

*(iv) Ndryshimet e pasurive financiare*

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të pasurisë të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse flukset e mjeteve monetare janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në flukset e mjeteve monetare nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale çregjistrohen dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse rrjedhat e parasë të pasurisë të modifikuar të mbartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, Banka rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim

ose humbje modifikimi në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

*(v) Netimi*
Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

**3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**

**(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

*(vii) Matja e vlerës së drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merret për të shitur një pasuri ose për të paguar transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principalin ose në mungesë të saj tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.
Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - përshembull vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.Nëse një pasuri ose një detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkeses, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet afatgjata me një çmim të ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra me një çmim të kërkeses.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës .

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*
Banka njeh humbjet e lejimeve për HPK për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk janë
matur në VDNFH:
- kreditë për klientët;
- pasuritë tjera financiare me kosto të amortizuar;
- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- zotimete e huasë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë,

zhvlerësimi është matur nën SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontigjente).
Banka do të njohë lejimet e humbjeve në një shumë të barabartë me Jetëgjatësinë HPK, përveç rasteve të mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit. Banka e konsideron një siguri borxhi të ketë rrezik të ulët të kreditit kur vlerësimi i rrezikut të tij të kredisë është i barabartë me përkufizimin e kuptimit global të 'klasës së investimit'; dhe
- kreditë dhe letrat me vlerë të investimit të borxhit për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

**3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**

**(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)**
*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

***Matje e HPK***
HPK të janë një vlerësim i ponderuar me probabilitet i humbjeve të kredisë dhe do të matet si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të dëmtuara me kredi në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mangësive në të holla - dmth. Diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të dëmtuara nga kreditë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara ;
- zotimet e huazuara: vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen Bankës nëse tërheqja e zotimit dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë; dhe
- kontratat e garancisë financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të mbulojë.

### *Përkufizimi i dështimit*

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një pasuri financiare të dështuar kur:

- humarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e saj të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie për Bankën.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose të humbura.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Banka do të konsiderojë tregues që janë në përputhje me kërkesat rregullatore të rrezikut për klasifikimin e huave si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e marrëveshjes kontraktuale;
- sasiore: p.sh. statusi i vonuar dhe mospagesa e një detyrimi tjetër të huamarrësit të njëjtë në Bankë; d
- klasifikimi i rrezikut rregullator të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera. Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në dështim dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet në rrethanat.

### *Nivelet e rrezikut të kredisë*

Banka cakton çdo ekspozim në një klasë të rrezikut të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë rrezikun e mosplotësimit. Krahas klasave të rrezikut të prezantuara për qëllime rregullative, Banka identifikon dhe monitoron veçmas huatë standarde në të kaluarën nga kreditë standarde jo në të kaluarën.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të rrezikut të kredisë për njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do t'i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, gjë që mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë të rrezikut të kredisë

## 3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

## (e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

***Përcaktimi nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm***

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë (dmth. rreziku i dështimit) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe mbështetëse që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informacion cilësor dhe analiza bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e kredive të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Banka do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e rrezikut rregullator nga standardi për tu shikuar në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e rrezikut rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë klasifikohen në Fazën 2.

Si një ndihmesë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë vonesë. Banka do të përcaktojë ditët në vonesë duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e vonuar për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Banka monitoron efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar atë:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë ;

- koha mesatare e identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe mospagimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet përgjithësisht nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja e HPK-së 12-mujore në kreditë e zhvlerësuara.

***Mjetet financiare të modifikuara***

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të tanishëm ose potencial të kredisë të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuar, mund të çregjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.
Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare ndryshohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, Banka do të shqyrtojë nëse rreziku i kredisë së pasurisë është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në rrezikun e mosplotësimit.

Banka rinegocion kredi për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitetet e ristrukturimeve) për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar rrezikun e mospagimit. Sipas politikës së ristrukturimeve së bankës, lëkundja e huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ka një rrezik të lartë të mospagimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kontratës fillestare kushtet dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Termat e rishikuar zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të besëlidhjeve të huasë. Të dy kreditë me pakicë dhe biznesi janë subjekt i politikës së durimit.

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i dështimit dhe zhvlerësimit të kredisë dhe pritjet e ristrukturimeve janë relevante për të vlerësuar nëse ka një rritje

të konsiderueshme të kredisë.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave në mënyrë të qëndrueshme gjatë tetë muajve para se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK 12-mujore.

## 3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

## (e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

***Inputet në matjen e HPK***

Inputet kryesore në matjen e HPK është e mundur të jenë struktura e termave të variablave në vijim:

- probabiliteti i dështimit (PD)
- humbja e dhënë nga dështimi (HDHD), dhe
- ekspozimi ndaj dështimit (END).

Këta parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. PD-të janë rregulluar për të pasqyruar informacionin largpamës, siç përcaktohet më poshtë.
Nivelet e rrezikut të kredisë do të jenë një input primar në përcaktimin e strukturës së afateve të PD për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD të jetës së mbetur të ekspozimeve dhe si këto pritet të ndryshojnë si rezultat i kalimit të kohës.

Kjo analizë përfshin identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e mospagimit dhe ndryshimeve në faktorët makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvoja e ristrukturimeve) mbi rrezikun e mospagimit. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë kanë të ngjarë të përfshijnë normat e papunësisë dhe inflacionin e çmimeve të konsumit. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacionit largpamës në këtë vlerësim diskutohet më poshtë.

HDHD është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një dështim. Banka do të vlerësojë parametrat HDHD bazuar në historinë e normave të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të kundërta. Modelet HDHD do të konsiderojnë strukturën,

kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivit financiar. Për kreditë e siguruara nga prona me pakicë, raportet e kredisë për vlerën (RKV) ka gjasa të jenë një parametër kyç në përcaktimin e HDHD.

Vlerësimet HDHD do të kalibrohen për faktore te jashtem të ndryshëm, si për huadhënien e pasurive të paluajtshme, të pasqyrojnë ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës.

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një deshtimi. Banka do të nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. END i një aktivi financiar do të jetë vlera kontabël bruto në mungesë. Për angazhimet e kreditimit dhe garancitë financiare, END do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të nxirren ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrojtimet historike.

Banka do të matë HPK-në duke marrë në konsideratë rrezikun e mosplotësimit për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse për qëllime të administrimit të rrezikut Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për mbitërheqjet me pakicë dhe pajisjet e kredit kartelës dhe disa struktura rrotulluese korporative që përfshijnë të dyja një hua dhe një përbërës të zotimit të padeklaruar, Banka do të matë HPK-në për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e angazhimit të paditur nuk e kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kreditit në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto objekte nuk

kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka vihet në dijeni për një rritje të rrezikut të kredisë në nivel kredie. Kjo periudhë më e gjatë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të rrezikut të kredisë që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë reduktimin e kufijve dhe anulimin e objektit.

## 3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

## (e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të njihen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut që përfshijnë:
– llojet e intrsumenteve; dhe
– klasifikimi i rrezikut të kredisë.

Njohja do t'i nënshtrohet rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një banke të veçantë të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.
Për investimet në letrat me vlerë të borxhit në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacion i jashtëm i referencës i publikuar nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kreditit siç është Moody's do të përdoret për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

***Informacione me vështrim të mëtejshëm***

Lejimet e humbjeve për HPK është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:
Sipas SNRF 9, Banka ka përfshirë informacione me vështrim të mëtejshëm në vlerësimin e saj nëse rreziku i kredisë i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e saj e HPK-ve. Banka formulon një pamje të 'rastit bazë' të drejtimit të ardhshëm të variablave përkatës ekonomikë dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat nga Komiteti i Riskut të Bankës dhe ekspertët ekonomikë dhe duke marrë në konsideratë një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe të parashikuara. Ky proces përfshin zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe marrjen në konsideratë të probabiliteteve relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga

Ne kemi audituar pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese të Banka Ekonomike Sh.A. dhe filialit të saj (Grupi), të cilat përfshjnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes ose të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që përfundon, dhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë politikat kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2024, dhe performancën e tij financiare të konsoliduar dhe rrjedhen e parasë të konsoliduar për vitin e përfunduar në përputhje me bazën të përgatitjes siç shpjegohet në shënimin 2(a) të pasqyrave të konsoliduara financiare shoqëruese.

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin *'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare'* në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave të konsoliduara financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

**RSM KOSOVO SH.P.K.**

Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja B-C,
Kati 2, No.B56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DL +383 45 666 888

www.rsm.global/kosovo

Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

## Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Grupit, por nuk përfshijnë pasqyrat e konsoliduara financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Grupit pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat e konsoliduara financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave të konsoliduara financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuara më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat e konsoliduara financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me bazën e përgatitjes siç shpaloset në shënimin 2(a), dhe për një kontroll të tillë të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat e konsoliduara financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra të konsoliduara financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave të konsoliduara financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Grupit. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat e konsoliduara financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Grupi të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të përshtatshme auditimi në lidhje me informacionin financiar të njësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

**RSM Kosovo Sh.p.k.**

Prishtina, Republika e Kosovës

21 Prill 2025

**Sadik Berisha**

Auditor Ligjor

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2024 (Shumat në mijë euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

| Pasuritë | Shënimi | Më 31 dhjetor 2024 | Më 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Paraja e gatshme dhe në banka | 6 | 41,070 | 54,549 |
| Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës | 7 | 60,555 | 74,682 |
| Depozitat me afat | 8 | 6,481 | 5,363 |
| Kreditë për klientët | 9 | 491,220 | 441,298 |
| Investime në letra me vlerë | 10 | 60,831 | 15,689 |
| Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi | 11 | 16,820 | 17,042 |
| Pasuritë e paprekshme | 12 | 5,095 | 5,719 |
| Paradhënie për tatimin mbi të ardhurat | | 179 | - |
| Pasuri të tjera | 13 | 8,632 | 7,826 |
| **Gjithsej pasuritë** | | **690,883** | **622,168** |
| **Detyrimet** | | | |
| Depozitat nga klientët | 14 | 591,773 | 532,619 |
| Detyrime ndaj bankave | 15 | 1,096 | 1,487 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 16 | 12,107 | 11,783 |
| Depozitat nga klientët | 14 | 591,773 | 532,619 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 16 | 12,107 | 11,783 |
| Provizioni për prime të pafituara | 17 | 6,427 | 5,168 |
| Borxhi i varur | 18 | 200 | - |
| Detyrimi i tatimit në fitim | | - | 142 |
| Detyrime të tjera | 19 | 4,856 | 5,135 |
| Detyrimi i shtyer tatimor | | 596 | 600 |
| **Gjithsej detyrimet** | | **617,055** | **556,934** |
| **Ekuiteti dhe rezervat** | | | |
| Kapitali aksionar | 20 | 29,422 | 29,422 |
| Rivlerësimi dhe rezervat tjera | 20 | 4,887 | 4,746 |
| Fitime të mbajtura | | 39,519 | 31,066 |
| **Gjithsej ekuiteti dhe rezervat** | | **73,828** | **65,234** |
| **Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat** | | **690,883** | **622,168** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues dhe nënshkruar në emër të tyre më 18 Prill 2025 nga:

Zt. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv

Zt. Berat Isa
Zyrtar Kryesor Financiar



| | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv | 21 | 36,260 | 30,941 |
| Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv | 21 | (7,673) | (5,417) |
| **Të ardhurat neto nga interesi** | | **28,587** | **25,524** |
| Të ardhurat nga tarifa dhe komisione | 22 | 5,941 | 4,776 |
| Shpenzimet nga tarifa dhe komisione | 22 | (1,667) | (1,201) |
| **Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione** | | **4,274** | **3,575** |
| Primet e fituara neto, neto nga tatimi mbi primin | 17 | 11,532 | 9,463 |
| Të ardhura të tjera operative, neto | 23 | 1,042 | 1,054 |
| **Të ardhurat** | | **45,435** | **39,616** |
| Shpenzimet e personelit | 24 | (7,834) | (6,781) |
| Zhvleresimi dhe amortizimi | 11,12 | (3,601) | (3,276) |
| Shpenzime të tjera | 25 | (13,967) | (9,963) |
| Shpenzimet e provizioneve teknike | 16 | (6,641) | (6,268) |
| (Lirimi)/ngarkesa e lejimit te humbjeve neto në instrumentet financiare | 6,7,8,9,10 | (342) | 1,380 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme | 12 | (365) | (942) |
| **Gjithsej shpenzimet operative** | | **(32,750)** | **(25,850)** |
| | | | |
| **Fitimi para tatimit** | | **12,685** | **13,766** |
| Tatimi në fitim | 26 | (1,232) | (1,296) |
| **Fitimi neto për vitin** | | **11,453** | **12,470** |
| | | | |
| **Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse** | | | |
| *Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas ne Fitim ose Humbje* | | | |
| Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi | | - | - |
| Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës | | 4 | 18 |
| Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse | | 137 | (125) |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi** | | **141** | **(107)** |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | | **11,594** | **12,363** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

| | Kapitali aksionar | Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera | Fitimet e mbajtura | Gjithsej ekuiteti dhe rezervat |
|---|---|---|---|---|
| **Me 01 Janar 2023** | **29,422** | **4,853** | **18,596** | **52,871** |
| Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet | | | | |
| Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët | - | - | - | - |
| Dividenta e shpërndarë (Shënimi 20) | - | - | - | - |
| **Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet** | - | - | - | - |
| Fitimi për vitin | - | - | 12,470 | 12,470 |
| *Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin* | | | | |
| Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi | - | 18 | - | 18 |
| Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi) | - | (125) | - | (125) |
| Transfer | - | - | - | - |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | **-** | **(107)** | **12,470** | **12,363** |
| **Më 31 Dhjetor 2023** | **29,422** | **4,746** | **31,066** | **65,234** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Me 01 Janar 2024** | **29,422** | **4,746** | **31,066** | **65,234** |
| Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet | | | | |
| Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët | - | - | - | - |
| Dividenta e shpërndarë (Shënimi 20) | - | - | (3,000) | (3,000) |
| **Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet** | - | - | **(3,000)** | **(3,000)** |
| Fitimi për vitin | - | - | 11,453 | 11,453 |
| *Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin* | | | | |
| Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi | - | 4 | - | 4 |
| Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi) | - | 137 | - | 137t |
| Transfer | - | - | - | - |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin** | **-** | **141** | **11,453** | **11,594** |
| **Më 31 Dhjetor 2024** | **29,422** | **4,887** | **39,519** | **73,828** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

| | Shënimi | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| **Aktivitete operative** | | | |
| Fitimi para tatimit | | 12,685 | 13,766 |
| Amortizimin dhe zhvlerësimin | 10,11 | 3,601 | 3,276 |
| (Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në kreditë për klientët | 9 | 283 | (1,375) |
| Shpenzimet e Humbjeve dhe Rregullimeve të Humbjeve | 16 | 6,641 | 6,268 |
| Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme | 12 | 365 | 942 |
| Zhvlerësimi i aseteve të tjera | | 620 | - |
| Lirimet e provizionit për garancitë | 19 | (47) | (78) |
| Të ardhurat nga interesi | 21 | (36,260) | (30,941) |
| | | **(4,439)** | **(2,725)** |
| *Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative* | | | |
| Rezerva statutore me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara | | (16,265) | 1,951 |
| **Kreditë për klientët** | | **(50,546)** | **(59,385)** |
| Pasuri të tjera | | (1,596) | 35 |
| Depozitat nga klientët | | 58,281 | 30,822 |
| Detyrime ndaj bankave | | (391) | 1,394 |
| **Detyrimet e provizioneve teknike** | | **(6,317)** | **(6,112)** |
| Provizioni për prime të pafituara | | 1,259 | 334 |
| **Detyrime të tjera** | | **946** | **(939)** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **(19,068)** | **(34,625)** |
| Interesi i paguar | | (6,800) | (4,469) |
| Interesi i arkëtuar | | 36,601 | 30,388 |
| Tatim mbi të ardhurat i paguar | | (1,553) | (1,248) |
| **Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga /(përdorur në) aktivitetet investuese** | | **9,180** | **(9,954)** |
| **Aktivitete investuese** | | | |
| Blerjet e pronave dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme | 11,12 | (3,060) | (1,521) |
| Blerjet e investimeve në letra me vlerë | 10 | (183,081) | (11,742) |
| Shitjet e investimeve në letra me vlerë | 10 | 138,186 | 26,111 |
| (Rritja)/zvogëlimi i depozitave me afat | | (1,118) | 1,351 |
| **Neto rrjedha e parasë e (përdorur në) /gjeneruar nga aktivitetet investuese** | | **(49,073)** | **14,199** |
| **Aktivitete financiare** | | | |
| Borxhi i varur | 18 | 200 | - |
| Shlyerja e detyrimit të qirasë | 11 | (1,178) | (1,117) |
| Dividentët e paguar | 20 | (3,000) | - |
| **Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet financiare** | | **(3,978)** | **(1,117)** |
| **Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj** | | **(43,871)** | **3,128** |
| Paraja dhe ekuivalentët e saj, fillim të vitit | 6 | 96,373 | 93,245 |
| **Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit** | **6** | **52,502** | **96,373** |

Shënimet shoqëruese nga 1 në 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

## 1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a ("Shoqëria Mëmë") është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Shoqëria Mëmë ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Shoqëria Mëmë operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 22 nëndegë. Shoqëria Mëmë ka të punësuar 450 punonjës më 31 Dhjetor 2024 (2023: 441).

Në 9 Shtator 2022, Shoqëria Mëmë përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiala") përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Filiales. Më 31 Dhjetor 2024, Shoqëria Mëmë zotëron 100% të aksioneve në Filialë.

Filiala është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me numër biznesi 70167671 si shoqëri aksionare.

Filiala është e licencuar si kompani e sigurimeve jo të jetës. Veprimtaria kryesore e Filialës është sigurimi motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe klasa të tjera të sigurimit të tilla si:
- Sigurimi i pronave;
- Të gjitha Risqet gjatë Ndërtimit (CAR);
- Sigurimi shëndetësor gjatë udhëtimit;
- Aksidentet personale;
- Sigurimi Gjithëpërfshirës i Automjeteve Motorike, etj.

Selia e regjistruar e Filialës gjendet në rrugën Luan Haradinaj, Llamella A, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Më 31 Dhjetor 2024 Filiala ka gjithsej 129 të punësuar dhe menaxhment të lartë (2023: 125).

Shoqëria mëmë, së bashku me filialin e saj të konsoliduar vendas (bashkë, "Grupi"), janë institucione financiare të rregulluara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërise mëmë përfshijnë llogaritë e Komapnisë.

## 2. Baza e përgatitjes

### (a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Interpretimet (së bashku SNRF), me përjashtim të SNRF 17. SNRF 17 nuk zbatohet më 31 dhjetor 2024, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për vazhdimin e afatit për zbatimin e këtij standardi. Zbatimi i SNRF 17 do të jetë në fuqi për periudhën e raportimit vjetor që fillon më 1 janar 2026. Megjithatë, faza përgatitore dhe plani i veprimit nga Grupi duhet të përfshijë aktivitete dhe veprime konkrete duke filluar nga viti 2024, drejt përgatitjes për zbatimin e plotë të këtij standardi deri në fund të vitit 2025. Kështu, këto pasqyra financiare nuk mund të lexohen si të përgatitura në përputhje me SNRF-të. Bazat e matjes përshkruhen më plotësisht në politikat kontabël më poshtë.

### b) Paraqitja e pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime qartësie, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe shënimet në pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare të konsoliduara, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime

## 2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

### (c) Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Grupi

Grupi, me përjashtim të SNRF 17, ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. SNRF 17 nuk është zbatuar, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për zgjatjen e afatit për zbatimin e këtij standardi. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimit, përveç IRFS 17, nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 Janar 2024:

- Amendamentet në IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare - Klasifikimi i Detyrimeve si Të Shkurtra ose të Gjatë dhe Amendamentet në IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare - Detyrimet e Gjatë me Kushtet.
- Amendamentet në IAS 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe IFRS 7 Instrumentet Financiare: Zbulime - Marrëveshjet e Financimit të Furnizuesve.
- Amendamentet në IFRS 16 Qirate - Detyrimi i Qirasë në Një Shitje dhe Riarendim i Qirasë.

Grupi është aktualisht në fazat fillestare të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të SNRF 17 Kontratat e Sigurimit në pasqyrat e tij financiare. Në këtë moment, bazuar në vlerësimin tonë fillestar, menagjemnti nuk parashikon një ndikim material në pozicionin ose performancën financiare të Grupit. Megjithatë, duke pasur parasysh

kompleksitetin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit, nuk mund të konkludohet përfundimisht se nuk do të ketë ndikim material. Prandaj, ne e kuptojmë rëndësinë e zbulimit të kësaj pasigurie. Prandaj, ne e pranojmë se efekti i zbatimit nuk mund të përcaktohet me siguri absolute në këtë moment.
Me përjashtim të SNRF 17 dhe nëse nuk shpaloset më sipër, standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja nuk pritet të kenë një efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

**(d) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive**

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave të konsoliduara financiare të Grupit janë shpalosur më poshtë. Grupi synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- Amendamentet në IAS 21 Efektet e Ndryshimeve në Normat e Këmbimit të Monedhës - Mungesa e Ndryshueshmërisë - në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2025.
- Amendamentet në IFRS 9 dhe IFRS 7 - Amendamentet në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare - në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 9 dhe IFRS 7 - Kontratave që Referencojnë Energjinë Elektrike të Varur nga Natyrë – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 1, IFRS 7, IFRS 9, IFRS 10 dhe IAS 7 - Përmirësime Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit IFRS - Vëllimi 11 – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- IFRS 18 Prezentimi dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2027.
- IFRS 19 Subsidiarët pa Pëgjegjësi Publike: Zbulimet – në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026.
- Amendamentet në IFRS 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe IAS 28 Investimet në Shoqëri dhe Ndërmarrje të Pajtueshme - Shitja ose Kontributi i

Pasurive mes një Investitori dhe Shoqërisë së tij të Pajtueshme ose Ndërmarrjes së Pajtueshme - data e efektivitetit shtyrë nga IASB përkohësisht, por aplikimi i hershëm lejohet.

Grupi ka zgjedhur të mos miratojë para kohe këto deklarata dhe është në proces të analizimit të ndikimit të adoptimit të këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve në pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit në periudhën e aplikimit fillestar.

**(d) Baza e kontabilitetit**

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përgatitur ne baze te konventës së kostos historike, me përjashtim të pasurive financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit të mbajtura për mbledhje dhe shitje dhe klasa të caktuara të pronave, impianteve dhe pajisjeve

**2. Baza e përgatitjes (vazhdim)**

**(e) Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat e konsoliduara financiare përgatiten mbi bazën e vijmësisë, pasi Drejtorët janë të kënaqur që grupi ka burime për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë parashikimet e ardhshme të përfitimit, flukset monetare, kërkesat për kapital dhe burimet kapitale. Këto konsiderata përfshijnë skenarë të theksuar. Ata gjithashtu morën parasysh rreziqe të tjera kryesore, si dhe nga ndikimet e lidhura me përfitimin, kapitalin dhe likuiditetin.

**(f) Valuta funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra individuale financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Grupit. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç ku shprehet ndryshe

**(f) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimi**

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave te konsoliduara financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Grupit dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.
Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 29.

**3. Politikat materiale kontabël**

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra te konsoliduara financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

**(a) Kombinimet e biznesit**

**Blerja e bizneseve llogaritet duke përdorur metodën e blerjes.**

Kur shoqëria mëmë ka kontroll mbi një të investuar, ajo klasifikohet si një filial. Shoqëria mëmë kontrollon një të investuar nëse të tre elementët e mëposhtëm janë të pranishëm: fuqia mbi të investuarin, ekspozimi ndaj kthimeve të

ndryshueshme nga i investuari dhe aftësia e investitorit për të përdorur fuqinë e tij për të ndikuar në ato kthime të ndryshueshme.
Pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin rezultatet e shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj ("Grupi") sikur të ishin një njësi ekonomike e vetme.

*(i) Interesat jo kontrolluese*

Grupi fillimisht njeh çdo interes jo kontrollues në të blerin, i cili është një interes aktual pronësor dhe u jep të drejtë zotëruesve të tij për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike në rast likuidimi ose me vlerën e drejtë në datën e blerjes ose, me instrumentet aktuale të pronësisë. pjesë proporcionale në shumat e njohura të aktiveve neto të identifikueshme të të blerit.

*(ii) Emri i mirë*

Emri i mirë përfaqëson tejkalimin e kostos së një kombinimi biznesi mbi interesin e Grupit në vlerën e drejtë të pasurive, detyrimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara të identifikueshme të blera. Kostoja përfshin vlerën e drejtë të pasurive të dhëna, detyrimet e marra përsipër dhe instrumentet e kapitalit të emetuar, plus shumën e çdo interesi jo kontrollues në të blerin plus, nëse kombinimi i biznesit arrihet në faza, vlerën e drejtë të interesit ekzistues të kapitalit neto në fitues. Emri i mirë kapitalizohet si pasuri e paprekshme dhe nuk amortizohet. Në vend të kësaj, emri i mirë testohet çdo vit për zhvlerësim, ose më shpesh nëse ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se ai mund të zhvlerësohet.

**(b) Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare, duke përjashtuar ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim, njihen në 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Interesi mbi pasuritë financiare të zhvlerësuara nga kredia njihet duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (d.m.th., vlerën kontabël bruto

të aktivit minus provizionin për HPK).
Për pasuritë financiare të blera ose të origjinës të dëmtuara nga kredia ('POCI'), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI të rregulluar nga kredia dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e rregulluar nga kredia është norma e interesit që, në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme monetare të vlerësuara (përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të pasurive POCI.

**c) Tarifa dhe komisione**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit (shënimi (3a)).

Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, shitjet nga komisioni dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

Mbajtësit e policave të kontratës së sigurimit ngarkohen për shërbimet e administrimit të policave dhe tarifat e tjera të kontratës. Këto tarifa njihen si të ardhura gjatë periudhës në të cilën janë kryer shërbimet përkatëse.

**(d) Të ardhura nga primet**

Primet e përgjithshme të shkruara të biznesit përfshijnë primet e kontratave të lidhura në vitin financiar, pavarësisht nëse ato lidhen tërësisht ose pjesërisht me një

periudhë kontabël të mëvonshme. Primet e shkruara shpalosen bruto të komisionit të pagueshëm ndaj ndërmjetësve. Pjesa e fituar e primeve të marra njihet si e ardhur. Primet fitohen nga data e lidhjes së rrezikut, gjatë periudhës së dëmshpërblimit, bazuar në modelin e rreziqeve të nënshkruara. Provizioni për primet e pafituara përfshin pjesën e primeve bruto të shkruara që vlerësohet të fitohen në vitin financiar vijues, duke përdorur bazën ditore proporcionale 1/365, e rregulluar, nëse është e nevojshme, për të pasqyruar çdo ndryshim në incidencën e rrezikut gjatë periudha e mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet në fuqi nga Grupi kanë rrezik linear dhe aktualisht nuk janë bërë rregullime për variacionin e rreziqeve.

### (e) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

### (i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

### (ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të pasurive ose detyrimeve në një transaksion që

nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërisht për të kompensuar detyrimet dhe pasuritë tatimore afatshkurtera dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor.

Taksat shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi njihen në të njëjtën kohë me njohjen e detyrimit për të paguar dividentin përkatës.

**3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**

**(iii) Ekspozimet tatimore**

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Grupi merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

**(f) Përfitimet dhe kërkesat**

Përfitimet dhe dëmet bruto përbëhen nga përfitimet dhe dëmet e paguara ndaj të siguruarit, si dhe ndryshimet në vlerësimin bruto të sigurimit dhe të detyrimeve të kontratave të investimit, përveç ndryshimeve bruto në provizionet e primit të pa

fituar të cilat regjistrohen në të ardhurat e primeve. Për më tepër përfshin dëmet e brendshme dhe të jashtme të trajtimit të dëmet që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin dhe shlyerjen e dëmet. Dëmet e sigurimeve regjistrohen në bazë të njoftimeve të pranuara.

## (g) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet e shprehura në valutë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, përveç aktiveve dhe detyrimeve jomonetare të matura me koston historike, të cilat përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën fillestare të transaksionit.

## (h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

*(i) Njohja*

Grupi fillimisht njeh huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuara, huamarrjet dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Grupi bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

*(ii) Klasifikimi*

***Pasuritë financiare***

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDNFH.
Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja këto kushte dhe është
nuk është caktuar si në VDNFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH:

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Grupi mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Këto zgjedhje bëhen në bazë të investim pas investimi.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose në VDATGJ.

Grupi nuk zotëron pasuri financiare që mbahen për tregtim ose menaxhohen dhe performanca e të cilave vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, maten me VDATGJ.

**3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**

**(h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

***Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit***

Grupi mban një portofol kredish afatgjata me normë fikse për të cilat Grupi ka mundësinë të propozojë të rishikojë normën e interesit në datat periodike të rivendosjes. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një opsion ose të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë kredinë në vlerën nominale pa penalitet. Grupi ka përcaktuar se flukset monetare kontraktuale të këtyre kredive janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që merr parasysh vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shuma kryesore e papaguar.

**Riklasifikimet**

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

***Detyrimet financiare***

Grupi klasifikon detyrimet e saj financiare matur me koston e amortizuar.

*(iii) Çregjistrimi*

***Pasuritë financiare***

Grupi çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjen e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Grupi as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes transferohet në pasuri financiare që kualifikohen për mosnjohje që krijohen ose mbahen nga

Grupi njihen si një pasuri ose detyrim i veçantë.

***Detyrimet financiare***

Grupi ç'regjistron një pasuri financiare kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose mbarojnë.

*(iv) Ndryshimet e pasurive financiare*

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Grupi vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të pasurisë të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse flukset e mjeteve monetare janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në flukset e mjeteve monetare nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale çregjistrohen dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse rrjedhat e parasë të pasurisë të modifikuar të mbartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, Grupi rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje modifikimi në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

*(v) Netimi*

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen sipas SNRF-ve, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup transaksionesh të ngjashme si p.sh. në aktivitetin tregtar të Grupit.

*(vii) Matja e vlerës së drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merret për të shitur një pasuri ose për të paguar transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principalin ose në mungesë të saj tregun më të favorshëm në të cilin Grupi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës.

## 3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

### (h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(vii) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)*

Kur është e mundur, Grupi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Grupi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e i nputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - përshembull vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Grupi vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.Nëse një pasuri ose një detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkeses, atëherë Grupi mat pasuritë dhe pozicionet afatgjata me një çmim të ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra me një çmim të kërkeses.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës.

Grupi njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Grupi njeh humbjet e lejimeve për HPK për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk janë matur në VDNFH:
- kreditë për klientët;
- pasuritë tjera financiare me kosto të amortizuar;
- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- zotimete e huasë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi është matur nën SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontigjente).

Grupi do të njohë lejimet e humbjeve në një shumë të barabartë me Jetëgjatësinë HPK, përveç rasteve të mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:
- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit. Grupi e konsideron një siguri borxhi të ketë rrezik të ulët të kreditit kur vlerësimi i rrezikut të tij të kredisë është i barabartë me përkufizimin e kuptimit global të 'klasës së investimit'; dhe
- kreditë dhe letrat me vlerë të investimit të borxhit për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

***Matje e HPK***

HPK të janë një vlerësim i ponderuar me probabilitet i humbjeve të kredisë dhe do të matet si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të dëmtuara në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mangësive në të holla - dmth. Diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Grupi pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të dëmtuara nga kreditë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;
- zotimet e huazuara: vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen Grupit nëse tërheqja e zotimit dhe flukset e mjeteve monetare që Grupi pret të marrë; dhe
- kontratat e garancisë financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Grupi pret të mbulojë.

## 3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

## (h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

### *Përkufizimi i dështimit*

Sipas SNRF 9, Grupi do të konsiderojë një pasuri financiare të dështuar kur:
- humarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e saj të kredisë në Grup në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Grupit për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie për Grupin.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose të humbura.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Grupi do të konsiderojë tregues që janë në përputhje me kërkesat rregullatore të rrezikut për klasifikimin e huave si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e marrëveshjes kontraktuale;
- sasiore: p.sh. statusi i vonuar dhe mospagesa e një detyrimi tjetër të huamarrësit të njëjtë në Grup; dhe
- klasifikimi i rrezikut rregullator të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në dështim dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet në rrethanat.

***Nivelet e rrezikut të kredisë***

Grupi cakton çdo ekspozim në një klasë të rrezikut të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë rrezikun e mosplotësimit. Krahas klasave të rrezikut të prezantuara për qëllime rregullative, Grupi identifikon dhe monitoron veçmas huatë standarde në të kaluarën nga kreditë standarde jo në të kaluarën.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të rrezikut të kredisë për njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do t'i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, gjë që mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë të rrezikut të kredisë.

***Përcaktimi nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm***

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë (dmth. rreziku i dështimit) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Grupi do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe mbështetëse që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informacion cilësor dhe analiza bazuar në përvojën historike të Grupit, vlerësimin e kredive të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Grupi do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e rrezikut rregullator nga standardi për tu shikuar në përputhje me politikën e Grupit për klasifikimin e rrezikut rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë klasifikohen në Fazën 2.

Si një ndihmesë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Grupi me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë vonesë.

Grupi do të përcaktojë ditët në vonesë duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e vonuar për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Grupi monitoron efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar atë:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë;
- koha mesatare e identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe mospagimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet përgjithësisht nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja e HPK-së 12-mujore në kreditë e zhvlerësuara.

## 3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

## (h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

*(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)*

### *Mjetet financiare të modifikuara*

Grupi vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë euro që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Grupi dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Grupit. (2023: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

*Kreditë në vonesë por të pazhvlerësuara*
Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Grupit.

*Kredi me kushte të rinegociuara*
Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

*Politika e shlyerjes*

Grupi fshin një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i fshirjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin Gjithsej. Shuma gjithsej e fshirë gjatë vitit 2024, është 3,031 mijë euro (2023: 941 mijë euro).

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## (b) Rreziku kreditor (vazhdim)

*Depozita nga bankat*
Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Gupi kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.
Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim Gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

| Me 31 dhjetor | 2024 | 2023 |
|---|---|---|
| AAA to AA- | 1,744 | - |
| AAA+ to BBB- | - | 19,097 |
| A+ to A- | 3,906 | 781 |
| BBB+ to BBB- | 4,134 | - |
| BBB+ to B- | - | 16,676 |
| BB+ to B- | 3,257 | - |
| Not Rated | - | 3,082 |
| Local Banks | 16,757 | 7,151 |
| | **29,798** | **46,787** |

*Investimet në letrat me vlerë*
Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.
Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Grupi duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

**Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes**
Grupi menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.
Grupi strukturon nivelet e rrezikut kreditor që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe

i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollet e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

*Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar*

Grupi mban kolateral kundrejt kredive ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
## (b) Rreziku kreditor (vazhdim)

| | 2024 | | 2023 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Loans to customers** | **FV of collateral** | **Loans to customers** | **FV of collateral** |
| Hipoteka | 197,910 | 652,489 | 177,919 | 6599,103 |
| Kolateral në mjete monetare | 16,148 | 18,102 | 16,207 | 16,207 |
| Pengje | 162,034 | 367,979 | 159,949 | 328,180 |
| Miks (hipoteke dhe peng) | 57,116 | 261,195 | 58,412 | 300,904 |
| Pa kolateral | 67,902 | - | 39,080 | - |
| **Gjithsej** | **501,110** | **1,299,765** | **451,567** | **1,244,394** |

### Përqendrimi i rrezikut kreditor

Më 31 Dhjetor 2024, Grupi ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të pare. Ekspozimi më i lartë ishte në: 11.74%, gjithsej ishin pesë ekspozime ndaj kredive që tejkalonin 10% të kapitalit të nivelit të pare (2023: 14.65%, pesë ekspozime të kredive). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 Dhjetor 2024, përfaqëson 9.92% (2023: 18.37%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 3.77% (2023: 2.86%) të kapitali të nivelit të parë.

Grupi monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

| | Kredi për klientët | | Investime në letra me vlerë | | Gjendja me bankat dhe BQK | | Garancitë financiare | | Kredi për klientët | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 |
| **Përqendrimi sipas sektorëve** | | | | | | | | | | |
| Korporative | 172,825 | 161,835 | - | - | - | - | - | - | 10,156 | 9,925 |
| Qeveria | - | - | 60,831 | 15,689 | 6,481 | 5,363 | - | - | - | - |
| Bankat | - | - | - | - | - | - | 83,611 | 115,784 | - | - |
| Individët | 161,643 | 141,327 | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Mikro entitete | 156,752 | 138,136 | - | - | - | - | - | - | 3,050 | 2,882 |
| Gjithsej | 491,220 | 441,298 | 60,831 | 15,689 | 6,481 | 5,363 | 83,611 | 115,784 | 13,206 | 12,807 |
| Përqendrimi sipas vend--ndodhjes | | | | | | | | | | |
| Vendet e BE-së | - | - | - | - | - | - | 21,308 | 39,648 | - | - |
| Rep. e Kosovës | 491,220 | 441,298 | 60,831 | 15,689 | 6,481 | 5,363 | 62,303 | 76,136 | 13,206 | 12,807 |
| **Gjithsej** | **491,220** | **441,298** | **60,831** | **15,689** | **6,481** | **5,363** | **83,611** | **115,784** | **13,206** | **12,807** |

## Pasojat e luftës Ukrainë-Rusi

Pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse dhe reagimi i mëpasshëm global ndaj këtyre veprimeve ushtarake mund të kenë efekte të rëndësishme financiare në shumë entitete dhe tregje financiare. Këto përfshijnë subjekte me operacione fizike në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi, si dhe interesa indirekte. Grupi nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rusisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, Grupi po monitoron vazhdimisht zhvillimet në lidhje me efektet e luftës Ukrainë-Rusi. Pozicioni financiar i Grupit vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si dhe në të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet.

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Grupit ose ne vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimi te rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

### Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është rregulluar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të Grupit kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Grupit janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Grupi përpiqet të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

Ekspozimet e Grupit janë të bazuara normat e interesit të shënuara të Kosovës dhe Grupi ballafaqohet vetëm me rrezik te rivënjes së çmimit.
Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Grupit në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Thesarit monitoron në mënyrë konstante rrezikun e normave të interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për riçmimin ose rialokimin me miratimin e Komisionit te Pasurive dhe Detyrimeve. Raporti lidhur me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komisionit për Pasuri dhe Detyrime. Janë marrë masat e nevojshme nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analiza për depozituesit kryesorë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet në analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analizën e GAP-it mbi rrezikun e likuiditetit **Ekspozimi ndaj Rrezikut të Normës së Interesit**

Operacionet e Grupi janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Grupi është i ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e riçmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR and EURIBOR dhe lloje te ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Grupit.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Grupit ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do te ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do te ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithate, efekti aktual do te varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.
Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si në vijim:

| | USD | | EUR | | CHF | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | **2024** | **2023** | **2024** | **2023** | **2024** | **2023** |
| Paraja në dorë dhe në banka | 0.72% | 2.87% | 0.85% | 1.00% | - | - |
| Balancat me BQK-në | - | - | 0.30% | 0.30% | - | - |
| Kreditë për klientët | - | - | 6.95% | 6.88% | - | - |
| Investime në letra me vlerë në VDATGJ | - | - | 3.19% | - | - | - |
| Investime në letra me vlerë kosto të amortizuar | 4.19% | - | 2.94% | 3.15% | 0.32% | - |
| **Detyrimet** | | | - | - | - | - |
| Depozitat e klientëve | 0.83% | 0.58% | 1.23% | 1.21% | 0.02% | - |

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimve financiare të Grupit ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

| Përshkrimi | 2024<br>Totalet e Normave Fikse (000) | 2023<br>Totalet e Normave Fikse (000) |
|---|---|---|
| Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata | 568,171 | 511,035 |
| Totali i detyrimet totale dhe pozicionet e shkurtra | 690,883 | 622,168 |
| Pozicioni neto (i papeshuar) | (122,712) | (111,133) |

| Përshkrimi | Totalet e Normave Variable (000) | Totalet e Normave Variable (000) |
|---|---|---|
| Asetet dhe pozicionet e gjata | - | - |
| Kredi dhe paradhënie për klientët | (122,712) | (111,133) |
| Totali i aseteve dhe pozicionet e gjata | 122,712 | 111,133 |
| Detyrimet dhe pozicionet e shkurtra | - | - |
| Pozicioni neto (i papeshuar) | 122,712 | 111,133 |
| Gjithsej kapitali (Klasi I + Klasi II) | 69,081 | 60,433 |
| Norma e interesit variabile në normë fikse të aseteve % | 21.60% | 21.75% |

Banka vazhdon me proporcion të ngjajshëm në Riskun e normave të interesit. Banka ka përafërsisht 22% të asseteve të saj me norma variabile.

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## (c) Rreziku i tregut (vazhdim)

## Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

| 31 Dhjetor 2024 | Deri 1 muaj | 1-3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-5 vite | Mbi 5 vite | Jo interes bartëse | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 25,426 | - | - | - | - | - | 15,644 | 41,070 |
| Gjendja me BQK | 60,555 | - | - | - | - | - | - | 60,555 |
| Depozitat me afat | - | - | - | 922 | 5,559 | - | - | 6,481 |
| Investimet në letra me vlerë | 32,618 | 12,372 | 2,973 | 1,197 | 108 | 11,563 | - | 60,831 |
| Kredi klientëve – Norma fikse | 4,603 | 19,497 | 27,654 | 49,639 | 228,663 | 161,164 | - | 491,220 |
| Asetet tjera | - | - | - | - | - | - | 3,027 | 3,027 |
| **Gjithsej** | **123,202** | **19,497** | **27,654** | **50,561** | **295,053** | **161,164** | **17,371** | **663,184** |

| **Detyrimet** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse | 53,712 | 22,839 | 21,285 | 101,041 | 124,303 | 1,354 | 267,239 | 591,773 |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,096 | - | - | - | - | - | - | 1,096 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | - | - | - | - | - | - | 12,107 | 12,107 |
| Borxhi i varur | - | - | - | - | - | - | 200 | 200 |
| Detyrimet tjera | - | - | - | 3 | 1,681 | 1,090 | 1,822 | 4,596 |
| **Gjithsej** | **54,808** | **22,839** | **21,285** | **101,044** | **125,984** | **2,444** | **281,368** | **609,772** |
| **Hendeku** | **68,394** | **9,030** | **9,342** | **(49,286)** | **108,346** | **170,283** | **(262,697)** | **53,412** |
| **Hendeku kumulativ** | **68,394** | **77,424** | **86,766** | **37,480** | **145,826** | **316,109** | **53,412** | |

| 31 Dhjetor 2024 | Deri 1 muaj | 1-3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-5 vite | Mbi 5 vite | Jo interes bartëse | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 25,207 | - | - | - | - | - | 29,342 | 54,549 |
| Gjendja me BQK | 74,682 | - | - | - | - | - | - | 74,682 |
| Depozitat me afat | - | - | - | 1,739 | 3,624 | - | - | 5,363 |
| Investimet në letra me vlerë | - | - | - | - | 15,689 | - | - | 15,689 |
| Kredi klientëve – Norma fikse | 9,015 | 11,390 | 24,186 | 40,378 | 224,685 | 131,644 | - | 441,298 |
| Asetet tjera | - | - | - | - | - | - | 2,483 | 2,483 |
| **Gjithsej** | **108,904** | **11,390** | **24,186** | **42,117** | **243,998** | **131,644** | **31,825** | **594,064** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Detyrimet** | | | | | | | | |
| Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse | 43,296 | 8,364 | 5,468 | 53,720 | 191,405 | 838 | 229,528 | 532,619 |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,487 | - | - | - | - | - | - | 1,487 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | - | - | - | - | - | - | 11,783 | 11,783 |
| Detyrimet tjera | - | - | - | 119 | 1,548 | 841 | 2,306 | 4,814 |
| **Gjithsej** | **44,783** | **8,364** | **5,468** | **53,839** | **192,953** | **1,679** | **243,617** | **550,703** |
| **Hendeku** | **64,121** | **3,026** | **18,718** | **(11,722)** | **51,045** | **9,965** | **(211,792)** | **43,361** |
| **Hendeku kumulativ** | **64,121** | **67,147** | **85,865** | **74,143** | **125,188** | **255,153** | **43,361** | |

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
## (c) Rreziku i tregut (vazhdim)

### Rreziku valutor

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë të huaj. Grupi sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë valuta të huaja me kursin "spot" kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra.

Rreziku valuator nuk është signifikant, meqë pjesa më e madhe e transakionve të Grupit janë në valutën vendase. Valutat e huaja me të cilat Grupi operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si në vijim:

| Valuta | 2024<br>EUR | 2023<br>EUR |
|---|---|---|
| 1 USD | 1.0389 | 1.1050 |
| 1 CHF | 0.9412 | 0.9260 |
| 1 GBP | 0.8292 | 0.8691 |

Ekspozimi i Grupit ndaj rrezikut të valutës së huaj, i shprehur në ekuivalentë në euro është si në vijim:

| 31 Dhjetor 2024 | EUR | USD | CHF | GBP | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 34,041 | 2,704 | 3,533 | 792 | 41,070 |
| Gjendja me BQK | 60,555 | - | - | - | 60,555 |
| Depozitat me afat | 5,885 | - | - | - | 5,885 |
| Investimet në letra me vlerë | 51,014 | 7,694 | 2,123 | - | 60,831 |
| Kreditë për klientët | 491,220 | - | - | - | 491,220 |
| Pasuritë tjera | 3,027 | - | - | - | 3,027 |
| | **645,742** | **10,398** | **5,656** | **792** | **662,588** |
| **Detyrimet** | | | | | |
| Depozita nga klientët | 574,771 | 10,529 | 5,633 | 840 | 591,773 |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,096 | - | - | - | 1,096 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 12,107 | - | - | - | 12,107 |
| Provizioni për primet e pafituara | 6,427 | - | - | - | 6,427 |
| Borxhi i varur | 200 | - | - | - | 200 |
| Detyrime të tjera | 4,596 | - | - | - | 4,596 |
| | **599,197** | **10,529** | **5,633** | **840** | **616,199** |
| **Pozicioni neto valutor** | **46,545** | **(131)** | **23** | **(48)** | **46,389** |

| 31 Dhjetor 2024 | EUR | USD | CHF | GBP | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 42,877 | 5,594 | 5,201 | 877 | 54,549 |
| Gjendja me BQK | 74,682 | - | - | - | 74,682 |
| Depozitat me afat | 5,363 | - | - | - | 5,363 |
| Investimet në letra me vlerë | 15,689 | - | - | - | 15,689 |
| Kreditë për klientët | 441,298 | - | - | - | 441,298 |
| Pasuritë tjera | 2,483 | - | - | - | 2,483 |
| | **582,392** | **5,594** | **5,201** | **877** | **594,064** |
| **Detyrimet** | | | | | |
| Depozita nga klientët | 521,410 | 5,138 | 5,196 | 875 | 532,619 |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,487 | - | - | - | 1,487 |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 11,783 | - | - | - | 11,783 |
| Provizioni për primet e pafituara | 5,168 | - | - | - | 5,168 |
| Detyrime të tjera | 4,814 | - | - | - | 4,814 |
| | **544,662** | **5,138** | **5,196** | **875** | **555,871** |
| **Pozicioni neto valutor** | **37,730** | **456** | **5** | **2** | **38,193** |

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj rritjes ose uljes së normave të valutës së huaj është si më poshtë:

| | USD | | CHF | | GBP | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 | 2024 | 2023 |
| Normat e ndjeshmërisë | 5% | 5% | 5% | 5% | 5% | 5% |
| **Fitimi ose humbja** | | | | | | |
| +5% e Euro | (6,56) | 22.80 | 1.17 | 0.25 | (2.40) | 0.10 |
| - 5% e Euro | 6,56 | (22.80) | (1.17) | (0.25) | 2.40 | (0.10) |

### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Grupi do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.

Qasja e Grupit për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Grupit.

Grupi monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mblidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Grupi ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Grupit dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 arritën në 44,750 mijë euro (me 31 Dhjetor 2023: 31,139 mijë euro).
Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Grupi përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Grupi vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Grupit. Për më tepër Grupi mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhmit të rrezikut të likuiditetit.

## Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

*Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare*

Tabelat e mëposhtme tregojnë flukset monetare të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit në bazë të maturimit më të hershëm kontraktual të mbetur. Flukset monetare të pritshme të Grupit për këto instrumente ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## (d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

### Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

| 31 Dhjetor 2024 | Deri 1 muaj | 1-3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-5 vjet | Mbi 5 vjet | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 41,070 | - | - | - | - | - | **41,070** |
| Gjendja me BQK | 60,555 | - | - | - | - | - | **60,555** |
| Depozitat me afat | - | - | - | 922 | 5,559 | - | **6,481** |
| Investimet në letra me vlerë | 32,618 | 12,372 | 2,973 | 1,197 | 108 | 11,563 | **60,831** |
| Kreditë për klientët | 4,603 | 19,497 | 27,654 | 49,639 | 228,663 | 161,164 | **491,220** |
| Asete të tjera | 3,027 | - | - | - | - | - | **3,027** |
| **Gjithsej** | **141,873** | **31,869** | **30,627** | **51,758** | **234,330** | **172,727** | **663,184** |

**Liabilities**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Depozitat nga klientët | 320,951 | 22,839 | 21,285 | 101,041 | 124,303 | 1,354 | **591,773** |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,096 | - | - | - | - | - | **1,096** |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 12,107 | - | - | - | - | - | **12,107** |
| Borxhi i varur | 200 | - | - | - | - | - | **200** |
| Detyrime të tjera | 745 | 4 | 616 | 156 | 2,620 | 455 | **4,596** |
| **Gjithsej** | **335,099** | **22,843** | **21,901** | **101,197** | **126,923** | **1,809** | **609,772** |
| **Hendeku** | **(193,226)** | **9,026** | **8,726** | **(49,439)** | **107,407** | **170,918** | **53,412** |
| **Hendeku kumulativ** | **(193,226)** | **(184,200)** | **(175,474)** | **(224,913)** | **(117,506)** | **53,412** | **-** |

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

## (d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

### Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

| 31 Dhjetor 2023 | Deri 1 muaj | 1-3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-5 vjet | Mbi 5 vjet | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | | | | | |
| Paraja e gatshme dhe në banka | 54,549 | - | - | - | - | - | **54,549** |
| Gjendja me BQK | 74,682 | - | - | - | - | - | **74,682** |
| Depozitat me afat | - | - | - | 1,739 | 3,624 | - | **5,363** |
| Investimet në letra me vlerë | - | - | - | - | 15,689 | - | **15,689** |
| Kreditë për klientët | 9,015 | 11,390 | 24,186 | 40,378 | 224,685 | 131,644 | **441,298** |
| Pasuri të tjera | 2,483 | - | - | - | - | - | **2,483** |
| **Gjithsej** | **140,729** | **11,390** | **24,186** | **42,117** | **243,998** | **131,644** | **594,064** |

**Liabilities**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Depozitat nga klientët | 272,824 | 8,364 | 5,468 | 53,720 | 191,405 | 838 | **532,619** |
| Detyrimet ndaj bankave | 1,487 | - | - | - | - | - | **1,487** |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 11,783 | - | - | - | - | - | **11,783** |
| Detyrime të tjera | 643 | 457 | 574 | 136 | 2,523 | 481 | **4,814** |
| **Gjithsej** | **286,737** | **8,821** | **6,042** | **53,856** | **193,928** | **1,319** | **550,703** |
| **Hendeku** | **(146,008)** | **2,569** | **18,144** | **(11,739)** | **50,070** | **130,325** | **43,361** |
| **Hendeku kumulativ** | **(146,008)** | **(143,439)** | **(125,295)** | **(137,034)** | **(86,964)** | **43,361** | **-** |

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Grupi e menaxhon kapitalin e vet per tu siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Grupit përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë

*Kapitali rregullator*

Grupi monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kososvës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

*Leva financiare*

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Grupit rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

| | 2024 | 2023 |
|---|---|---|
| Gjithsej Pasuritë | 690,883 | 622,168 |
| Gjithsej Ekuiteti | 73,828 | 65,234 |
| **Raporti i levës** | **10.69%** | **10.48%** |

## 29. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

### (f) Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Risku tjetër me të cilin përballet Grupi në bazë të kontratave të sigurimit është se kërkesat aktuale dhe pagesat e përfitimeve ose koha e tyre ndryshojnë nga pritjet. Kjo ndikohet nga shpeshtësia e kërkesave, ashpërsia e kërkesave, përfitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi i mëvonshëm i kërkesave afatgjata. Prandaj, qëllimi i Grupit është që të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion për të mbuluar këto detyrime.

Ekspozimi ndaj riskut zbutet nga diversifikimi në një portofol të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Ndryshueshmëria e risqeve është përmirësuar gjithashtu me përzgjedhjen e kujdesshme dhe zbatimin e udhëzimeve të strategjisë së sigurimit, si dhe me përdorimin e marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Grupi blen ri-sigurime si pjesë e programit të lehtësimit të risqeve të saj. Ri-sigurimi i dhënë është vendosur në bazë proporcionale dhe jo-proporcionale. Pjesa më e madhe e ri-sigurimit proporcional është tejkalimi i ri-sigurimit të humbjes që merret për të kufizuar ekspozimin e përgjithshëm të Grupit në disa kategori të biznesit. Ri-sigurimi jo-proporcional është kryesisht ri-sigurimi i humbjes së tepërt i projektuar për të zbutur ekspozimin neto të kompanisë ndaj humbjeve nga katastrofa. Kufijtë e mbajtjes për ri-sigurimin e humbjes së tepërt ndryshojnë sipas linjës dhe territorit të produktit.

Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në një mënyrë që përputhet me kërkesat e provizioneve të papaguara dhe janë në përputhje me kontratat e ri-sigurimit.

Megjithëse Grupi ka marrëveshje për ri-sigurim, nuk lirohet nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj të siguruarve të saj dhe kështu ekziston një ekspozim kredie në lidhje me sigurimet e dhëna, deri në masën që ndonjë ri-sigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e marra sipas marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Grupi kryesisht lëshon këto lloje të kontratave të sigurimit: sigurimi i përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, sigurimi shëndetësor, sigurimi i pronës, sigurimi profesional të dëmshpërblimit dhe kontratave të tjera të sigurimit.Për sigurimin e përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, risku më i rëndësishëm është dëmi material dhe jo material që shkaktohet nga aksidentet. Për sigurimin e pronës dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor risqet më të rëndësishme janë: katastrofa natyrore, zjarri, aktivitetet terroriste, epidemitë, shkencat mjekësore dhe përmirësimet në teknologji.

Qëllimi i këtyre strategjive të sigurimit dhe ri-sigurimit është të kufizojë ekspozimin ndaj katastrofave bazuar në oreksin e riskut të kompanisë siç vendoset nga menaxhmenti. Mbajtjet maksimale të sigurimit janë 10% e kapitalit rregullator minimal.

Tabela e mëposhtme përcakton përqendrimin e detyrimeve të kontratës së sigurimit jo të jetës sipas llojit të kontratës:

| 31 Dhjetor 2024 | Detyrimet Bruto | Risigurimi i detyrimeve | Detyrimet Neto |
|---|---|---|---|
| Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta | 8,075 | 200 | 7,875 |
| BKS | 880 | 53 | 827 |
| Fondi i Kompenzimit | 915 | - | 915 |
| Sigurimi i Pronës | 757 | 503 | 254 |
| Sigurimi shëndetësor | 500 | - | 500 |
| Produkte të tjera | 980 | 126 | 854 |
| **Gjithsej** | **12,107** | **882** | **11,225** |

| 31 Dhjetor 2023 | Detyrimet Bruto | Risigurimi i detyrimeve | Detyrimet Neto |
|---|---|---|---|
| Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta | 7,820 | 355 | 7,465 |
| BKS | 765 | - | 765 |
| Fondi i Kompenzimit | 910 | - | 910 |
| Sigurimi i Pronës | 752 | 503 | 249 |
| Sigurimi shëndetësor | 526 | - | 526 |
| Produkte të tjera | 1,010 | 105 | 905 |
| **Gjithsej** | **11,783** | **963** | **10,820** |

## 30. Kombinimet e biznesit

Kombinimi i biznesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 ishte blerja e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiali"). Më 9 shtator 2022 (data e blerjes), shoqëria mëmë fitoi 100% të të drejtave të votës të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a, një kompani e përfshirë në sigurimet e jo-jetës. Si rezultat, Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.a. u bë një filial i shoqërisë mëmë pasi shoqëria mëmë mori kontrollin e Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.a. Detajet e vlerës së drejtë të pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve, shuma e blerjes dhe emri i mirë janë si më poshtë:

| | Vlera kontabël Euro | Rregullimet Euro | Vlera e drejtë Euro |
|---|---|---|---|
| **Pasuritë** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 738,259 | - | 738,259 |
| Investimet në depozita me afat | 7,368,878 | - | 7,368,878 |
| Investimet në Obligacione Qeveritare | 1,953,564 | - | 1,953,564 |
| Kërkesat ndaj debitorëve | 1,212,361 | - | 1,212,361 |
| Kërkesat e ceduara nga risigurimi | 1,907,010 | - | 1,907,010 |
| Kostoja e shtyrë e blerjes | 411,943 | - | 411,943 |
| Prona, Impiante & Pajisje | 3,252,508 | 112,845 | 3,365,353 |
| Prona investuese | 894,517 | - | 894,517 |
| Pasuritë e paprekshme | 24,201 | - | 24,201 |
| Pasuritë tatimore | - | 14,201 | 14,201 |
| Pasuritë tjera | 317,860 | (46,003) | 271,857 |
| **Gjithsej Vlera e Drejtë e Pasurive** | **18,081,101** | **81,043** | **18,162,144** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Detyrimet** | | | |
| Primi i pafituar | 4,559,113 | - | 4,559,113 |
| IBNR dhe RBNS | 10,974,692 | 590,000 | 11,564,692 |
| Detyrimet e Risigurimit | 931,203 | - | 931,203 |
| Detyrimet ndaj KIB | 142,238 | - | 142,238 |
| Detyrimet e qirasë – IFRS 16 | 50,995 | - | 50,995 |
| Detyrimet e qirasë | 148,931 | - | 148,931 |
| Detyrimet tatimore | 106,396 | - | 106,396 |
| Paga dhe Kontributet Pensionale | 54,711 | - | 54,711 |
| Detyrimet ndaj aksionarëve | 97,509 | - | 97,509 |
| Detyrimet ndaj furnitorit | 240,872 | - | 240,872 |
| Detyrimet e tatimit në fitim | 35,000 | (35,000) | - |
| Detyrimet Kontigjente | - | - | - |
| **Gjithsej Vlera e Drejtë e Detyrimeve** | **17,341,660** | **555,000** | **17,896,660** |
| | | | |
| **Vlera e Drejtë e Pasurive Neto të Fituara** | **739,441** | **(473,957)** | **265,484** |
| **Emri i mirë** | | | |
| Konsiderata e transferuar | | | 2,100 |
| IJK | | | - |
| | | | **2,100** |
| | | | |
| Vlera e drejtë e pasurive të blera | | | 18,162 |
| Vlera e drejtë e detyrimeve të supozuara | | | (17,897) |
| **Vlera e drejtë e pasurive neto të fituara** | | | **265** |
| **Emri i mirë në datën e blerjes** | | | **1,835** |

## 30. Kombinimet e biznesit (vazhdim)

Emri i mirë konsiston kryesisht në përfitime ekonomike të ardhshme dhe sinergji me operacionet ekzistuese dhe nuk është i zbritshëm për qëllime tatimore. Grupit i kërkohet të testojë, në baza vjetore, nëse emri i mirë ka pësuar ndonjë zhvlerësim. Shuma e rikuperueshme përcaktohet në bazë të llogaritjeve të vlerës në përdorim. Përdorimi i kësaj metode kërkon vlerësimin e rrjedhjeve monetare të ardhshme dhe përcaktimin e një norme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të rrjedhjeve monetare. Që nga data e raportimit, Emri i mirë nuk është zhvlerësuar.
Shumat e rikuperueshme të kompanisë së blerë janë përcaktuar nga llogaritjet e vlerës në përdorim bazuar në parashikimet e flukseve monetare nga buxhetet që mbulojnë një periudhë deri më 31 dhjetor 2027. Supozime të tjera kryesore janë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Norma e skontimit: | 15.65% |
| Norma e rritjes: | 2.00% |

Norma e rritjes dhe supozimi zbatohen vetëm për periudhën përtej periudhës së buxhetuar formale me llogaritjen e vlerës në përdorim.

## 31. Ngjarjet pas datës së raportimit

Përveç rasteve të shpalosura në pasqyrat financiare të konsoliduara, nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

# KOMPANIA E SIGURIMEVE "SIGURIA" - BILANCI I GJENDJES DHE PASQYRA E TË ARDHURAVE

Pasqyrat financiare të audituara nga Grant Thorton të kompanisë sigurimeve "Siguria". Për raport të detajuar të raportit vjetor ju lutem referohuni në webfaqen e www.ks-siguria.com

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2024

| PASURITË | 2024<br>EURO'000 | 2023<br>EURO'000 |
|---|---|---|
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 870 | 469 |
| Depozitat | 11,682 | 9,914 |
| Investimet ne letrat me vlere | 5,082 | 5,084 |
| Të arkëtueshmet nga sigurimet | 1,299 | 1,538 |
| Kostot e shtyra të përvetësimit | 601 | 532 |
| Prona, pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurisë | 3,325 | 3,462 |
| Prona investuese | 895 | 895 |
| Pjesa e risiguruesit në detyrimet e provizioneve teknike | 882 | 963 |
| Pasuritë tjera | 1,816 | 1,351 |
| **GJITHSEJ PASURITË** | **26,452** | **24,208** |

## EKUITETI DHE DETYRIMET

| EKUITETI | 2024<br>EURO'000 | 2023<br>EURO'000 |
|---|---|---|
| Kapitali aksionar | 19,503 | 19,503 |
| Rezerva e rivlerësimit | 534 | 534 |
| Humbjet e akumuluara | (12,846) | -13,604 |
| **GJITHSEJ EKUITETI** | **7,191** | **6,433** |
| **DETYRIMET** | | |
| Detyrimet e provizioneve teknike | 11,545 | 11,221 |
| Provizioni për prime të pafituara | 6,427 | 5,168 |
| Detyrime ndaj borxhit të varur | 200 | - |
| Detyrim ndaj tatimit në të ardhura | 164 | 54 |
| Dertyrimet e Qirasë | 324 | 445 |
| Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera | 601 | 887 |
| **GJITHSEJ DETYRIMET** | **19,261** | **17,775** |
| **GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET** | **26,452** | **24,208** |

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 04 Prill 2025 dhe janë nënshkruar në emër të:

Zt. Fitim Rexhepaj
Drejtor Gjeneral

Zt. Adhurim Kastrati
Drejtor Financiar

# PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
# PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2024

| | 2024<br>EURO'000 | 2023<br>EURO'000 |
|---|---|---|
| Primet e shkruara bruto | 14,460 | 11,018 |
| Minus: Primet e bartura tek risiguruesit | (2,055) | -813 |
| **PRIMET E SHKRUARA NETO** | **12,405** | **10,206** |
| | | |
| Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara | (1,258) | -337 |
| Ndryshimi në pjesën e risiguruesëve të rezervës së primit të pafituar | 770 | 93 |
| **PRIMET E FITUARA NETO** | **11,917** | **9,961** |
| | | |
| Të ardhurat financiare neto | 355 | 229 |
| Të ardhura tjera | 411 | 420 |
| **GJITHSEJ TË ARDHURAT** | **12,683** | **10,610** |

| | | |
|---|---|---|
| Shpenzimet e provizioneve teknike | (6,641) | -6,268 |
| Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit | 70 | 63 |
| Kontributi në BKS për shpenzimet administrative | (257) | -292 |
| Shpenzime tjera operative dhe administrative | (4,827) | -3,255 |
| **GJITHSEJ SHPENZIMET** | **(11,656)** | **-9,751** |
| | | |
| **FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT** | **1,027** | **858** |
| | | |
| Tatimi në të ardhura | (269) | -114 |
| | | |
| FITIMI/(HUMBJA) PËR VITIN | 758 | 744 |
| Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse | - | - |
| **GJITHSEJ FITIMI/(HUMBJA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN** | **758** | **744** |

# Raporti i Auditorit të Pavarur

**Grant Thornton LLC**
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
**T** +383 (0)38 247 801
**F** +383 (0)38 247 802
**E** Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Për Aksionarin e
Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.a.

## Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2024, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me politikat e kontabilitetit të shpalosura në shenimin 2A.

## Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në pajtim me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit të BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Pasiguria materiale që lidhet me parimin e vijimësisë

Ne tërheqim vëmendjen te Shënimi 2X në pasqyrat financiare shoqëruese, i cili shpalos se më 31 dhjetor 2024, Kompania ka pasuri neto prej 7,191 mijë euro (2023: 6,433 mijë euro). Fitimi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 është 758 mijë euro (2023: fitimi në vlerë prej 744 mijë euro), ndërsa humbjet e akumuluara në atë datë ishin 12,846 mijë euro (2023: 13,604 mijë euro).

Gjatë vitit 2023, aksionari i vetëm i Kompanisë ka kontribuar kapitalin në vlerë prej 1,300 mijë euro.

Aftësia e Kompanisë për të vazhduar së përmbushuri parimin e vijimësisë varet nga mbështetja e vazhdueshme financiare nga aksionari i saj dhe disponueshmëria e burimeve të vazhdueshme të financimit. Aksionari i Kompanisë nuk ka ndërmend të likuidojë ose të përfundojë operacionet e biznesit të Kompanisë. Aksionari i Kompanisë, Banka Ekonomike Sh.a., në letrën e datës 4 prill 2025 konfirmoi se është në gjendje dhe do të vazhdojë t'i ofrojë Kompanisë, mbështetje financiare për t'i mundësuar vazhdimin e veprimtarisë dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave rregullatore për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e asaj letre.

Pasqyrat financiare nuk përfshijnë rregullime në lidhje me rikuperimin dhe klasifikimin e shumave të pasurive të regjistruara, as shumat dhe klasifikimin e detyrimeve që mund të kërkohen nëse kompania nuk vazhdon së përmbushuri parimin e vijimësisë. Opinioni ynë nuk është modifikuar më tej në lidhje me këtë çështje.

## Informata tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë shtojcat plotësuese të cilat përfshijnë "Margjinën e solvencës" dhe "Pasuritë që mbulojnë detyrimet e sigurimeve". Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon edhe informatat tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë formë sigurie apo konkluzioni mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat tjera dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë auditimit ose në të kundërten duket të jetë materialisht e keqdeklaruar. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, vijmë në përfundim se ekziston një anomali materiale e këtyre informatave tjera, neve na kërkohet t'a raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë aspekt.

Grant Thornton LLC is a member firm of Grant Thornton International Ltd (GTIL). GTIL and the member firms are not a worldwide partnership. GTIL and each member is a separate legal entity. Services are delivered by the member firms. GTIL does not provide services to clients. GTIL and its member firms are not agents of, and do not obligate, one another and are not liable for one another's acts or omissions.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat e kontabilitetit të shpalosura në shenimin 2A, dhe për ato kontrolle të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë më vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

## Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Kompania mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Kompania të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajten e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a., përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Grant Thornton LLC**
Prishtinë,
07 prill 2025

Suzana Stavrikj
Auditor ligjor

Grant Thornton LLC is a member firm of Grant Thornton International Ltd (GTIL). GTIL and the member firms are not a worldwide partnership. GTIL and each member is a separate legal entity. Services are delivered by the member firms. GTIL does not provide services to clients. GTIL and its member firms are not agents of, and do not obligate, one another and are not liable for one another's acts or omissions.